

# KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



Raporti Vjetor

2013

## PËRMBAJTJA

Fjala përshëndetëse e Komisionerit.....	fq. 3
Hyrja.....	fq. 4

### KAPITULLI I – VËSHTRIM MBI SITUATËN E DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI

I.1. Kuadri ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri.....	fq. 5
I.2. Situata e diskriminimit në Shqipëri .....	fq. 8
I.2.1. Diskriminimi për shkak të racës .....	fq. 8
I.2.2. Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar.....	fq. 11
I.2.3. Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor .....	fq. 15
I.2.4. Diskriminimi për shkak të gjinisë.....	fq. 19
I.2.5. Diskriminimi i shumëfishtë.....	fq. 21

### KAPITULLI II – VEPRIMTARIA E KMD-SË NË MBROJTJEN NGA SJELLJET DISKRIMINUESE DHE PROMOVIMIN E BARAZISË

II.1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim .....	fq. 23
II.1.1. Shqyrtimi i çështjeve nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi .....	fq. 23
II.1.1.1. Procedura e shqyrtimit të ankesave .....	fq. 23
II.1.1.2. Çështjet e trajtuara nga KMD gjatë vitit 2013 .....	fq. 24
II.1.1.3. Ankuesit .....	fq. 25
II.1.1.4. Shpërndarja rajonale e ankesave .....	fq. 25
II.1.1.5. Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara .....	fq. 26
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të racës .....	fq. 27
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar .....	fq. 29
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike .....	fq. 31
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të orientimit seksual .....	fq. 31
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të gjinisë .....	fq. 33
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të moshës .....	fq. 35
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të bindjeve politike .....	fq. 36
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të gjendjes arsimore .....	fq. 36
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore .....	fq. 37
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të bindjeve fetare .....	fq. 37
• Ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të denoncimeve .....	fq. 38
II.1.1.6. Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat .....	fq. 39
• Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve .....	fq. 40
• Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit .....	fq. 40
• Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit .....	fq. 41
II.1.1.7. Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara .....	fq. 42

II.1.2. Asistenca ndaj viktimave në gjykatë .....	fq. 44
II.2. Ndërgjegjësimi .....	fq. 45
• Organizimi i Konferencave dhe trajnimeve nga KMD .....	fq. 45
• Organizimi i Ditëve të Hapura .....	fq. 48
• Rritja e vizibilitetit në media .....	fq. 48
• Pjesëmarrja në Seminare, Konferenca dhe tryeza diskutimi .....	fq. 49
• Leksione të Hapura .....	fq. 49
II.3. Kryerja e sondazheve dhe monitorimeve të pavarura në lidhje me diskriminimin..	fq. 50
II.4. Publikimi i raporteve dhe dhënia e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin .....	fq. 51
II.4.1. Rekomandime Legjislative .....	fq. 51
II.4.2. Opinione dhe Rekomandime të tjera për çështje diskriminimi .....	fq.52
II.4.3. Rekomandime për përmirësimin e situatës së grupeve vulnerabël. ....	fq. 54
II.4.4. Publikimi i raporteve të veçanta .....	fq. 56
II.4.5. Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi .....	fq. 56
II.5. Rritja e kapaciteteve të stafit të KMD-së .....	fq. 58
II.6. Bashkëpunime .....	fq. 59
II.6.1. Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare dhe OJF-të përmes projekteve të përbashkëta .....	fq. 59
II.6.2. Nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit .....	fq. 61

### **KAPITULLI III – ASPEKTE TË SHËRBIMEVE**

III.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore .....	fq. 63
III.2. Menaxhimi i burimeve financiare .....	fq. 63

<b>REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI .....</b>	<b>fq. 66</b>
---	---------------

<b>ANEKS - AKTIVITETE TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI .....</b>	<b>fq. 68</b>
--	---------------

## Fjala përshëndetëse e Komisionerit

**I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,  
Të nderuar Deputetë,**

Me ndjenjën e një përgjegjësie të madhe që mbart Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion që siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe sjelljet që e nxisin atë, po paraqesim pranë Kuvendit të Shqipërisë Raportin Vjetor 2013.

Aktiviteti i Komisionerit është zhvilluar në funksion të realizimit të proceseve intensive demokratizuese dhe integruese ku Shqipëria është përfshirë dhe ushtrimit të kompetencave që ligji i ka përcaktuar.

Ky raport është konceptuar duke mbajtur parasysh detyrimin ligjor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të parashikuar në nenin 26 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ku thuhet shprehimisht se *“Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e komisionerit dhe të zyrës”*.

Përmbajtja e këtij raporti është ndërtuar bazuar në misionin dhe objektivat e Zyrës së Komisionerit të reflektuara në dokumentin e miratuar nga institucioni “Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit për Vitin 2013 i Komisionerit Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi”, si dhe në rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë ka adresuar për vitin 2013.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERE**

**Irma BARAKU**

## Hyrja

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2013, ka ushtruar funksionet dhe kompetencat e tij në përputhje me Planin Strategjik 2012-2015 dhe Planin e Veprimit për vitin 2013. Ky është dokumenti bazë mbi të cilin mbështetet veprimtaria e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Plani Strategjik synon të kthehet në një instrument për KMD-në dhe për të gjithë aktorët e tjerë publikë dhe jopublikë, për një kuptim të përbashkët të situatës së mosdiskriminimit, sfidave që shtrihen përpara dhe përballimin e tyre. Kjo strategji parashtron edhe bashkëpunimin dhe bashkërendimin mes të gjithë aktorëve, rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse, për të arritur në një qasje efikase dhe të harmonizuar në luftën për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjithashtu, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, Komisioneri ka patur në vëmendje edhe objektivat e parashtruara në Rezolutën e datës 25 Mars 2013 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “*Për vlerësimin e punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2012*”.

Në periudhën nga 1 janar 2013 deri në 31 dhjetor 2013, KMD ka trajtuar gjithsej 256 çështje, nga këto 225 ankesa dhe 31 çështje ex-officio. Gjatë vitit 2013 ka filluar shqyrtimi i 166 ankesave, nga të cilat 149 janë nga individë dhe 17 ankesa nga organizata me interesa legjitime. Edhe gjatë vitit 2013 ka pasë një shtrirje gjeografike të ankesave me pretendim diskriminim, kryesisht nga bashki dhe komuna ku Komisioneri ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese. KMD ka dalë me vendim për 131 çështje të trajtuara gjatë vitit 2013, duke dhënë vendim për të gjitha çështjet e mbartura nga viti 2012 (59 ankesa dhe 6 çështje ex-officio), ndërkohë që ka dhënë vendime edhe për 51 ankesa dhe 15 çështje të nisura kryesisht të rregjistruara në vitin 2013. Theksojmë se në 27% të rasteve të përfunduara është konstatuar diskriminimi. Në 17% të tyre është dhënë vendim diskriminimi shoqëruar me rekomandimin për shmangjen e situatës diskriminuese dhe në tre raste është vendosur sanksion me gjobë për moszbatim të rekomandimit të KMD-së. Ndërkohë që në 10% është shmangur situata diskriminuese përmes ndërmjetsimit të KMD-së. Gjatë vitit 2013, janë dhënë 36 rekomandime për shmangjen e situatave diskriminuese pas shqyrtimit të ankesave.

Zyra e Komisionerit ka identifikuar nevojat për amendime ligjore dhe përmirësim të mëtejshëm të mekanizmave ligjorë, duke dërguar, gjatë vitit 2013, 2 Rekomandime Legjislative për ndryshimin e legjislacionit ekzistues në fushën e diskriminimit, 1 opinion për Gjykatën Kushtetuese, 4 Rekomandime të tjera për çështje diskriminimi dhe 15 rekomandime për përmirësimin e situatës së grupeve vulnerabël.

Një vëmendje të veçantë Komisioneri i ka kushtuar edhe rolit të medias, duke u shfaqur më shumë në median e shkruar dhe vizive, me qëllim nxitjen e qytetarëve për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre, krijimin e besimit të publikut tek institucioni, rritjen e ndërgjegjësimit në nivel lokal dhe në sektorin privat. Transmetimi i një spoti televiziv ka ndikuar dukshëm në informimin e publikut.

Vendosja e bashkëpunimit me aktorë të tjerë vlerësohet nga ana e institucionit si një lehtësi në ushtrimin e aktivitetit të tij. Disa marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar me institucione shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare si dhe janë zhvilluar disa aktivitete të përbashkëta.

## KAPITULLI I

### VËSHTRIM MBI SITUATËN E DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI

#### I.1. Kuadri ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri

Ekziston një kuadër i gjerë ligjor në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit. Legjislacioni shqiptar në fushën e mosdiskriminimit parashikohet në një sërë aktesh, duke filluar me Kushtetutën e R.Sh, aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe me ligjet e brendshme.

*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, ka synuar nxitjen e respektimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në disa dispozita të saj, ku mund të përmendim nenin 18, por edhe nenet 16 e 20. Në nenin 18 parashikohet se “*të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*”.

Shqipëria është pjesë e instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mos-diskriminimit. Raporti i tyre me legjislacionin kombëtar në fuqi, përcaktuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, jep mundësinë që t’i referohemi dokumenteve të rëndësishëm ndërkombëtare. Natyrisht që ky është një kuadër mjaft i gjerë, por KMD do të parashtrijë si më poshtë kuadrin ligjor me të cilin është lidhur veprimtaria e institucionit.

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike* është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991<sup>1</sup>. Në korrik 2013, KMD ka qenë pjesë përbërëse e delegacionit që ka raportuar lidhur me implementimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, në kuadër të raportit të Dytë Periodik të Shqipërisë, gjatë Sesionit 106 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut. Në vëzhgimet përmbyllëse, Komiteti ka vlerësuar si aspekte pozitive miratimin, ndër të tjera, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vitin 2010 dhe amendimet në Kodin Penal në Maj 2013 të cilat zgjerojnë mbrojtjen nga diskriminimi edhe për shkak të orientimit seksual.

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore* është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991<sup>2</sup>. Në nëntor 2013, KMD ka qenë pjesë përbërëse e delegacionit që ka raportuar lidhur me implementimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore . Në vëzhgimet përfundimtare të këtij Komiteti, mbi raportin e dytë dhe të tretë periodik të kombinuar të Shqipërisë, vlerësohet si pozitive miratimi i ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, ligji “*Për shëndetin mendor*”, ratifikimi i Konventës së OKB “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*”, ndryshimet në Kodin Penal lidhur me zgjerimin e mbrojtjes nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual, si dhe punën e realizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Ligji nr. 7510 date 08.08.1991 “*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*”.

<sup>2</sup> Ligj nr. 7511 date 08.08.1991 “*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore*”.

<sup>3</sup>[http://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=E/C.12/ALB/CO/2-3&Lang=En](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=E/C.12/ALB/CO/2-3&Lang=En)

**Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012<sup>4</sup>, ka përcaktuar një sërë të drejtash për personat me aftësi të kufizuara, të cilat përkthehen në detyrime për shtetet palë. Këto parashikime duhen mbajtur parasysh për ndryshimet legjislativë në kuadër të përshtatjes së legjislacionit të brendshëm shqiptar me këtë Konventë.

**Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave**, miratuar në vitin 1979, është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993<sup>5</sup>, dhe Protokolle Opsional në 2003<sup>6</sup>. Në legjislacionin shqiptar, një përkufizim plotësisht në përputhje me CEDAW, gjejmë në ligjin 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” (neni 4) dhe në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (neni 3).

**Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore**, e ratifikuar nga Shqipëria në 1996<sup>7</sup>, në nenin 14 të saj parashikon “ndalimin e diskriminimit”, ndërsa Protokolle Nr. 12, në nenin 1, i referohet ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit, duke zgjeruar fushën e zbatimit të Nenit 14 edhe në rastet kur një person është diskriminuar në gëzimin e çdo të drejte ose përfitimi sipas legjislacionit kombëtar.

**Konventa e Këshillit të Europës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”**<sup>8</sup> është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Në këtë Konventë, “dhuna kundër grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe konsiderohet si një formë diskriminimi ndaj tyre.

**Konventa Kuadër e Këshillit të Europës Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare**, e cila pas ratifikimit është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka forcën e ligjit, është një garanci për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri;

**Karta Sociale Evropiane**, një traktat i Këshillit të Europës, e miratuar në vitin 1961 dhe e rishikuar në vitin 1963, është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm me ratifikimin e saj prej Shqipërisë në vitin 2002.

**Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial-ICERD**, në të cilën Shqipëria ka aderuar në vitin 1994.

**Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”**, konkretizon nenin 18 të Kushtetutës. Ai është ligji organik mbi bazën e të cilit sigurohet mbrojtja nga diskriminimi. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi. Ligji rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë joshteruese shkaqesh. Në bazë të këtij ligji është krijuar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), si person juridik publik, i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij dhe si autoriteti përgjegjës, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin. KMD-ja ka kompetenca për të pranuar ankesa jo vetëm ndaj sektorit publik, por edhe ndaj

<sup>4</sup> Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

<sup>5</sup> Ligji 1769/ 9.11.1993

<sup>6</sup> Ligji nr. 9052, date 17.04.2003

<sup>7</sup> Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, i ndryshuar.

<sup>8</sup> Ligji Nr. 104 datë 11.08.2012 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”. Kjo Konventë nuk ka hyrë akoma në fuqi, pasi duhen edhe dy ratifikime.

subjekteve privatë dhe individëve. Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore janë të parashikuara shprehimisht dhe përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, në fushën e arsimit, si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Por mbrojtja nga diskriminimi sipas Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” garantohet për të gjitha të drejtat e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Ligjet e brendshme gjithashtu sanksionojnë parimin e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, edhe pse ekziston nevoja për ndryshime apo miratimin e legjislacionit të ri për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi<sup>9</sup>.

**Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”** është një tjetër akt mbi bazën e të cilit vepron KMD-ja gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Në këtë ligj parimi i barazisë sanksionohet si një nga parimet bazë i cili duhet të udhëheqë veprimtarinë e administratës publike. Në kuadër të hartimit të Kodit të ri të Procedurave Administrative, KMD ka konstatuar se nuk gjen më pasqyrim parimi i barazisë. Në këtë kuadër, KMD ka rekomanduar që parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit duhet të jenë pjesë e parimeve bazë të këtij Kodi, si parime të rëndësishme që duhet të udhëheqin veprimtarinë e çdo organi publik apo subjekti privat që ushtron funksione publike<sup>10</sup>.

**Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”**, i ndryshuar, i cili në nenin 9, parashikon ndalimin e çdo lloji diskriminimi në fushën e punësimit, por për një numër më të kufizuar shkaqesh se Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. KMD ka dërguar në vitin 2012 rekomandime për Kodin e Punës, të cilat nuk janë miratuar akoma. KMD do të ridërgojë këto propozime.

Gjithashtu, kuadri ligjor në fushën e barazisë dhe mos-diskriminimit, për shkaqe të veçanta parashikohet edhe në ligjet e tjera si: Ligji nr. 9970, date 24.07.2008, “**Për barazinë gjinore në shoqëri**” i cili parashikon ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë në nenin 6 të tij; Ligji nr. 10347, date 04.11.2010, “**Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**”, i cili eliminon të gjitha format e diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës; Ligji nr. 9669, date 18.12.2006, “**Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare**”, etj.

Niveli i mbrojtjes nga diskriminimi është rritur gjatë vitit 2013 me miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal, fakt ky i konstatuar edhe në Progres Raportin 2013 për Shqipërinë. Këtu mund të përmendim parashikimin si rrethanë rënduese të dënimit të motiveve të identitetit gjinor, orientimin seksual, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike dhe aftësisë së kufizuar<sup>11</sup>; parashikimin si vepër penale të ngacmimit seksual (neni 108/a); kriminalizimin e nxitjes së urrejtjes apo grindjeve për shkak të orientimit seksual (neni 265); kriminalizimi i shkeljes së barazisë së shtetasve nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik edhe për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor (neni 253). Komisioneri ka qenë propozues i disa prej këtyre ndryshimeve, por edhe i disa të tjerave që fatkeqësisht nuk kanë gjetur miratim dhe që do t’u ridërgohen autoriteteve kompetente<sup>12</sup>.

<sup>9</sup> Një nevojë e tillë është konstatuar edhe në Progres Raportin 2013 Për Shqipërinë.

<sup>10</sup> Për rekomandimet e KMD-së për Draft Kodin e Procedurave Administrative referoju faqes 54 të këtij Raporti 11 Shkaqe këto që mbrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Ligji “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”.

<sup>12</sup> Për rekomandimet e KMD-së për Kodin Penal referoju faqes 54, të këtij Raporti.



Për të luftuar diskriminimin në fushën e arsimit, Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka ngarkuar Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës<sup>13</sup> për marrjen e masave me karakter pozitiv (neni 18 i ligjit), dhe në zbatim të këtyre detyrimeve ka parashikuar në nenin 39 të tij, nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e nenit 18. Komisioneri konstaton se edhe pse me Urdhrin Nr. 52, datë 23. 04. 2012 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02, 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është ngritur një grup ndërinstytucional pune i kryesuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës<sup>14</sup>, akoma nuk janë miratuar aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në zbatim të legjislacionit janë hartuar dhe dokumente strategjike dhe politika mosdiskriminimi, ku përmendim: Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013; Plani i Veprimit për Fëmijët 2012 - 2015; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje 2011-2015; Plani Kombëtar i veprimit për Dekadën e Përfshirjes Rome 2012-2015.

## I.2. Situata e diskriminimit në Shqipëri

Edhe pse nuk ekzistojnë të dhëna të konsoliduara për paraqitjen e diskriminimit, është e qartë se diskriminimi është i përhapur në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Kjo pjesë paraqet situatën e diskriminimit dhe llojet më të përhapura të diskriminimit sipas konstatimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë punës së tij, si dhe burime të tjera të disponueshme. Nga praktika e zbatimit të ligjit vit pas viti po vihet re një ndërgjegjësim më i madh i publikut të gjerë dhe grupeve specifike mbi mjetet ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi. Kjo gjë vërtetohet edhe me rritjen e numrit të ankesave të regjistruara, dhe fillimin e zbatimit të ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi edhe në gjykata.

Komisioneri, në mjaft raste ka evidentuar mos informimin e qytetarëve mbi diskriminimin, madje shpeshherë ata e identifikojnë diskriminimin me forma të tjera të sjelljeve të paligjshme apo të parregullta. Edhe në vitin 2013, është vënë re se ankuesit plotësojnë ankesa për pretendim diskriminimi, të cilat në thelb kishin të bënin me shkeljen e një të drejte, por nuk cenonin parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Edhe pse vihet re një tendencë më e lartë mbi fenomenin e diskriminimit, ndërgjegjësimi i popullsisë, mbetet ende një prioritet.

### I.2.1. Diskriminimi për shkak të racës<sup>15</sup>

Në Shqipëri jeton një numër i konsiderueshëm i minoriteteve, pjesë e të cilëve janë edhe romët dhe egjiptianët. Sipas Censurit të vitit 2011, të realizuar nga INSTAT rezulton se numri i përgjithshëm i popullsisë në Republikën e Shqipërisë është 2,800,138 banorë. Sipas të dhënave të Censurit 2011 rezultojnë këto të dhëna për minoritetet sipas përkatësisë etnike dhe kulturore: rom 8,301 banorë, egjiptianë 3,368 banorë. Ndërkohë rezulton se 390,938 banorë kanë preferuar të mos përgjigjen dhe përgjigjet e 44.144 banorëve kanë qenë të pavlefshme/

13 Emërtimi siç parashikohet në Ligjin “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, sot emërtimi zyrtar “Ministri i Arsimit dhe Sportit”.

14 Emërtimi zyrtar në kohën e daljes së urdhrin për ngritjen e grupit të punës, sot Ministria e Arsimit dhe Sportit.

15 Sipas Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës përkufizimi për “**diskriminimin racial**” është: “Trajtim i ndryshëm me bazë etninë, origjinën, ngjyrën, shtetësinë, besimin fetar dhe gjuhën”.

[http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/gpr/en/recommendation\\_n7/Recommendation\\_7\\_en.asp#P80\\_4931](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/gpr/en/recommendation_n7/Recommendation_7_en.asp#P80_4931)

të papërcaktuara. Rezultatet e Censurit për Popullsinë dhe Banesat u kundërshtuan nga përfaqësuesit e minoriteteve, përfshi disa shoqata Rome dhe Egjiptiane<sup>16</sup>.

Mbrojtja e minoriteteve garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligje që parashikojnë respektimin e të drejtave të tyre, të cilat rregullojnë fusha të veçanta të jetës dhe njëkohësisht evidentojnë qartë edhe rëndësinë që i ka kushtuar shteti shqiptar vitet e fundit diskriminimit racial. Në kuadër të pesë prioritetëve të Komisionit Evropian për Shqipërinë, përmirësimi i legjislacionit dhe i politikave për minoritetet është një ndër masat që vendi ynë ka parashikuar të marrë, kjo në përputhje edhe me rekomandimet e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e të Drejtave të Minoriteteve të Këshillit të Evropës.

Kuadri institucional për mbrojtjen e të drejtave të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri është i gjerë. Njohja e këtyre institucioneve, ka një rëndësi thelbësore në realizimin e mbrojtjes së të drejtave të tyre. Çdo institucion ka pjesën e vet të përgjegjësisë, por bashkëpunimi dhe bashkërendimi midis tyre është i rëndësishëm për të patur rezultate sa më të mira në angazhimet që ndërmerren. P.sh.: Për zbatimin e dokumenteve strategjike që janë miratuar në vend, kërkohet një bashkëpunim dhe koordinim i veprimeve midis pushtetit qendror dhe atij vendor.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka pasur dhe vazhdon të ketë në vëmendje përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Romëve dhe Egjiptianëve. Komisioneri edhe gjatë vitit 2013 ka realizuar ditë të hapura, të cilat mundësojnë takime me anëtarë të komunitetit. Problematikat e romëve dhe egjiptianëve shfaqen në disa sfera të jetës si: strehimi, arsimit, punësimi, të mirat dhe shërbimet. Edhe fëmijët rom kanë qenë objekt i ankesave ose rasteve ex-officio të diskriminimit dhe në këto raste Komisioneri, ka mbajtur një qëndrim veçanërisht proaktiv. Një problematike për fëmijët rom është mos regjistrimi i tyre në regjistrat e gjendjes civile. Mungesa e regjistrimit të fëmijëve rom dhe egjiptian, minimizon aksesin e tyre në gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore<sup>17</sup>.

Çështja e strehimit paraqitet problematike për një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të komunitetit rom, të cilët jetojnë në kushte të vështira banimi, me hapësira të pamjaftueshme, dhe në ambiente të papërshtatshme. Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar disa raste, ndaj njërive vendore, për çështjen e strehimit të romëve dhe egjiptianëve. Ka bashki të cilat nuk kanë ndërtuar banesa sociale, ndërkohë që në disa bashki pavarësisht se ekzistojnë prej vitesh banesat sociale nuk ndahen për banorët e pastrehë rom, por për pjesën tjetër të popullsisë. Në Raportin Vjetor 2013 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, theksohet angazhimi që duhet të ketë vendi ynë në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit, për të përmirësuar shpejt kushtet e jetesës të komunitetit Rom dhe për këtë është thelbësor koordinimi i administratës publike në nivel qendror dhe vendor<sup>18</sup>.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të ankesave të regjistruara, i ka dërguar rekomandime pushtetit vendor për të marrë masa pozitive për komunitetin rom në mënyrë që kërkesat e tyre të trajtohen me përparësi<sup>19</sup>. Shpërngulja e familjeve rom nga

<sup>16</sup> Progres-Raport 2013 për Shqipërinë, fq. 56, [www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al)

<sup>17</sup> Konkluzionet e Komitetit të të Drejtave Sociale, Ekonomike dhe Kulturore, 18 dhjetor 2013, fq.4

<sup>18</sup> Marrë nga Progres Raport 2013 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, [www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al).

<sup>19</sup> Referohu pjesës së “Rekomandimeve për Përmirësimin e Situatës”

vendbanimet e tyre në gusht 2013 ka qenë një çështje veçanërisht shqetësuese<sup>20</sup>. Në funksion të zgjidhjes së situatës, kemi ndërhyrë me rekomandimet përkatëse Drejtuar Policisë së Qarkut Tiranë dhe Bashkisë së Tiranës<sup>21</sup>. Në fushën e strehimit problematika janë evidentuar edhe në legjislacionet përkatëse. Kriteret e vendosura për të përfituar banesat sociale, janë të vështira, gati të pamundura për t'u përmbushur nga personat që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Kjo gjë bën që ata të mos kenë mundësi të përfitojnë nga sistemi i mbrojtjes sociale që ofrohet për publikun e gjerë.

Një tjetër problematikë e evidentuar është diskriminimi në fushën e arsimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikon detyra të posaçme për Ministrinë e Arsimit dhe përcakton shprehimisht nxjerrjen e akteve nënligjore nga MASH<sup>22</sup> për eliminimin e diskriminimit në fushën e arsimit. Pavarësisht se Ligji “Për arsimin para-universitar” dhe aktet nënligjore përkatëse lehtësojnë regjistrimin e fëmijëve rom në shkolla edhe pa çertifikatë lindje, është vëne re një hezitim nga ana e shkollave 9-vjeçare për të zbatuar këtë rregull. Projektit “shansi i dytë” përcakton mundësinë e shkollimit edhe kur nuk është realizuar në kohën e duhur, megjithatë, Komisioneri në disa raste ka evidentuar shkolla që kanë kundërshtuar që të pranojnë nxënës që u përkasin këtyre komuniteteve. Duke marrë shkas nga ankesat e viteve të mëparshme, KMD ka realizuar gjatë vitit 2013 një monitorim për të parë shpërndarjen e nxënësve rom në shkollat 9-vjeçare në Tiranë. Komisioneri, pas analizës së bërë në lidhje me shpërndarjen e fëmijëve rom në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Tiranës, konstatoi se nuk kishte ndonjë tendencë të veçimit apo përqendrimit të fëmijëve rom në një shkollë të vetme<sup>23</sup>.

Mjaft e përhapur është edhe situata e braktisjes së shkollës nga ana e nxënësve romë. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ka dalë me shqetësimin për mungesën e masave për të adresuar në mënyrë efektive normat më të larta të braktisjes së arsimit fillor nga vajzat, në krahasim me djemtë, gjë që ndikon në mënyrë disproporcionale tek fëmijët romë<sup>24</sup>. Për të garantuar të drejtën e fëmijëve dhe për të siguruar akses të barabartë, Drejtoritë Arsimore Rajonale kanë për detyrë të zbatojnë me përparësi për komunitetin rom udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës<sup>25</sup> nr. 29, datë 02.08.2013 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme” dhe udhëzimin nr. 31, datë 02.08.2013, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë”.

Romët dhe Egjiptianët kanë problematika të dukshme në punësim. Pavarësisht se romët janë të përfshirë në planet e veprimit të pushtetit vendor ose në strategjitë kombëtare, ku parashikohet nxitja e punësimit të romëve, numri i të papunëve ngelet i lartë. Duhet theksuar se të rinjtë rom tashmë po arsimohen edhe në nivelet pasuniversitare. Në kuadër të kësaj problematike disa nga rekomandimet e fundit i janë drejtuar Zyrës Rajonale të Punësimit Shkodër, Bashkisë Kukës dhe Lezhë për nxitjen e punësimit të romëve dhe Egjiptianëve.

<sup>20</sup> Ky shqetësim është adresuar edhe në konkluzionet e Komitetit të të drejtave ekonomike, Sociale dhe kulturore, 18 dhjetor 2013.

<sup>21</sup> Referohu pjesës se “Rekomandimeve” të Raportit Vjetor të KMD-së.

<sup>22</sup> Sot emërtimi zyrtar është “Ministria e Arsimit dhe Sportit”.

<sup>23</sup> Për një informacion më të plotë për monitorimin e kryer referohu fq. 52, të këtij Raporti.

<sup>24</sup> Konkluzionet e Komitetit të të Drejtave Sociale, Ekonomike dhe Kulturore, 18 dhjetor 2013

<sup>25</sup> Sot emërtimi zyrtar është Ministria e Arsimit dhe Sportit

Edhe në konkluzionet e Komitetit të drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, është theksuar se mungesa e aksesit të romëve në punësim është edhe si pasojë e faktit, që prioritetet shtetërore nuk zbatohen në nivel lokal<sup>26</sup>.

Problematikat e evidentuara me sipër, janë në të njëjtën linjë me rekomandimet që anëtarët e shoqatave rome dhe egjiptiane kanë ngrit gjatë Konferencës me teme: “*Mbrojtja nga Diskriminimi: Modelet pozitive dhe sfidat*” të datës 07.11.2013.

Disa nga problematikat e dala gjatë këtij grupi pune janë: - Komuniteti Rom ka problematika në fushën e strehimit; - Ndhurma ekonomike e cila përfitohet nga ky Komunitet është shumë e vogël;- Media duhet të jetë me e ndjeshme ndaj problematikave të romëve; -Duhet të hartohet një strategji e posaçme për egjiptianët;- Kuotat në universitete janë shumë të ulta për romet dhe egjiptianët; - Ka shumë burokraci në marrjen e vërtetimit të papunësisë në kuadër të marrjes së ndihmës ekonomike.

### **I.2.2. Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar<sup>27</sup>**

Ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara “*Për të drejtat e personave me aftësi të Kufizuar*” ka intensifikuar veprimet dhe përpjekjet e të gjithë aktorëve të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Vizibiliteti i personave me aftësi të kufizuar është rritur ndjeshëm dhe po ashtu është rritur ndërgjegjësimi për çështjet dhe problematikat që prekin këta persona. Megjithatë, njerëzit me aftësi të kufizuara vazhdojnë të jenë në disavantazh në krahasim me qytetarët e tjerë.

Diskriminimi ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara ekziston në të gjitha sferat e jetës publike dhe private, e theksuar kryesisht në fushën e punësimit, arsimimit, aksesit në shërbime dhe strehimi, aksesueshmëria fizike dhe ajo në informacion. Gjendja e njerëzve me aftësi të kufizuara mund të shihet përmes nivelit të lartë të papunësisë, arsimimit të ulët, varfërisë, nën- përfaqësimit në jetën publike, aksesit të kufizuar në ndërtesat publike, shërbime, dhe rreziqet e institucionalizimit apo dhënies së shërbimeve jashtë standarteve.

Në situatën aktuale një nga vështirësitë e trajtimit të çështjeve të aftësisë së kufizuar është edhe fakti se legjislacioni aktual nuk ka një përkufizim për aftësinë e kufizuar, por ligje të ndryshme kanë parashikime të ndryshme, duke sjellë diskriminim midis kategorive të aftësisë së kufizuar. Konventa e OKB-së ka pranuar se *aftësia e kufizuar është një koncept evolues*. Në bazë të Konventës aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët. Konventa nuk ka dhënë një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por siguron një përshkrim të gjerë të paaftësisë. Pikërisht kjo është qasja që duhet ndjekur edhe në legjislacionin e brendshëm, duke bërë një përkufizim të aftësisë së kufizuar gjithëpërfshirës dhe jo përjashtues, në mënyrë që të shmangen përjashtimet midis kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

<sup>26</sup> Konkluzionet e Komitetit të drejtave Sociale, Ekonomike dhe Kulturore, 18 dhjetor 2013, fq.3

<sup>27</sup> Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, nga ana e personave me aftësi të kufizuara, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e OKB menjëherë pas ratifikimit të saj nga shteti Shqiptar, Komisioneri vlerëson se duhet adresuar me prioritet çështja e reformës së komisioneve që bëjnë përcaktimin e aftësisë së kufizuar, duke kaluar nga modeli mjekësor- i dëmtimit, tek modeli bio-psiko-social dhe ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe rehabilituese. Sipas nevojës për ndërhyrje vlerësojmë se duhet të vijohet me ndërhyrjet në fushën e arsimit, pasi niveli i ulët arsimor i personave me aftësi të kufizuara përbën një nga pengesat për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në *arsimin* e detyrueshëm është 2400 (përfshirë këtu edhe nxënësit me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollat speciale). Ky numër përbën vetëm 0.5 % të numrit të përgjithshëm të fëmijëve të regjistruar në arsimin e detyruar.<sup>28</sup>

Ndërkohë sipas një studimi të realizuar nga *Save the Children*, numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla 9-vjeçare të zakonshme për vitin shkollor 2011-2012 rezulton të jetë: 511 fëmijë në kopshtet e zakonshme që përbën 0.49 % të numrit total (103 492) të fëmijëve që frekuentojnë kopshtet e zakonshme; 3167 fëmijë në shkollat e zakonshme 9-vjeçare që përbën 0.64 % të numrit total (472 892) të fëmijëve që frekuentojnë shkollat e zakonshme 9-vjeçare. Pra, numri total i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm është 3678 fëmijë, që përbën vetëm 0.63 % të numrit total prej 576 383 të fëmijëve që frekuentojnë arsimin e zakonshëm<sup>29</sup>.

Ligji “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në vitin 2012, duke sanksionuar se parimi bazë në sistemin arsimor është ai i gjithpërfshirjes, garanton dhe lejon përfshirjen e sa më shumë fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme. Gjatë vitit 2013 janë miratuar Dispozitat Normative “Për Sistemin Arsimor Para-universitar”, ku janë parashikuar në mënyrë më të hollësishme procedurat dhe rregullat për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Edhe pse tashmë ka një rregullim të hollësishëm ligjor dhe me akte nënligjore, Komisioneri ka konstatuar se këto parashikime ligjore për arsimimin njihen shumë pak, për të mos thënë aspak, nga drejtuesit e institucioneve arsimore dhe Drejtoritë dhe Zyrat Rajonale Arsimore, të cilat kanë rolin kryesor në zbatimin e tyre.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ndalon refuzimin për të pranuar në një institucion arsimor për shkak të aftësisë së kufizuar. Megjithë përmirësimin e kuadrit ligjor, nga praktika Komisioneri ka konstatuar se ka raste kur fëmijëve me aftësi të kufizuara iu refuzohet pranimi në shkollat e zakonshme. Gjatë praktikës së tij Komisioneri ka konstatuar diskriminimin e fëmijës me aftësi të kufizuar për shkak të dështimit të strukturave përgjegjëse për të bërë vlerësimin individual të nevojave të nxënësit nëpërmjet Komisioneve Multidisiplinare, në zbatim të parashikimeve ligjore që rregullojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara<sup>30</sup>.

Personat me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe të folur kanë qenë dhe janë një nga grupet brenda aftësisë së kufizuar, problematikat e të cilëve kanë qenë jashtë vëmendjes së autoriteteve përgjegjëse dhe marrjes së masave nga ana e këtyre të fundit për të adresuar

<sup>28</sup> [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

<sup>29</sup> Studim Analitik “Arsimi gjithëpërfshirës në Shqipëri” realizuar nga organizata Save the Children, në kuadër të projektit “Promovimi i arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

<sup>30</sup> Vendimi Nr. 92 datë 25.10.2013 Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

problematikat e tyre. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ngarkon Këshillin e Ministrave dhe Ministrin e Arsimit dhe Shkencës<sup>31</sup>, me përgjegjësi për marrjen e masave për respektimin dhe sigurimin e së drejtës për arsimim në mënyrat e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.<sup>32</sup> Ligji “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” po ashtu parashikon se nxënësve, që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Brail. Komisioneri ka dërguar në qershor të vitit 2012, rekomandime për grupin e punës të ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit, nr. 52, datë 23. 04. 2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02, 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe të kryesuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ku ndër të tjera i ka rekomanduar marrjen e masave për zyrtarizimin e gjuhës shqipe të shenjave.

Nisma e ndërmarrë për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave<sup>33</sup>, shënon një hap pozitiv në drejtim të mbrojtjes nga diskriminimi, të personave me aftësi të kufizuar, jo vetëm në arsim, por në çdo aspekt të jetës. Barrierat në komunikim çojnë në përjashtimin e këtyre personave nga shumë fusha të jetës dhe bëhen pengesë për gëzimin në baza të barabarta me të tjerët të shumë të drejtave dhe shërbimeve që ofrohen për publikun.

Mungesa e aksesit në ndërtesat dhe hapësirat publike vazhdon të jetë një nga barrierat kryesore për të arritur barazinë e personave me aftësi të kufizuara. Barrierat fizike shkaktojnë shkeljen e barazisë dhe çojnë në situata diskriminuese në të gjitha sferat e jetës, duke prekur si sektorin publik ashtu edhe atë privat.

Një nga fushat kryesore në jetën e çdo personi është *pjesëmarrja në jetën publike dhe politike*. E drejta për të votuar është një e drejtë kushtetuese. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet<sup>34</sup>. Kjo do të thotë se çdo person me aftësi të kufizuar ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet në baza të barabartë me të tjerët.

Në bazë të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, shtetet, përfshirë këtu edhe shtetin shqiptar, kanë marrë përsipër që të respektojnë, të mbrojnë dhe të garantojnë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Pra, detyrimet e shtetit nuk qëndrojnë vetëm në detyrimin për të respektuar dhe mbrojtur këto të drejta, por shteti ka detyrimin që të marrë të gjitha masat e përshtatshme dhe të duhura, qofshin këto legjislative, administrative, buxhetore, gjyqësore apo çdo veprim tjetër që është i nevojshëm për të garantuar realizimin e plotë të këtyre të drejtave. Ndryshe nga të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore të cilat shtetet kanë detyrimin që t’i respektojnë dhe mbrojnë në mënyrë të menjëhershme, por t’i përmbushin apo realizojnë në mënyrë progresive, të drejtat politike, janë të drejta që shtetet kanë detyrimin për t’i realizuar në mënyrë të menjëhershme. E drejta e votës si një e drejtë politike duhet siguruar nga shteti në mënyrë të menjëhershme dhe siguri i saj kërkon ndërhyrjen dhe marrjen e masave nga ana e shtetit.

Udhëzimi nr. 01, datë 12.12.2012 “Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësive të qeverisjes vendore për zgjedhjet” i

<sup>31</sup> Sipas emërimit që bëhet nga Ligji nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>32</sup> Neni 18, pika 2, germa “ç” e ligjit.

<sup>33</sup> Urdhri Nr. 232 datë 02.12.2013 i Kryeministrit “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të punës për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>34</sup> Neni 45 i Kushtetutës.

miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmirësoi ndjeshëm situatën ligjore të procesit të zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit 2013. Megjithatë, ashtu siç kemi rekomanduar në Raportin Vjetor 2012, për një zbatim efektiv të tij, kërkohet angazhim nga ana e qeverisjes vendore dhe një koordinim midis të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor. Në kuadër të procesit të përgatitjes për zgjedhjet e 23 qershorit KMD ka kërkuar informacion nga KQZ, lidhur me masat e marra për të garantuar votimin e personave me aftësi të kufizuara<sup>35</sup>. Nga informacioni i dërguar rezultoi se KQZ<sup>36</sup> nuk kishte krijuar një procedurë apo një mekanizëm për të mbikëqyrur respektimin e vendosjes së qendrave të votimit në katet e para të vendndodhjeve /godinave të përcaktuara si qendra votimi.

Mungesa e aksesit fizik në qendrat e votimit ka qenë një nga shkaqet që ka shkaktuar diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara gjatë zgjedhjeve të 23 qershorit 2013. Gjatë vitit 2013, Komisioneri, ka trajtuar dy ankesa për diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar, ku ka konstatuar diskriminim për shkak të mungesës së aksesit fizik në qendrat respektive të votimit<sup>37</sup>.

Pavarësisht angazhimit nuk u arrit që zgjedhësit me aftësi të kufizuara në shikim të votonin përmes fletëve të votimit të përshtatura në shkrimin *Brail*.

Me gjithë hapat pozitive të ndërmarrë në drejtim të përmirësimit të legjislacionit, por edhe të problematikave që akoma vazhdojnë të ndeshin personat me aftësi të kufizuara për të realizuar një nga te drejtat themelore, siç është e drejta për të votuar, një shqetësim i madh, janë zgjedhësit me aftësi të kufizuara, të cilët për shkak të gjendjes së tyre të rënduar shëndetësore nuk mund të dalin nga shtëpia. Legjislacioni aktual që rregullon procesin zgjedhor nuk lë hapësirë për votimin e zgjedhësve jashtë qendrave të votimit, siç mund të jetë rasti i personave që nuk mund të dalin nga shtëpia. Kjo situatë sjell nevojën e adresimit të rekomandimeve për ndryshime në Kodin Zgjedhor, në mënyrë që të mundësohet votimi i këtyre personave.

Sipas Raportit final të OSBE/OHDIR për zgjedhjet parlamentare 2013, 630 qendra votimi (44 %) janë vlerësuar si jo lehtësisht të aksesueshme për votuesit me aftësi të kufizuara, çka është domethënëse duke pasur parasysh mungesën e dispozitave për votimin e zgjedhësve që janë të izoluar në shtëpi.

Aksesi fizik i ndërtesave publike shkakton gjithashtu diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në *fushën e të mirave dhe shërbimeve*, veçanërisht aksesin në institucionet shëndetësore, shërbime të cilat janë jetike për personat me aftësi të kufizuara. Problematikë me të cilën ndeshen personat me aftësi të kufizuara dhe që ka nevojë të adresohet është edhe plotësimi i shërbimit mjekësor me mjekë specialistë. Është konstatuar gjatë çështjeve të trajtuara se *mungon* një bashkëpunim ndërministror dhe i strukturave rajonale për një *shërbim me standarte* për fëmijët me aftësi të kufizuara pranë qendrave rezidenciale shtetërore, nën varësinë e Shërbimit Social Shtetëror.

<sup>35</sup> Shkresa nr. 172 prot , datë 06.03.2013 drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

<sup>36</sup> Shkresa nr. 2488/1 prot, datë 11.03.2013, "*kthim përgjigje*" nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve.

<sup>37</sup> Vendimi Nr. 101 date 18.10.2013 dhe Nr.100 datë 14.10.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pozitive vlerësohet Urdhri nr. 239, datë 11.12.2013 i Kryeministrit “ *Për ngritjen e grupit ndërministror për zbatimin e rregullave të përshtatshëmrisë ndërtimore në institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore*”.

Situata e personave me aftësi të kufizuara në përfitimin e të mirave që ofron skema e mbrojtjes sociale dhe konkretisht të përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuara, ka vazhduar të jetë problematike edhe për vitin 2013. Gjatë vitit 2012 kanë ndodhur ndryshime në dy ligjet që rregullojnë statusin e personave me aftësitë kufizuara në lëvizje dhe në shikim dhe konkretisht në Ligjin 8626 date 22.06.2000 “*Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*” të ndryshuar dhe Ligjin nr. 8098 datë 23.03.1996 “*Për statusin e të verbrit*”. Ndryshimet e bëra në këto dy ligje kërkonin nxjerrjen e akteve nënligjore. Akte nënligjore për përcaktimin e masës, kriteret dhe procedurat e përfitimit të kompensim për shërbimin e transportit, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, akoma nuk kanë dalë. Vonesa në nxjerrjen këtyre akteve nënligjore ka rënduar ndjeshëm situatën e këtyre personave, në shumë fusha të jetës, por veçanërisht në fushën e shërbimeve shëndetësore. Në mjaft prej spitaleve rajonale ka mungesa të mjekëve specialistë, fakt që i detyron këta persona që të udhëtojnë në qytetet të tjera për të marrë shërbimin e nevojshëm. Në kushtet e mungesës së kompesimit të transportit dhe gjëndjes ekonomike përgjithësisht jo të mirë të personave me aftësi të kufizuara, marrja e shërbime të specializuara në ato spitale rajonale ku janë mjekët sipas specialiteteve, vështirësohet ose bëhet e pamundur.

*Punësimi* i personave me aftësi të kufizuara vazhdon të jetë problematik. Problematikat e personave me aftësi të kufizuara janë aq të mëdha dhe të thella, sa që edhe pse në realitet rezulton të jetë mjaft i errët, pranë institucionit të Komisionerit nuk raportohet asnjë ankesë për diskriminim nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Komisioneri vlerëson se ky nënraportim i ankesave për diskriminim në fushën e punësimit nga ana e personave me aftësi të kufizuara, nuk tregon mungesën e diskriminimit, por duhet parë si një tregues për të përqendruar vëmendjen drejt këtij problemi, jo vetëm institucioni i KMD-së, por edhe të gjitha strukturat e tjera shtetërore.

### **I.2.3. Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor**

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të komunitetit LGBT ka në themel një parim të rëndësishëm që ka të bëjë me pranimin se LGBT gëzojnë të njëjtat të drejta si çdo person tjetër për mosdiskriminim dhe ushtrim të të drejtave njerëzore. Respektimi i të drejtave të këtij komuniteti ka qenë vazhdimisht pjesë e detyrimeve të Shqipërisë gjatë procesit të integritit evropian. “*Forcimi i mbrojtjes së personave gej, lesbike, biseksuale dhe transgjendër*” ka qenë pjesë e Planit të Veprimit për Adresimin e Rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe është aktualisht pjesë e Planit të Veprimit për zbatimin prioritetit 5 “*Të drejtat e Njeriut*”, për procesin e integritit në Bashkimin Evropian.

Për të analizuar më qartë mund të themi se ndër pengesat kryesore që ka komuniteti janë: Gjuha e urrejtjes, veçimi i tyre, fyerja dhe përbuzja në ambientet publike dhe trajtimi i këtyre individëve si njerëz të “*sëmure*”.<sup>38</sup>

<sup>38</sup> **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.** Ndërkaq, Komiteti ka rekomanduar, *ndër të tjera*, që shteti palë duhet të intensifikojë përpjekjet për të luftuar stereotipet dhe paragjykimet kundër personave LGBT. Referohu tek kuadri ligjor.



Anëtarë të komunitetit bëhen viktime të incidenteve me bazë urrejtje (në vende publike dhe familje). Ka raste që ndeshen me ngacmime nga policia edhe kur në fakt kërkohet mbrojtja apo shërbimi i tyre. Janë verifikuar raporte për ngacmime të personave LGBT dhe sjellje brutale nga ana e policëve kundër punonjësve transgjnorë të seksit<sup>39</sup>. Komisioneri ka identifikuar disa raste të ushtrimit të dhunës nga familjarët apo të ushtrimit të dhunës verbale dhe fizike nga persona të pidentifikuar. Gjithashtu janë deklaruar pranë zyrës së Komisionerit ankesa për mos ofrimin e shërbimeve të kërkuara nga oficerët e policisë nga ana e përfaqësuesve të komunitetit ose kryerja e tyre vetëm pas ndërhyrjeve të OJF-ve që ofrojnë ndihmë për këta persona. Theksojmë se komuniteti transgjendër, ndonëse i vogël në numër paraqet problematika të mëdha që kanë të bëjnë me strehimin, punësimin, arsimin e sidomos me kujdesin shëndetësor. Krimet për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjnor nuk reflektohen si krime homofobike në statistikat zyrtare; vetëm në Maj 2013 është parashikuar shprehimisht si vepër penale (neni 265) apo si rrethanë rënduese (neni 50/j).

Jo në pak raste debati mbi të drejtat e komunitetit LGBT është shoqëruar me debate deri në përdorimin e “gjuhës së urrejtjes”. Theksojmë se “gjuha e urrejtjes” kundër personave gay lesbike, biseksuale dhe transeksuale (komuniteti LGBT), ka të bëjë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura si nëpërmjet medias, ashtu edhe nëpërmjet internetit, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj njerëzve LGBT.<sup>40</sup> Vlerësimi nëse shprehje apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “gjuhë e urrejtjes”, duhet të bëhet në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës. Një “gjuhë urrejtje” e tillë, duhet të ndalohej dhe publikisht të kundërshtohet kurdo që ndodh. Gjithë masat duhet të respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes, në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe jurisprudencën e Gjykatës.

Komuniteti i Lezbikeve, Gejve, Biseksualëve e Transgjnorëve në Shqipëri, duhet të gëzojë të drejta e liri në mënyrë të barabartë me të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. Të drejtat e njeriut janë universale dhe zbatohen për të gjithë individët, çdo vend duhet të garantojë dinjitet të barabartë për të gjithë qeniet njerëzore pa diskriminim. Shumë individë janë të stigmatizuar, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjnor të tyre dhe nuk mund të gëzojnë plotësisht të drejtat universale të njeriut.

Në Shqipëri nuk ka pengesa ligjore për komunitetin LGBT për t’u organizuar në shoqata. Ekzistojnë katër OJF që përfaqësojnë komunitetin LGBT apo e kanë fokusuar aktivitetin e tyre në mbrojtje të këtij komuniteti. Realizimi i aktiviteteve dhe tubimeve nuk është penguar ligjërisht. Ushtrimi i të drejtave të mësipërme ka njohur një zhvillim pozitiv. Ndërsa në 17 Maj 2010 në Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë një grup përfaqësuesish të shoqërisë civile dolën së bashku në një konferencë për shtyp, në vitin 2012 dhe 2013 realizohen aktivitete në mjediset publike, me përfaqësues nga komuniteti LGBT, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri dhe përfaqësues të institucioneve të pavarura dhe qeveritare. Ka pasë një anashkalim të përfaqësuesve të këtij komuniteti për të bërë prezent, para institucioneve publike, opinionin dhe problematikat e këtij komuniteti. Por, gjatë këtyre

<sup>39</sup> Human Rights Report - Albania (May 24, 2012), Ambasada Amerikane.

<sup>40</sup> Komiteti i Ministrave, rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të të drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjnor të tyre. Në kuadër të garantimit të kësaj të drejte, rekomandohet që: “Shtetet anëtare duhet të marrin masat e duhura për të luftuar të gjitha format e shprehjes, duke përfshirë, në media dhe në internet, të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se ka gjasa për të prodhuar efektin e nxitjes, përhapjen ose nxitjen e urrejtjes apo të tjera forma të diskriminimit kundër personave gay lesbike, biseksuale dhe transeksuale.

viteve ky qëndrim ka ndryshuar. Në mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë të datës 09.12.2013 përfaqësues të komunitetit LGBT ishin pjesë e seancës dëgjimore për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Nga praktika e Komisionerit është vënë re se, qytetarët nuk janë të mirë-informuar mbi komunitetin LGBT dhe gjithashtu ka një homofobi të theksuar kundrejt këtij komuniteti, shpesh kjo homofobi vërehet edhe tek nëpunësit e shërbimit civil. Duke theksuar faktin se ky komunitet konsiderohet i “ri” në vendin tonë dhe nuk ka raporte, analiza konkrete për këtë komunitet. Një pengesë e madhe është dhe fakti se nuk ka pasur gjatë gjithë këtyre viteve një anketim dhe një studim të qartë dhe konkret mbi situatën e këtij komuniteti në vendin tonë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, një ndër prioritetet e punës së tij, ka dhe respektimin e të drejtave të personave të komunitetit LGBT. Në Raport Progresin e BE për Shqipërinë, është tërhequr vëmendja mbi një serë çështjesh dhe problematikash që ka shoqëria shqiptare në trajtimin e komunitetit LGBT. Në raport theksohet se: *“janë raportuar disa raste dhune dhe keqtrajtimi që kanë vënë në shënjestër persona të komunitetit transeksual, si dhe homofobia vazhdon të jetë gjerësisht e përhapur, madje edhe në radhët e zyrtarëve të shërbimit publik.”* Por gjithashtu në Raport Progresin e BE për Shqipërinë 2013 thuhet shprehimisht: Ekziston legjislacioni në fushën e politikave anti-diskriminuese - p.sh. lidhur me të drejtat e personave lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transeksual dhe ndërgjykorë (LGBT) - Autoritetet shqiptare duhet të zbatojnë edhe legjislacionin ekzistues edhe të hartojnë legjislacion të ri në fushën e anti-diskriminimit. Janë ndërmarrë një numër hapash konkretë. Ekziston një plan veprimi LGBT , si dhe është ndryshuar Kodi Penal që merr parasysh rrethanat rënduese për shkeljet me bazë gjinie, race, etnie, identiteti gjinor, orientimi seksual, besimi fetar, feje, statusi shëndetësor, predispozite gjenetike apo aftësie të kufizuar.<sup>41</sup>

**Arsimi.** Një nga risitë e ligjit *“Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë”* i miratuar në vitin 2012 është se tek shkaqet e diskriminimit është përfshirë edhe “orientimi seksual” përpos shumë shkaqeve të tjera<sup>42</sup>. Ky nen ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në Nenin 1 të Ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor para-universitar. Fëmijët dhe adoleshentët marrin “edukatë seksuale” vetëm në dy lëndë gjatë 12 viteve shkollor. Kurrikulat shkollore vazhdojnë të mbeten shumë konservatore në lidhje me çështjet e seksualitetit si e drejt, si gjendje natyrore apo si çështje sociale. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë të paprekura në sistemin arsimor aktual. Raportime të shumta nga komuniteti tregojnë se jo vetëm nxënësit por edhe mësuesit janë shpesh diskriminues ndaj personave LGBT. Shpesh ndodh që ata bënë legjitimues të sjelljeve homofobike dhe diskriminuese ndaj fëmijëve apo adoleshentëve LGBT.<sup>43</sup>

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar një monitorim mbi situatën e diskriminimit në Shqipëri duke përfshirë dhe komunitetin LGBT. Monitorimi u bë në disa qytete të Shqipërisë në sistemin para-universitar. Nga ky monitorim, i cili u realizua në formën e anketimit, u evidentua se ndër shkaqet kryesore të diskriminimit që nxënësit

<sup>41</sup> Progres Raport 2013 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin European dhe Këshillin, [www.mje.gov.al](http://www.mje.gov.al)

<sup>42</sup> Neni 5/ 1 i Ligjit nr.69/2012 *“Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë”*

<sup>43</sup> Marrë nga publikimi i PINK Embassy/ LGBT Pro Albania.

Financuar nga Programi MATRA, Ministria e Jashtme e Mbretërisë së Hollandës

rendisnin ishte dhe orientimi seksual me 7%. Kjo përqindje doli nga anketimi i zhvilluar në 3 shkolla 9-vjecare dhe 3 shkolla të mesme në gjashtë bashki.

Një ndër prioritetet e BE-së është dekriminalizimi i marrëdhënieve seksuale mes personave të të njëjtit seks. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) që prej vitit 1990 e ka hequr homoseksualitetin nga Klasifikimi Ndërkombëtar i Statistikave të Sëmundjeve dhe Problemeve lidhur me Shëndetin. Megjithatë personat me orientim seksual të ndryshëm janë konsideruar dhe vazhdojnë të konsiderohen akoma me pa të drejtë si persona të sëmurë ose që vuajnë nga ndonjë sëmundje. Shprehje se “homoseksualizmi është sëmundje” janë të pabazuara dhe dezinformojnë opinionin publik. Për më tepër në disa tekste shkollore homoseksualizmi trajtohet si sëmundje. Nuk kemi një studim mbi diskriminimin ndaj komunitetit LGBT në përmbajtjen e programeve mësimore të të gjitha niveleve, por as të përfshirjes në këto programe të informacionit mbi këtë komunitet. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar një çështje mbi përmbajtjen diskriminuese të një prej literaturave të përdorura nga dy fakultete në zhvillimin e një moduli të kurrikulës universitare.<sup>44</sup>

**Media**, ka shprehur një interes të veçantë ndaj çështjes LGBT dhe ka ndikuar ndjeshëm (pozitivisht & negativisht) në avancimin e kësaj kauze. Shpesh në raportimin e çështjeve ose lajmeve mbi LGBT ka keqinformim dhe përdorim të gabuar në terminologji.

**Punësimi**. Nuk ka raportime apo statistika për gjendjen e personave LGBT me punësimin. Aktualisht politikat e diversitetit nuk zbatohen për çështjet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Aktualisht asnjë institucion apo biznes nuk dihet të ketë hartuar politika specifike në të mirë të personave LGBT.<sup>45</sup> Nuk ka statistika që tregojnë nëse personat LGBT e deklarojnë hapur orientimin e tyre seksual apo identitetin gjinor në mjediset e punës. Raste individuale janë të suksesshme por edhe negative. Komuniteti LGBT raporton sjellje diskriminuese në mjediset e punës. OJF-të kanë raportuar disa herë për diskriminim dhe humbje të vendeve të punës për shkak të orientimit seksual.

Vëmë re se ka homofobi jo vetëm në ambientet shkollore apo të punës, por edhe në ofrimin e shërbimeve. Duhet vënë theksi tek shërbimet sidomos të shërbimit mjekësor ku shpeshherë ky shërbim u është mohuar personave LGBT, duke qenë një diskriminim i hapur ndaj këtij komuniteti. Diskriminimi ndaj personave LGBT lidhet me paraqitjen e tyre të jashtme ose sjelljen. Personat që nuk sillen ose nuk jetojnë sipas “normave” shoqërore, janë shpesh viktima të diskriminimit në të gjitha mjediset; familje, shkollë, punë, rrugë dhe mjedisë publike. Komuniteti ka raportuar për sjellje diskriminuese në njësi tregtare shërbimesh, përmes qëndrimeve armiqësore apo mohimit të ofrimit të shërbimit.<sup>46</sup>

Shqipëria nuk ka një strategji për mbrojtjen nga diskriminimi, por ka ndërmarrë masa konkrete me synim mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT dhe disa komuniteteve të tjera vulnerabël. Zyra e Komisionerit ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e “Planit të Masave për mosdiskriminimin për shkak të Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjinor 2012-2014”, duke dhënë kontributin e tij në propozimet për ndryshimet në kuadrin ligjor dhe për politikat anti-diskriminim në punësim, arsim dhe në fushën e të mira dhe shërbimeve. Disa nga masat e parashikuara në këtë plan, janë: trajnimi i administratës publike në qendër dhe në qeverisjen vendore me konceptet e reja dhe parimet e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi; organizimi i fushatave ndërgjegjëse/sensibilizuese, publikimeve vjetore, botime,

<sup>44</sup> Vendimi nr.11, datë 08.02.2013

<sup>45</sup> Marrë nga publikimi i PINK Embassy/ LGBT Pro Albania në partneritet me COC Netherlands dhe CRCA

<sup>46</sup> Vendimi nr.5, date 23.01.2014 (çështja ka filluar në 2013)

fletëpalosje, praktika të suksesshme kundër diskriminimit; marrja e masave konkrete nga institucionet publike dhe bizneset/aktivitetet private për garantimin e barazisë në bazë të ligjit anti-diskriminim; trajnime të specialisteve të zyrave të punësimit dhe të stafëve mësimore për çështjet LGBT.

#### I.2.4. Diskriminimi për shkak të gjinisë<sup>47</sup>

Ndërsa barazia është një komponent thelbësor i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, pabarazitë gjinore vazhdojnë të jenë prezent në shoqërinë tonë.

Një nga shkeljet më të rënda të barazisë gjinore është dhuna ndaj grave. *Dhuna ndaj gruas* është një formë e diskriminimit e cila i ka rrënjët në pabarazinë gjinore dhe e përforcon atë. GJEDNJ në çështjet e trajtuara prej saj për rastet e dhunës në familje, ka konstatuar përveç shkeljes së nenit 3 të KEDNJ-së, edhe diskriminim, pra shkelje të nenit 14, duke u shprehur se: *"dështimi i Shtetit për të mbrojtur gratë kundër dhunës në familje shkel të drejtën e mbrojtjes së barabartë nga ligji" pavarësisht nëse ky dështim është apo jo i qëllimshëm. Gjykata thekson se dështimi i autoriteteve për t'u marrë me dhunën në familje në mënyrë të përsëritur, reflekton një qëndrim diskriminues ndaj grave*<sup>48</sup>. Sipas një studimi të INSTAT, 27, 6% e grave raportuan se dhuna kishte filluar pas martesës. Gratë e keqtrajtuara shpesh nuk janë të gatshme të flasin hapur për dhunën në familje. Vetëm 8,4% e grave të dhunuara "gjatë jetës" dhe 7,1% e grave të dhunuara "aktualisht" ishin përpjekur të kërkonin ndihmë. Sipas të dhënave të këtij studimi rezultoi se gratë me arsim fillor ose më të ulët kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje, ndërsa gratë me arsim universitar kishin më pak gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje<sup>49</sup>. Ky vërtetim tregon modele dhe tendenca të rëndësishme për natyrën dhe shtrirjen e dhunës. Një aspekt tjetër i rëndësishëm në luftën kundër dhunës ndaj gruas është nevoja urgjente për të dhëna të krahasueshme për dhunën në baza gjinore, duke përfshirë këtu jo vetëm të dhëna për viktimat, por edhe për shkaktarët e kësaj dhune. Mund të themi se Shqipëria ka tashmë një legjislacion të mirë në fushën e mbrojtjes nga dhuna në familje. E rëndësishme është zbatimi efikas dhe me standarte të këtij legjislacioni.

KMD ka konstatuar diskriminim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë për shkak të gjinisë, për shkak të shtatzënisë në marrëdhëniet e punësimit dhe trajtimin gjatë këtyre marrëdhënieve, qoftë nga organet e administratës shtetërore dhe nga subjektet private. Diskriminimi në ofrimin e shërbimeve si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike ka sjellë në vëmendjen e KMD-së nevojën për një rishikim të kontratave tip të hartuara nga entet rregullatore, sidomos dispozitat mbi "klientin familjar", duke përcaktuar në mënyrë të qartë kush përfshihet në këtë koncept.

Vitet e fundit janë ndërmarrë masa pozitive për fuqizimin e grave, kryesisht në sektorin ekonomik. Megjithatë aksesin në kredi në kredite, hua bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kreditit financiar është ende i ulët. Kryesisht kërkesa për kredi dhe huamarrje është

<sup>47</sup> Diskriminimi për shkak të gjinisë është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, që bazohet në gjininë e personit, dhe ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në mënyrë të barabartë nga secila gjini, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

<sup>48</sup> Eremia dhe të tjerët kundër Republikës së Moldavisë ( Kërkesa nr.. 3564/11)

<sup>49</sup> Dhuna në familje në Shqipëri : Vërtetim kombëtar me bazë popullatën 2013. INSTAT

tipike e meshkujve<sup>50</sup>. Ata janë individët që veprojnë me cilësinë e kryefamiljarëve, duke vështirësuar pozitën e femrave në marrjen e kredive. Aksesit i kufizuar i grave në format e kreditit financiar është i lidhur ngushtësisht edhe me një praktikë të përhapur në shoqërinë tonë, ku prona regjistrohet më së shumti në emër të mashkullit, i cili vepron edhe në cilësinë e kryefamiljarit.

Kjo praktikë diskriminuese është evidente gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”. Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 në nenin 4 pika 10, vendos një kriter diskriminues bazuar në gjininë e personit përmes përkufizimit që bën për termin “*Kryetar të familjes*”, duke vendosur babain në krye të hierarkisë për t’u cilësuar kryetar familje e për pasojë edhe si personi që përfiton ndihmën ekonomike. Sipas renditjes që bën ky ligj automatikisht kryefamiljar është burri dhe vetëm në mungesë të tij radha kalon tek gruaja – nëna. Komisioneri në zbatim të kompetencave të tij, po përgatit rekomandimet përkatëse për ta sjellë këtë ligj në përputhje me Ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Kjo çështje është konstatuar edhe në vërejtjet përmbyllëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, i cili ka bërë thirrje për fuqizimin e përdorimit të masave të përkohshme dhe të veçanta, në pajtim me Nenin 4, paragrafi 1, të Konventës CEDAW. Ky Komitetet ka rekomanduar që: “*Masat e përkohshme dhe të veçanta të zbatohen me qëllim që të sigurojnë barazinë e grave dhe burrave në mundësimin e pasurisë, kapitalit dhe kredive, etj., veçanërisht në lidhje me gratë që u përkasin grupeve të privuara, duke përfshirë gratë dhe vajzat që u përkasin minoriteteve gjuhësore dhe etnike, gratë e moshuara, gratë me aftësi të kufizuara, dhe gratë që banojnë në zonat rurale dhe të largëta*”. Gjithashtu, lidhur me gjendjen e aksesit të grave në prona, hua dhe kredi, është realizuar në vitin 2012 nga UN Women në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, një studim mbi të drejtat pronësore të grave në Shqipëri, në të cilin është konstatuar e njëjta problematikë.

Për sa i përket pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, megjithë angazhimin për vendosjen e kuotës gjinore, sipas parashikimeve në nenin 67/6 të Kodit Zgjedhor, në vitin 2013 në Legjislaturën e VIII-të të Kuvendit, gratë janë të përfaqësuara në nivelin 18%<sup>51</sup>. Pavarësisht respektimit të kriterëve të vendosura nga neni 67 i Kodit Zgjedhor, në praktikë një parashikim i tillë tregon se ka një boshllëk ligjor. Formula e vendosur për listat shumëmemërore të kandidatëve “*të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë secilës gjini*” nuk garanton respektimin e kuotës gjinore prej 30 %. Lidhur me këtë problematikë, por jo vetëm, Komisioneri ka përgatitur disa rekomandime që do t’u dërgohen autoriteteve kompetente gjatë vitit 2014. Lidhur me pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje, nga të dhënat e paraqitura në botimin e INSTAT, “Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2013”, vihet re tendenca që me rritjen e pozicionit apo nivelit drejtues, kemi një zvogëlim të pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese. Kështu nga 55 ambasadorë vetëm 6 janë femra, kurse 49 janë meshkuj; nga 13 Rektorë vetëm 1 është femër, kurse 12 janë meshkuj; gjyqtarët dhe prokurorët meshkuj janë më të shumtë në numër se sa gjyqtarët apo prokurorët femra, dhe diferenca rritet me rritjen e niveleve drejtuese; të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë meshkuj (15); dhe raporti gjinor i anëtarëve të Gjykatës së Lartë është 12 meshkuj dhe 4 femra.

<sup>50</sup> Shih studimet e kryera nga Qendra Shqiptare për Studime Ekonomike (ACER) dhe nga Shoqata e Grave Afariste dhe Profesioniste në vitin 2006. Sipas studimit të SHGAP konkludohet se gratë që kanë marrë kredi nga bankat kanë hasur pengesa. Pengesat kanë qenë të lidhura me biznesin të cilin ato zhvillojnë [81,3%]; me përgatitjen e plan biznesit [76,7 %], me përgatitjen e dokumenteve bankarë [72.7%] dhe me termat e kolateralit [70%].

<sup>51</sup> Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2013, Botim i INSTAT.

### **I.2.5. Diskriminimi i shumëfishtë**

Diskriminimi i shumëfishtë është një situatë ku një individ përjeton diskriminim për më shumë se një shkak. Me fjalë të tjera, një person jo vetëm mund t'i përkasë një minoriteti të caktuar, por ka edhe një moshë të caktuar dhe njëkohësisht gjinia mund të shtojë vulnerabilitetin e individit për të qenë viktimë e diskriminimit. Për shembull, një grua që i përket një pakice etnike mund të preket nga diskriminimi në një mënyrë të ndryshme nga një mashkull që i përket një pakice etnike. Një grua e moshuar mund të diskriminohet në vendin e punës për shkak të gjinisë si dhe në përfitimin e shërbimeve shëndetësore për shkak të moshës, ose një grua rome gjatë lindjes në spital mund të diskriminohet për shkak të gjinisë (jo të gjitha gratë diskriminohen) dhe njëkohësisht për shkak të përkatësisë etnikë (jo të gjitha gratë rome përballen me situata të tilla). Karakteristika të tjera personale ose rrethana të caktuara si aftësia e kufizuar, gjendja ekonomike, gjithashtu ndikojnë në ekspozimin e dikujt ndaj sjelljeve diskriminuese dhe përvojën e diskriminimit. Për shembull, kur një grua me aftësi të kufizuara që i përket komunitetit rom, refuzohet për dy ose më shumë prej këtyre shkaqeve, kur aplikon për një punë. Komisioneri në disa raste ka evidentuar se shkollat kanë kundërshtuar që të pranojnë nxënës romë, veçanërisht kur ata ishin të varfër. Gjendja ekonomike rezulton të jetë një shkak që ndikon pothuajse në vulnerabilitetin e çdo individi për të qenë viktimë e diskriminimit, prandaj ajo duhet të adresohet në çdo politikë që ndërmarrin autoritetet për grupe të caktuara të shoqërisë, si gratë, fëmijët apo komunitetin rom/egjiptian, personat me aftësi të kufizuara etj.

## KAPITULLI II

### VEPRIMTARIA E KMD-SË NË MBROJTJEN NGA SJELLJET DISKRIMINUESE DHE PROMOVIMIN E BARAZISË

Me miratimin e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë në aspektin e kuadrit ligjor njohën një stad të ri të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ky ligj ka parashikuar krijimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si institucioni i cili “siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin” (Neni 21, pika 1). Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit (Neni 22). Nëse i referohemi kompetencave që ligji i njeh këtij institucioni do t’i gruponim si më poshtë:

- *Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim*, ku përfshihen: shqyrtimi i ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar ose nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi; kryerja e hetimeve administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit; vendosja e sanksioneve administrative sipas përcaktimit të këtij ligji; parashtrimi i mendimit me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin e investuar në saje të kërkesës së gjykatës që shqyrton çështjen; përfaqësimi i ankuesit në organet gjyqësore në çështjet civile me miratimin e tij në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të këtij ligji.
- *rritja e ndërgjegjësimit*, ku përfshihen: nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.
- *kryerja e sondazheve dhe monitorimeve të pavarura në lidhje me diskriminimin*, ku përfshihen: kryerja e sondazheve në lidhje me diskriminimin dhe monitorimi i zbatimit të këtij ligji.
- *publikimi i raporteve dhe dhënia e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin*, ku përfshihen: adresimi i rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues; publikimi i raporteve dhe përgatitja e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; kontribuimi në raportime dhe, sipas rastit, prezantimi i raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.

## **II.1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim**

Bazuar në Ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, asistenca ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:

1. Shqyrtimit të çështjeve nga KMD;
2. Asistencës së viktimave në gjykatë.

### **II.1.1. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD**

Bazuar në **Ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë: të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi; të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; t`u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues; të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.

#### **II.1.1.1. Procedura e shqyrtimit të ankesave**

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal(neni 33 i ligjit). Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim si dhe shpjegime dhe fakte që disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri. Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij. Komisioneri nuk vepron për ankesat anonime.

Nqs ankesa plotëson kushtet e ligjit për t`u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 te ligjit. Procedura e hetimit përfshin grumbullim informacioni lidhur me çështjen, mund të zhvillohen edhe inspektive apo seanca dëgjimore mes paleve. Pas analizimit të fakteve të grumbulluara bazuar ne procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim pas 90 ditëve nga data e ardhjes se ankeses, apo e seancës dëgjimore, nëse është zhvilluar një e tillë.Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brënda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brënda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.




Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brënda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas Kodit të Procedures Civile.

### II.1.1.2. Çështjet e trajtuara nga KMD gjatë vitit 2013

Në periudhën nga 1 janar 2013 deri në 31 dhjetor 2013, KMD ka trajtuar gjithsej **256 çështje**, (225 ankesa dhe 31 çështje ex-officio). Nga këto **191 (166 ankesa dhe 25 çështje ex-officio) të rregjistruara në vitin 2013**, si dhe **65 (59 ankesa dhe 6 çështje ex-officio) të mbartura nga viti 2012**.

KMD ka dalë me vendim për 131 çështje të trajtuara gjatë vitit 2013, duke dhënë vendim për të gjitha çështjet e mbartura nga viti 2012 (59 ankesa dhe 6 çështje ex-officio), ndërkohë që ka dhënë vendime edhe për 51 ankesa dhe 15 çështje të nisura prej tyre janë të rregjistruara në vitin 2013.

Në tabelën e mëposhte pasqyrohet rritja e numrit të ankesave dhe çështjeve të nisura kryesisht nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga viti 2010 deri në vitin 2013.




Siç shihet totali i numrit të ankesave të shqyrtuara dhe atyre që janë ende në procedura shqyrtimi në vitin 2013 lidhur me vitin 2012 është gati dyfishuar.

### II.1.1.3. Ankuesit

Bazuar në nenin 32, pika 1/a/b, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesit janë: individ, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitim.

Gjatë vitit 2013, ka filluar shqyrtimi i 166 ankesave, nga të cilat 149 janë nga individ të ndryshëm dhe 17 kanë ardhur nga organizata me interesa legjitime.



Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2013 përveç ankesave individuale, janë paraqitur edhe 17 ankesa nga organizata me interesa legjitim. Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e komunitetit LGBT, të personave me aftësi të kufizuara, të komunitetit rom, egjiptian etj. Falë bashkëpunimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe këtyre organizatave, për disa prej ankesave të ngritura prej tyre nga Komisioneri janë dhënë rekomandime, për rivendosjen e të drejtës së shkelur, ndërkohë që disa prej tyre janë zgjidhur me ndërmjetësim. Vlen të theksohet fakti se, këto bashkëpunime kanë qënë mjaft të efektshme për evidentimin e rasteve të pretenduara për diskriminim, ndërgjegjësimin e përmirësimin e situatave. Në disa raste informacioni i sjellë nga organizatat e shoqërisë civile ka shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për inicimin kryesisht të çështjeve.

### II.1.1.4. Shpërndarja rajonale e ankesave

Edhe gjatë vitit 2013 ka pasë një shtrirje gjeografike të ankesave me pretendim diskriminim, te paraqitura pranë KMD-së. Qytetet nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave me pretendim diskriminim pranë KMD-së janë Korça, Pogradeci, Saranda, Gjirokastra, Tirana, Shkodra, Lezha, Përmeti dhe zonat përreth tyre.

Shumica e ankesave janë paraqitur nga personat që banojnë kryesisht në qytetet ku KMD ka zhvilluar takime informuese në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare (OSCE/ODHIR, UNDP), gjatë të cilave komuniteti është njohur me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

kompetencat e KMD-së dhe mënyrat që duhet të ndiqen për të bërë një ankesë pranë KMD-së.

Për vitin 2014 pritet që numri i ankesave që do të paraqiten pranë Zyrës së KMD-së do të rritet, falë aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe informuese që Komisioneri ka zhvilluar dhe do të zhvillojë.


#### **II.1.1.5. Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara**

Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.(neni 1)

Në Zyrën e KMD-së, për vitin 2013 janë paraqitur ankesa për shkaqet e parashikuara në ligj, por ka pasë dhe ankesa në të cilat subjektet nuk ishin në gjëndje të identifikonin shkaqet. Duhet theksuar se ligji ka parashikuar një listë të hapur të shkaqeve duke parashikuar edhe çdo shkak tjetër, duke patur parasysh këtu shkaqe që lidhen me cilësi individuale të personave.

Shpërndarja e ankesave të shqyrtuara, sipas shkaqeve për vitin 2013 dhe ato të mbartura nga viti 2012 është:

- raca 149 ankesa,
- ngjyra 1 ankesë,
- gjendja arsimore 1 ankesë,
- gjendja ekonomike 8 ankesa,
- gjendja shëndetësore 11 ankesa,
- përkatësia në një grup të veçantë 1 ankesë,
- aftësia e kufizuar 23 ankesa,
- orientimi seksual 7 ankesa,
- gjinia 5 ankesa,
- mosha 4,
- bindjet politike 22 ankesa,
- bindjet fetare 1 ankesë,
- shtatëzania 1 ankesë,
- vendbanimi 2 ankesa,
- për çdo shkak tjetër 10 ankesa,
- të pidentifikuara 7 ankesa.



- **Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të racës<sup>52</sup>**

Për vitin 2013 janë trajtuar 137 ankesa dhe 12 çështje me pretendim diskriminimin për shkak të racës. Duhet të theksohet fakti se ankesat individuale janë marrë kryesisht gjatë ditëve të hapura që Komisioneri ka organizuar në rrethe të ndryshme të vendit. Organizimi i ditëve të hapura<sup>53</sup>, ka qënë një komponent i projekteve ndërgjegjësuese të KMD-së, ku komuniteti rom ka qënë në fokus dhe është informuar lidhur me institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kompetencat dhe mënyrën se si mund të ankohesh pranë institucionit të Komisionerit. Mbështetur në informacionin egrumbulluar në këto takime, KMD ka dërguar rekomandime drejt institucioneve përkatëse për problematikat e ngritura nga ky komunitet.

Bazuar në ankesat vërejmë se pjesarë të këtij komuniteti ankohen diskriminim në fushën e punësimit, strehimit, arsimit dhe në atë të shërbimeve.

Nga këto çështje ka përfunduar shqyrtimi për Duhet theksuar fakti se Komisioneri raste hetimi, në lidhje me diskriminimin për shkak të races, për vitin 2013. Gjatë shqyrtimit të tyre dhe ankesave me shkak racën, kanë përfunduar procedurat e hetimit për rastet e mëposhtme:

- në 4 raste është dhënë vendim me diskriminim,
- në 22 prej rasteve është konstatuar mosdiskriminim,
- në 2 raste janë dhënë rekomandime për përmirësimin e situatës,
- në 4 raste është dhënë vendim mosdiskriminimi dhe rekomandim për përmirësimin e situatës,

<sup>52</sup> Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

<sup>53</sup> Shih faqen 61 të këtij raporti për t’u njohur me projektet.

- në 4 raste në bashkëpunim me institucionet përkatëse është arritur qëllimi që kemi synuar,
- në 15 raste çështjet nuk janë pranuar për shkak të mos kompetencave të KMD-së dhe ankuesve i është rekomanduar t'i drejtohen për zgjidhjen e çështjes institucioneve përkatëse,
- në 2 raste çështjet janë pushuar për shkak se ankuesit kanë qënë inaktiv për një periudhë të gjatë dhe ka qënë i pamundur shqyrtimi i mëtejshëm i çështjeve,
- në 5 raste ankuesit janë tërhequr nga ankimi,
- për 91 raste vazhdojnë ende procedurat e shqyrtimit të ankesës, pasi janë paraqitur gjatë muajit dhjetor 2013.

Gjithashtu për vitin 2013 janë paraqitur një numër ankesash me shkak racën, të cilat nuk janë pranuar për shqyrtim, pasi nuk plotësonin kriteret që parashikon ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, por për këto raste Komisioneri ka sugjeruar dhe rekomanduar që subjektet ankuese t'i drejtohen institucionit kompetent. KMD, në disa raste, ka ofruar asistencë për komunitetin rom dhe egjiptian, në plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike, për rregjistrimin e fëmijëve të tyre në shkolla, rregjistrimin në gjendjen civile, përfitimin nga banesat sociale, përfitimin nga tarifatat studentore etj.

#### **Shembull 1:**

***Trajtimi ex-officio i çështjes së mospranimit të nxënësit rom, pranë shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, në Tiranë.***

Bazuar në informacionin e marrë nga përfaqësues të shoqatës “CRCA”, pretendohet se fëmija me emrin D. D., i datëlindjes 16.06.2001, i cili i përket komunitetit rom në Tiranë, nuk ishte pranuar për t'u regjistruar në shkollën 9-vjeçare “Shyqyri Peza” nga ana e drejtoreshës znj. Sh.T, me pretendimin se “është në moshë më të rritur se të tjerët”. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, filloi procedurën e shqyrtimit ex-officio të çështjes.

Në bisedën e bërë nga ana e përfaqësuesve të Zyrës së Komisionerit me znj. SH.T, në mjediset e shkollës 9- vjeçare “Shyqyri Peza” dhe përfaqësueses së Qendrës Ditore”Princi i Vogël” znj. R. P., si dhe znj. E. I., përfaqësuese e shoqatës “CRCA”, nga ana e drejtoreshës u theksua se pretendimi i ngritur nga ana e saj ishte se nxënësi në fjalë, ishte në moshë më të madhe se nxënësit e tjerë me të cilët do qëndronte në një klasë, pasi është 12 vjeç dhe mosfrekuentimi i rregullt në procesin mësimor i fëmijës përbënte një shkak për të cilin kishin refuzuar regjistrimin.

Në bashkëpunimin me Shoqatën “CRCA” dhe ndërmjetësimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me drejtoreshën e shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, znj. Sh. T., u arrit që të realizohej regjistrimi i nxënësit D. D., në klasën e tretë pranë kësaj shkolle dhe ai të vijonte mësimin normalisht me nxënësit e tjerë.

#### **Shembull 2:**

***Trajtimi ex-officio i çështjes së komunitetit Rom, në Qendrën e Realizimit të Veprave të Artit në Rrugën e Kavajës, lidhur me largimin nga vendstrehimet e tyre.***

Gjatë muajit gusht të vitit 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur me prioritet rastin e dëbimit të familjeve rome nga vendstrehimi i tyre pranë rrugës së Kavajës. Gjatë takimit me anëtarë të komunitetit rom që jetonin në këto vendbanime, inspektorët morën informacion se në këtë zonë jetonin rreth 37 familje të komunitetit rom. Gjatë shpërnguljes pjestarët e familjeve rome të Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit në

Rrugën e Kavajës, ngritën shqetësimin se organet e policisë nuk kishin reaguuar ndaj largimit forcërisht dhe abuzimeve verbale që ishte bërë ndaj tyre. Gjatë hetimit administrativ dhe provave të administruara nga KMD, rezultoi se nuk kishte asnjë dokumentacion që të vërtetojë se janë ndjekur të gjitha veprimet që parashikon legjislacioni shqiptar për lirimin e trullit të zënë padrejtësisht. Kështu, Komisioneri i dërgoi një rekomandim Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, ku kërkoi *“Marrjen në mënyrë të menjëhershme të masave të nevojshme për trajtimin e çështjes në mënyrë ligjore, të barabartë dhe jodiskriminuese”*.

Sipas informacionit të marrë në media, një pjesë e tyre ishte vendosur aty që prej vitit 1990, në këtë zonë. Nuk ka asnjë informacion mbi masat që institucionet përgjegjëse për t'u kujdesur për strehimin, kanë marrë për të shmangur pasjonat negative për këtë komunitet. Lidhur me këtë rast, Komisioneri i ka dërguar rekomandim Bashkisë së Tiranës, ku ka rekomanduar *“Marrjen e masave të menjëhershme për ofrimin dhe zbatimin e programeve të strehimit social për familjet rome, pranë Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit në Rrugën e Kavajës dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, të ndërmetësojë me institucionet e varësisë për të bërë të mundur ofrimin e ndihmës ekonomike për familjet rome, të cilat janë banore të Bashkisë Tiranë”*.

Në bashkëpunim me Federatën Rome të Shqipërisë dhe Kryetaren e Njesisë Bashkiake nr. 5 Tiranë, janë ndërmarrë hapa për ndërmjetësimin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e ndihmës ekonomike. Në përfundim të shqyrtimit të rastit, Komisioneri nevojën e ndryshimeve në legjislacion për të mundësuar përfitimet nga shërbimet sociale (nga 11 familje që u asistuan nga stafi i zyrës vetëm 1 plotësonte kriteret për të përfutuar ndihmën ekonomike).

- ***Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar***

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar për vitin 2013, 11 çështje (9 ankesadhe 2 çështje të nisura kryesisht), për shkak të aftësisë së kufizuar. Nga këto:

- për 6 ankesa është konstatuar diskriminim,
- në 1 çështje është konstatuar mosdiskriminim,
- për 4 ankesa vazhdon shqyrtimi.

Ankesat me pretendim diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar kishin të bënin mohimin e përshtatjes së arsyeshme, për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve, moszbatimin e legjislacionit në lidhje me ushtrimin e së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar si dhe dështimi për të zbatuar legjislacionin në arsim me synim integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollat e zakonshme.

### **Shembull 1**

Bazuar në informacionin e marrë nga gazeta Shqiptarja.com, e datës 18.09.2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes ku pretendohet për diskriminim të nxënësës së klasës së parë të Liceut Artistik “Jan Kukuzeli”, A. XH. Sipas denoncimit mësuesja e klasës së parë kishte kërkuar largimin e vogëlushes nga shkolla me pretendimin se nuk mund të përkujdeset për të pasi mund të cënohet niveli i mësimit edhe për fëmijët e tjerë.

Rezultoi gjatë inspektimit se drejtuesi i institucionit arsimor për t'i ardhur në ndihmë mësueses kishte kërkuar nga DAR/Durrës prezencën e psikologes pranë A. XH për gjatë gjithë kohës që ajo ishte në klasë. Ditën e parë të shkollës A. XH, për shkak se duhet të shoqërohej në bankë nga psikologja, me justifikimin se kjo e fundit bëhej pengesë për shkak të shtatlartësisë, u vendos në bankë të fundit. Gjatë javës së parë të shkollës prindër dhe mësues, përfaqësues të mediave ndërprejnë shpesh mësimin duke hapur derën e klasës dhe duke kontaktuar me fëmijën. Pra, A. XH përbënte kuriozitet, u bë qëndra e vëmendjes, ndërkohë që ishte një fëmijë si shumë të tjerë që kishte filluar shkollën për herë të parë. Këto sjellje dhe veprime krijonin rreth A. XH një mjedis frikësues dhe jo miqësor, duke shfaqur tek ajo shenja stresi.

Nga sa rezultoi nga inspektimi dhe seanca degjimore të realizuara pranë Liceut Artistik "Jan Kukuzeli" Durrës, nuk ishte ngritur ndonjë komision për të vlerësuar nevojat e A.XH. dhe nëse ajo do të duhej të ndiqte shkollën e zakonshme apo një shkollë të specializuar. Drejtuesi i institucionit arsimor ka patur dijeni për nevojat e veçanta të saj, informacion të cilin ia ka percjellë edhe DAR/ Durrës. DAR/ Durrës dhe Drejtuesi i institucionit arsimor duhet të kishin respektuar parashikimet e bëra në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mosrespektimi i këtyre parashikimeve ligjore ka sjellë që A.XH. të mos gëzojë në baza të barabarta me fëmijët e tjerë të drejtën për t'u arsimuar, e drejtë kjo që i garantohet nga aktet ligjore në fuqi, pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi:

- Konstatimin e diskriminimit ndaj nxënëses A. Xh., nga Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës dhe drejtuesi i Liceut Artistik "Jan Kukuzeli", Durrës dhe rekomandoi:
- DAR Durrës, të marrë urgjentisht masat për të bërë funksional Komisionin Multidisiplinor, sipas parashikimeve ligjore për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- Drejtuesi i Liceut Aristik "Jan Kukuzeli", Durrës, të marrë masat për të ngritur komisionin për nxënësit me aftësi të kufizuar brenda Liceut Artistik "Jan Kukuzeli", sipas parashikimeve ligjore, për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- Deri në momentin e krijimit dhe funksionimit të komisioneve dhe planeve individuale për nxënësen në fjalë, drejtuesit e këtyre institucioneve dhe mësuesja kujdestare të rrisin bashkëpunimin me prindërit e fëmijës për t'iu përshtatur më mirë nevojave aktuale të saj.
- DAR Durrës dhe Drejtuesi i Liceut Artistik "Jan Kukuzeli", Durrës, të bashkëpunojnë për të ndjekur procedurat ligjore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar për të gjithë nxënësit e tjerë që ndjekin mësimin pranë këtij institucioni arsimor

### **Shembull 2**

FSHDPAK, ka paraqitur ankesën në të cilën trajton problemin e ngritur nga, z. H. M. dhe z. E. S., të cilët pretendohet se janë diskriminuar nga Bashkia Vlorë dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar më datë 23.06.2013. Ankesa e depozituar pranë Komisionerit konsiston në faktin se, z. H. M dhe z. E. S. nuk u janë krijuar kushtet, në lidhje me përshtatjen e mjediseve të qëndrave të votimit për të ushtruar të drejtën e votës. Referuar dhe fakteve të grumbulluara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u konstatua se personave me aftësi të kufizuara në qytetin e Vlorës nuk i ishin krijuar kushtet për të bërë të mundur votimin në mënyrë të barabartë dhe në kushte të njëjta me pjesën tjetër të votuesve. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të z. H. M dhe z. E. S, nga ana e Bashkisë Vlorë dhe Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Të rekomandojë që, Bashkia Vlorë, të marrë masa që në zgjedhjet e ardhshme, të ndjekë me përparësi zbatimin e kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe në udhëzimet përkatëse, për përshtatjen e qëndrave të votimit dhe vendosjen e tyre në katet e para të godinave, për personat me aftësi të kufizuara.
3. Të rekomandojë, Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, të kontrollojë dhe të monitorojë, brenda kompetencave të veta, zbatimin e kriterëve sa i takon personave me aftësi të kufizuara, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të ardhshme.

- **Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike**

Numri i çështjeve të trajtuara nga KMD, me pretendim diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike është 7, (6 ankesa dhe 1 çështje e filluar kryesisht). Nga këto:

- Për 1 prej ankesave është konstatuar diskriminim,
- Për 1 prej ankesave është konstatuar mosdiskriminim,
- dy ankesa nuk janë pranuar pasi nuk plotësojnë kërkesat e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”
- për 1 ankesë dhe 1 çështje të nisur kryesisht vazhdon shqyrtimi.

### **Shembull 1**

Shtetasit M.K dhe R.K kanë paraqitur ankesë pranë zyrës së Komisionerit në të cilën pretendonin se për shkak të gjendjes ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, Y.P, Drejtor i Përgjithshëm EKB, Gj.L, Jurist pranë EKB, D.S, Përmbarues Gjyqësor Privat dhe Gj.F, pretendent pronar i pasurisë, duke shfrytëzuar Aktin Normativ nr. 3, datë 01.08.2012 “Për lirim të banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”, kanë ndërmarrë veprime diskriminuese duke i nxjerrë nga banesa në të cilën jetonin.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës KMD ka konstatuar diskriminimin e drejtpërdrejtë të shtetasit M.K, nga ana e EKB, pasi çenonte të drejtën e banueses për strehim. Bazuar në këtë vendim, Komisioneri ka konstatuar diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) në fushën e të mirave dhe shërbimeve, duke vlerësuar se praktika e ndjekur nga EKB, duke i trajtuar të gjitha familjet që jetonin në këtë banesë ish pronë e subjekteve të shpronësuara është bërë njëlloj pa marrë parasysh kushtet e ndryshme që këto familje kishin.

Në këtë vendim Komisioneri ka rekomanduar që EKB, të marrë të gjitha masat për nxjerrjen e përgjegjësive dhe mospërsëritjen e këtyre veprimeve në të ardhmen në respekt të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

- **Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të orientimit seksual**

Gjatë vitit 2013 KMD ka shqyrtuar 7 çështje me pretendim diskriminim për shkak të orientimit seksual. Nga këto:

- për 5 ankesa është marrë vendim diskriminim,
- për një ankesë është marrë vendim për mosdiskriminim,



- një ankesë është në proces<sup>54</sup> shqyrtimi.

Përsa më lart, në tre rastet në të cilat është konstatuar diskriminim, janë dhënë masa administrative me gjobë, duke qënë se personi kundër të cilit ka nisur çështja, nuk ka zbatuar vendimin e dhënë nga KMD.

### **Shembull 1**

Komisioneri ka shqyrtuar dy ankesa me pretendime pothuajse të njëjta. Njëra e iniciuar me nismë të Komisionerit kundër shtetasit E.S në lidhje me deklaratimet në median vizive që identifikonin pedofilinë me orientimin seksual. Ankesa tjetër është bërë nga dy organizata me interesa legjitimë Ambasada Pink dhe organizata Pro LGBT Shqipëri të cilat pretendonin se shkrimi i botuar nga shtetasi A.L në një gazetë të përditshme, ka përmbajtje të hapur diskriminuese, homofobike dhe keqinformuese ndaj komunitetit LGBT në Shqipëri.

Në të dy këto ankesa Komisioneri ka vlerësuar se E.S dhe A.L kanë përdorur shprehje në adresë të komunitetit LGBT, të cilat krijojnë në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirëinformuar në lidhje me çështjet e orientimit seksual apo identitetit gjinor, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa dhe ndjenja urrejtjeje ndaj këtij komuniteti. Komisioneri ka vlerësuar se shprehjet e përdorura nga E.S dhe A.L, janë flagrante dhe përcjellin një gjuhë të urrejtjes të pajustificuar, saqë edhe në mungesë të identifikimit të një individi konkret si viktimë diskriminimi, mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

***Në përfundim të shqyrtimit të ankesës Komisioneri ka konstatuar se shprehjet e përdorura nga E.S dhe A.L janë diskriminuese, pasi ato paragjykojnë dinjitetin dhe çënojnë sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.***

*Gjithashtu, në këtë vendim Komisioneri vendosi detyrimin e E.S dhe A.L si persona të cilët kanë konsumuar sjellje diskriminuese të kërkojnë publikisht ndjesë si dhe të evitojnë në të ardhmen përdorimin e gjuhës që nxit urrejtje.*

*Duke qënë se në përgjigje të vendimit, subjektet nuk kanë reaguar, Komisioneri, në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka vendosur masën administrative me gjobë, në vlerat 20.000 lekë për E.S dhe 10.000 lekë për A.L.*

### **Shembull 2**

Shtetasi V.N ka paraqitur ankesë pranë zyrës së Komisionerit, pasi ndihet i diskriminuar nga disa media të shkruara dhe vizive të cilat për shkak të orientimit seksual kanë transmetuar të plota të dhënat e tij personale. Në informacionin e dhënë në media personat e përfshirë në lajm janë etiketuar si homoseksualë si dhe është lidhur vepra e prostitucionit me karakteristikën personale të orientimit seksual. Z. V.N., deklaroi se për shkak të publikimit të emrit të tij në televizion dhe në gazeta, po refuzohet për tu marrë në punë, familjarët nuk e duan si dhe është sharë dhe ofenduar në mjediset e komisariatit.

***Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, KMD është shprehur se transmetimi i informacionit mbi veprën penale, duke e lidhur me karakteristika personale të individit që prezumohet apo ka kryer veprën penale edhe kur kjo karakteristikë nuk përcakton cilësimin e veprës penale,***

<sup>54</sup> Për këtë çështje është marrë vendim me gjobë në janar 2014.

*vendos një praktikë që në mënyrë të tërthortë diskriminon individët apo komunitetet për shkak të këtyre karakteristikave.*

*Komisioneri ka rekomanduar që mediat të jenë më të kujdesshme dhe të përgjegjshme në publikimin e informacioneve duke kapërcyer tendencën e trajtimit të homoseksualitetit si një temë që lidhet me lajme skandaloze si dhe mediat duhet të marrin masa për mospublikimin e karakteristikave personale të individëve, që nuk kanë lidhje me parashikimin ligjor të veprës penale të kryer.*

- **Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të gjinisë**

Për vitin 2013, KMD shqyrtoi 4 ankesa me pretendim diskriminim për shkak të gjinisë, nga të cilat:


- për 1 rast është marrë vendim për diskriminim. Në këtë rast janë dhënë dy vendime ndaj dy subjekteve publike, njëri vendim diskriminim, ndërsa tjetri mosdiskriminim, pasi subjekti u vu në dijeni për rastin dhe në bashkëpunim me Komisionerin mori masa për të shmangur situatën diskriminuese ndaj ankueses,
- një ankesë është pushuar pasi subjekti ankues u tërhoq nga ankimi,
- dy ankesa janë mbyllur me konstatimin e mosdiskriminimit.

Objekti i ankesave me pretendim diskriminim për shkak të gjinisë, përgjithësisht ka qënë mosrespektimi i të drejtave në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e institucioneve publike.

Referuar individëve që janë ankuar pranë KMD-së, 96 prej tyre janë meshkuj dhe 53 femra. Duke bërë një krahasim me vitin 2012 mund të themi që numri i ankuesve meshkuj është rritur dukshëm, duke u dyfishuar, ndërsa numri i ankueseve femra nuk ka pasur një rritje të dukshme<sup>55</sup>. Këtu vlen të theksohet fakti se numri i ankesave me pretendim për diskriminim me shkak gjinor është i vogël, ndërsa nga shqyrtimi i ankesave nga KMD, rezulton se viktima te diskriminimit për shkaqe te ndryshme janë më shumë gra.

---

<sup>55</sup> Referuar raportit vjetor 2012, nga 84 ankues, 44 ishin meshkuj dhe 40 femra.



### Shembull

Shtetasja A.Ç ka paraqitur ankesë pranë zyrës së Komisionerit në të cilën pretendon se për shkak të gjinisë, gjendjes martesore dhe civile është diskriminuar nga kompania CEZ Shpërndarje sh.a Tiranë. Ankuesja shpjegon se ishte në proces divorci me ish bashkëshortin dhe kontrata e furnizimit me energji elektrike të banesës bashkëshortore ku jetonte së bashku me vajzat e saj ishte në emër të ish bashkëshortit. Ish bashkëshorti në mënyrë që të vihesh në posedim të banesës ka kërkuar nga CEZ pezullimin e përkohshëm të kontratës duke përdorur hapësirën që krijon kontrata e furnizimit me energji elektrike, duke arritur që nëpërmjet mungesës së energjisë elektrike të bënte të pabanueshme banesën. CEZ Shpërndarje sh.a ka vepruar menjëherë në përgjigje të kësaj kërkesë, duke bërë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike duke lënë pa energji banesën.

Komisioneri ka vlerësuar se parashikimi i kontratës tip i kompanisë CEZ përmban një problematikë në lidhje me mungesën e përkufizimit të saktë të termit “klient familjar” dhe zbatimit korrekt të tij. Kështu, kategoria “klient familjar” e parashikuar nga vetë kontrata si kategori e veçantë, përfshin klientin që është pjesë e një familjeje si përfitues të shërbimit jo një individ të vetëm. Në dukje kontrata për klientët familjarë paraqitet neutrale për sa i përket se kush është kryefamiljari, por nga ana tjetër në realitetin shqiptar dihet që me këtë “rol” janë veshur përgjithësisht kryefamiljarët meshkujt.

*Në përfundim, Komisioneri ka vlerësuar se qëndrimi i kompanisë CEZ Shpërndarje, Tiranë ka qenë diskriminues, pasi ky subjekt nuk ka mbajtur parasysh faktin se në këtë banesë, banojnë ish bashkëshortja shtatzënë dhe fëmijët e saj, të cilët kanë të drejtën për tu furnizuar me energji elektrike, në kushtet kur nuk ka pasur një titull ekzekutiv që të urdhëronte lirim të banesës. Më veprimet e saj CEZ Shpërndarje, Tiranë ka bërë trajtim të diferencuar në trajtimin e kontratës gjë që ka përmbushur kërkesën e ish bashkëshortit për nxjerrjen nga banesa të ish bashkëshortes dhe zotërimin e banesës.*

*Në këtë vendim Komisioneri ka rekomanduar që CEZ Shpërndarje, Tiranë, të marrë të gjitha masat për furnizimin me energji elektrike të banesës. Në këtë vendim Komisioneri ka*

konstatuar diskriminimin e tërthortë të shtetas A.Ç nga Enti Rregullator i Energjisë pasi kontrata e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët familjarë e miratuar nga ky institucion nuk parashikon aksesin e barabartë që duhet të kenë bashkëshortët apo ish bashkëshortët, si dhe nuk parashikon trajtim të veçantë për gratë shtatzëna dhe fëmijët në përfitim të shërbimit të furnizimit me energji elektrike. Në vitin 2014 Komisioneri ka rekomanduar rishikimin e përmbajtjes së kontratës për konsumatorët familjarë nga ana e ERE.

- **Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të moshës**

Ankesat e paraqitura pranë KMD-së për diskriminim për shkak të moshës gjatë vitit 2013, kanë qënë 3. Pasi u shqyrtuan nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit, për 1 prej ankesave nuk u konstatua diskriminim, por u dha rekomandim për përmirësimin e situatës dhe shmangien e situatave diskriminuese. Për 2 rastet e tjera vazhdojnë procedurat hetimore nga ana e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Rastet e trajtuara nga KMD për këtë shkak, janë paraqitur në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

**Shembull 1:**

**Çështja “Dhunimi i një të mituri nga punonjësi i Policisë së Shtetit”**

Mbështetur në informacionin e marrë nga Koalicioni Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve (BKTF), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nisur procedurat e hetimit administrativ, lidhur me ushtrimin e dhunës ndaj shtetasit (të mitur) E.K në Tiranë, më datë 24.11.2012, nga dy punonjës të Policisë së Shtetit. Në pamjet filmike audiovizive të depozituara nga Koalicioni BKFT, dallohej qartë i mituri me një flamur në duar, i cili është ndaluar dhe mbahet nga punonjësi i Policisë së Qarkullimit Rrugor. Pas pak, në vendin ku mbahej i mituri, ka ardhur një tjetër punonjës i Policisë së Shtetit, i cili ka marrë në dorëzim të miturin dhe i ka vendosur prangat, duke ia lidhur duart prapa shpine. Gjatë shoqërimit për në makinën e Policisë, punonjësi i Policisë ka shtyrë të miturin e më pas e ka qëlluar me pëllëmbë disa herë në shpinë.

Pas përfundimit të hetimeve të kryera nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u konstatua se, gjatë ndalimit të të miturit punonjësi i Policisë së Qarkullimit Rrugor Tiranë, nuk ka ushtruar dhunë ndaj të miturit E.K. Ai ka dorëzuar të miturin tek punonjësi i Policisë së Komisarariatit nr. 2 Tiranë, K.C, i cili gjatë shoqërimit të të miturit për në mjetin e policisë ka ushtruar dhunë ndaj tij. **Komisioneri, vendosi:**

*Konstatimin e diskriminimit, në lidhje me ushtrimin e dhunës ndaj të miturit E. K, në veprimet e kryera gjatë detyrës nga punonjësi i Policisë së Shtetit, z. K. C. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandoi që: Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, mbështetur në rekomandimin e Drejtorisë së Standardeve Profesionale, të bëjë përjashtimin e menjëhershëm të z. K. C, nga Policia e Shtetit.*

Në zbatim të rekomandimit të Drejtorisë së Standardeve dhe të KMD-së, punonjësi i policisë z. K. C., ka marrë masën disiplinore “Përjashtin nga Policia”, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Këtë masë disiplinore ai e ka ankimuar në Komisionin e Apelit, nga ku kjo masë është anuluar dhe është dhënë masa disiplinore “Shtyje e afatit të gradimit 12 muaj”.

- **Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të bindjeve politike**

Gjatë vitit 2013 janë paraqitur 20 ankesa për diskriminim, me shkak bindjet politike. Nga këto ankesa:

- Në 1 çështje nuk është konstatuar diskriminimi,
- për 15 prej tyre vazhdon procedura hetimore,
- në 2 çështje subjektet ankuese janë tërhequr nga ankimi, pasi situata për të cilën ishin ankuar kishte marrë zgjidhje pozitive,
- në dy raste nuk është pranuar ankesa, pasi nuk plotësonin kriteret e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ankesat që bëjnë pjesë në këtë kategori, kanë qënë të përqëndruara në fushën e punësimit, pasi objekti i tyre ka pasur lidhje të drejtpërdrejtë me pretendimin për largim të padrejtë nga puna për shkak të bindjeve politike. Problematika me të cilën është hasur Zyra e KMD-së në shqyrtimin e këtyre ankesave, është vështirësia në evidentimin e bindjeve politike të ankuesve dhe personave ndaj të cilëve janë paraqitur ankesat.

**Shembull:**

Shtetasi Gj.F ka paraqitur ankesë pranë zyrës së Komisionerit në të cilën pretendon se është larguar nga detyra e Përgjegjës të Sektorit në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Tiranë (DSHP), për shkak të bindjeve politike, pa asnjë motivacion objektiv.

Mbështetur në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke kryer procedurën e hetimit dhe inspektimit. Pak kohë pasi Komisioneri kishte nisur shqyrtimin e ankesës, subjekti ankues tërhoqi ankesën, pasi ishte rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës dhe situata kishte marrë zgjidhje. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës KMD vendosi ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të ankesës për shkak të tërheqjes nga procedimi administrativ të palës së interesuar.

- **Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të gjendjes arsimore**

Për vitin 2013 në ndryshim me vitin paraardhës, ka pasur vetëm një rast me pretendim diskriminim për shkak të gjendjes arsimore. Këto raste ndonëse të pakta në numër kanë pasur vëmendjen e duhur nga Zyra e KMD-së. Ankuesi në fjalë ka paraqitur pretendim diskriminimin për bindjet politike dhe gjendjen arsimore. Komisioneri, pasi shqyrtoi ankesën, konstatoi diskriminimin e subjektit ankues për shkak të gjendjes arsimore.

**Shembull**

Mështetur në ankesën e z. J. D. dhe bazuar në provat e paraqitura prej tij, rezulton se ka qënë i punësuar si nëpunës civil në pozicionin e specialistit të Sektorit të Trajnimit të Personelit të Burgjeve dhe ka vazhduar në këtë detyrë deri në daljen e vendimit nr. 1090 prot., datë 09.09.2008, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, me të cilin është vendosur “Lirimi nga detyra dhe kalimi në listë pritje, për shkak të ndryshimit të kërkesave për vendin e punës”. Z. J. D. mendon se ndaj tij është kryer një sjellje diskriminuese për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes arsimore, pasi e kanë larguar nga pozicioni i punës e më pas e kanë zëvendësuar më një person tjetër, më pak të kualifikuar.

Gjatë shqyrtimit të çështjes u konstatua që, Komisioni i Shërbimit Civil dhe Gjykata e Apelit Tiranë, kishte dhënë vendimin për dëmshpërblimin e z. J. D dhe rikthimin në

pozicionin e mëparshëm të punës por nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ishte marrë asnjë masë për zbatimin e tyre. Ndërkohë që nga lirimi i z. J. D nga puna, në të njëjtin pozicion pune me të, ishin punësuar dhe larguar një numër i madh punonjësish dhe ai nuk ishte rikthyer më në punë me pretendimin se nuk kishte arsimin e duhur. Z. J. D., kishte mbaruar arsimin e lartë dhe kishte marrë titullin Doktor dhe bazuar edhe në vendimin e Gjykatës së Apelit dhe të Komisionit të Shërbimit Civil, ai i plotësonte kriteret e punës dhe kishte arsimin përkatës. **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi:**

1. *Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të bindjeve politike, ndaj z. J. D., nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, pasi mbështetur në provat e grumbulluara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk u arrit të konstatohej sjellje diskriminuese ndaj tij.*
2. *Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të gjendjes arsimore, ndaj z. J. D., nga Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, duke e vënë atë në kushte jo të favorshme, në raport me punonjësit e tjerë të Sektorit të Trajnimeve të Personelit në DPB, me nivel më të ulët të studimit.*
3. *Rekomandim për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, që të rikthejë në pozicionin e mëparshëm të punës z. J. D.*

Në lidhje me rekomandimin e KMD-së, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nuk ka kthyer asnjë përgjigje. Për këtë arsye po përgatitet nga Zyra e KMD-së, masa administrative me gjobë, për shkak të moszbatimit të rekomandimit.

- ***Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore***

Gjatë vitit 2013, pranë KMD-së, janë paraqitur 8 ankesa në të cilat pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore. Për një rast ka nisur procedura kryesisht, bazuar në një informacion që Komisioneri ka marrë në media. Nga këto ankesa kanë përfunduar procedurat e shqyrtimit 4 prej tyre, nga të cilat:

- në 2 çështje është konstatuar diskriminim dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse,
  - 1 çështje nuk është pranuar pasi nuk i plotësonte kriteret e parashikuara në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,
  - për 2 çështje është dhënë vendim mosdiskriminimi.
- ***Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të bindjeve fetare***

Gjatë vitit 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar kryesisht një rast për shkak të bindjeve fetare, në të cilin është konstatuar diskriminim.

### **Shembull**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori informacion, nëpërmjet medias së shkruar, për një mjekë në spitalin e qytetit të Burrelit, e cila nuk kishte pranuar të punonte me infermieren, për shkak se kjo e fundit mbante shami. Bazuar në provat dhe faktet e administruara, rezultoi se ka një dallim në trajtimin e znj. I. H. Në ndryshim nga infermierët e tjerë, të cilët qëndrojnë në dhomën e mjekut pranë të cilit kanë marrë emërimin, ajo vazhdonte të qëndronte pranë një mjeku tjetër dhe jo pranë mjekes ku ka emërimin.

Drejtorja e Shërbimit Spitalor Burrel, nëpërmjet mosveprimit, ka dështuar për ta mbrojtur znj. I.H nga sjelljet diskriminuese të punonjësve të tjerë. Si pasojë, znj. I.H është penguar që të ushtrojë profesionin, në mënyrë të barabartë me punonjësit e tjerë infermierë vetëm për shkak

të shfaqjes në publik të besimit të saj fetar. Për këtë arsye, mosveprimi i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Burrel, për të eliminuar pasojat negative dhe trajtimin ndryshe të punonjësës I.H, përbëjnë diskriminim të drejtpërdrejtë, për shkak të bindjeve të saj fetare.

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi:**

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e “shqetësimit” në fushën e punësimit, për shkak të bindjeve fetare të znj. I. H., me detyrën infermiere, nga znj. F. GJ., me detyrë mjekë endokrinologe pranë Shërbimit Spitalor Burrel.
2. Detyrimin e znj. F. Gj. për të ndaluar në mënyrë të menjëhershme sjelljet dhe veprimet diskriminuese ndaj znj. I. H.
3. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë në fushën e punësimit, për shkak të bindjeve fetare të znj. I. H., nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Burrel.
4. Detyrimin e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Burrel të marrë masa të menjëhershme për të eliminuar trajtimin ndryshe të znj. I. H. dhe garantimin e ushtrimit në mënyrë të barabartë me të tjerët të detyrës së saj si infermiere.

- *Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të denoncimeve*

Gjatë vitit 2013 KMD ka shqyrtuar 2 çështje (1 ankesë, të mbartur nga viti 2012). Në njëren çështje ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të denoncimeve të bëra prej saj, kundrejt subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën. Në 1 rast tjetër Komisioneri e ka nisur kryesisht shqyrtimin e tij, dhe është në përfundim të procedurave hetimore.

**Shembull 1:**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e znj. I. K., e cila pretendon se është diskriminuar nga ana e Universitetit të Arteve për shkak të ideve, shkrimeve dhe prononcimeve në median vizive dhe atë të shkruar, qëndrime këto me një frymë të lartë të kritikës ndaj qëndrimeve dhe veprimeve të Universitetit të Arteve (UA).

Mbështetur në faktet dhe provat e grumbulluara, në mungesë të një justifikimi të përligjur nga ana e UA-së, u konstatua se mospërfshirja e ankueses në komisionet e provimit, për lëndën ku është titullare, ka ardhur si rezultat i ankimeve të saj që synonin zbatimin e parimit të barazisë, në Gjykatë apo tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sipas shpjegimeve praktika e ndjekur për organizimin e Stinës Koncertore në dukje nuk përjashton pedagogët e jashtëm, por për shkak të mungesës së procedurave dhe rregullave të shkruara për mënyrën se si personat e interesuar do të marrin informacionin e nevojshëm për të marrë pjesë në Stinën Koncertore, bën që kategori të caktuara, si pedagogët e jashtëm, siç është edhe ankuesja, të vendosen në pozita më pak të favorshme krahasuar me pedagogët e brendshëm. Këta të fundit duke qenë të punësuar me kohë të plotë kanë më shumë mundësi të njihen me aktivitetet që organizon UA. **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi :**

1. *Konstatimin e diskriminimit të ankueses I.K, për shkak të “ideve dhe qëndrimeve kritike”, gjatë marrëdhënieve të punës.*
2. *Rekomandohet z. S.Sh, Dekan i Fakultetit të Muzikës, në Universitetin e Arteve si personi përgjegjës, të marrë masa për zbatimin e Rregullores Mësimore të Ciklit të Parë të Studimeve*

lidhur me zbatimin e rregullave për realizimin e procesit të provimeve, duke përfshirë ankuesen I. K në Komisionet e Provimeve për studentët e saj.

3. Rekomandohet Universiteti i Arteve të zbatojë detyrimet e përcaktuara për punëdhënësit në nenin 13 të Ligjit ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’, duke shqyrtuar në mënyrë efektive dhe brenda afateve ligjore çdo ankesë për diskriminim nga punëmarrësit.

4. Rekomandohet Universiteti i Arteve që për shqyrtimin në mënyrë efektive të ankesave për diskriminim dhe për të përmbushur kërkesat e nenit 13 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” të parashikojë në aktet e tij të brendshme procedura të përcaktuara qartë për shqyrtimin e ankesave për diskriminim nga punëmarrësit.


5. Rekomandohet Universiteti i Arteve të marrë masa që në sezonin e radhës të Stinës Koncertore, të hartojë procedura të qarta lidhur me mënyrën e informimit dhe aplikimit nga ana e personave të interesuar.

6. Pushimin e gjykimit për pretendimin e ankueses për diskriminim në shpalljen e vendeve të lira të punës, në bazë të nenit 46 të Kodit të Procedurës Civile, pasi kjo mosmarrëveshje është duke u gjykuar nga Gjykata.

#### II.1.1.6. Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat

Ankesat e shqyrtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2013, i përkasin kryesisht fushave të mëposhtme:

- 187 çështje fushës së të mirave dhe shërbimeve,
- 55 çështje fushës së punësimit,
- 14 çështje fushës së arsimit.





- ***Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve***

Ankesat në fushën e të mirave dhe shërbimeve kanë qënë më të mëdha në numër, referuar dy fushave të tjera, pasi në fushën e të mirave dhe shërbimeve përfshihen përfitimi i të mirave dhe shërbimeve të ofruar nga administrata publike dhe subjektet private. Kryesisht ankesat e paraqitura në këtë fushë kanë të bëjnë me shërbimet të cilat nuk janë ofruar nga njësitë vendore (p.sh. personat me aftësi të kufizuara pretendojnë se njësitë vendore nuk kanë përshtatur mjediset e vendbanimit ku jetojnë për personat me aftësi të kufizuara) apo nga subjekt private, shëndetësia, administrata publike etj. Përgjithësisht ankesat kanë pasur të bëjnë me përshtatjen e arsyeshme, vonesat në pagesat e pensioneve të invaliditetit, vonesat në marrjen e masës mujore të ndihmës ekonomike etj. Kjo është dhe arsyeja pse kjo fushë përmbledh 71 % të ankesave të përgjithshme.

**Shembull:**

Shtetasja B.M ka paraqitur ankesë pranë zyrës së Komisionerit në të cilën pretendon se për shkak të racës, (pasi i përket komunitetit Rom) nuk është përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike nga ana e Komunës Grabian.

Në shqyrtim të dokumentacionit, Komisioneri ka vlerësuar se Komuna Grabian me pretendimin se në komuna banorët janë të pajisur me tokë dhe i pengon ligji për të dhënë ndihmë ekonomike, ka konsoliduar praktikën e mosfrimit të këtij shërbimi. Duke mos shqyrtuar asnjë kërkesë të banorëve për ndihmë ekonomike nuk ka bërë një trajtim të ndryshëm, të diferencuar apo një sjellje diskriminuese, për shkak të racës, vetëm ndaj ankuses B.M, por ka ndjekur praktika diskriminuese ndaj gjithë banorëve të Komunës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës Komisioneri ka konstatuar se praktika e ndjekur nga Komuna Grabian, duke mos shqyrtuar kërkesat e banorëve për ndihmë ekonomike, duke i trajtuar të gjithë këto familje njëllor pa një analizë për plotësimin e kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) përbën diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, pasi cënon të drejtën e banorëve të Komunës Grabian për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Në këtë vendim Komisioneri ka rekomanduar që Komuna Grabian të marrë veprimet e duhura në drejtim të shqyrtimit të kërkesave për ndihmë ekonomike nga ana e banorëve. Në përgjigje të këtij rekomandimi Komuna Grabian është përgjigjur se nga ana e saj po përgatitet dokumentacioni i nevojshëm për të shqyrtuar këtë çështje në Këshillin e Komunës.

- ***Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit***

Ankesat e paraqitura me pretendim diskriminim në fushën e punësimit kanë të bëjnë me procedurat e ndjekura nga institucione të ndryshme në lidhje me punësimin në administratë si dhe ankesa të paraqitura ndaj subjekteve private. Numri i përgjithshëm i tyre për vitin 2013, është 45. Në krahasim me vitin e shkuar, ankesat e paraqitura në fushën e punësimit, janë drejtuar përgjithësisht drejt largimeve nga institucionet e administratës publike. Ankesat që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë pasë si shkak diskriminimi, bindjet politike dhe gjendjen shëndetësore. KMD në fushën e punësimit, në disa prej çështjeve të përfunduara ka dhënë vendim diskriminim dhe rekomandimet përkatëse për rregullimet dhe masat që duhet të marrë subjekti i cili ka kryer diskriminimin.

### Shembull

Shtetasja E.Zh ka paraqitur ankesë pranë zyrës së Komisionerit në të cilën pretendon se për shkak të shtatzanisë, përgjegjësisë prindërore dhe gjendjes shëndetësore është diskriminuar nga punëdhënësi banka Credit Agricole sh.a. Subjekti ankues shpjegon se në përfundim të raportit mjekësor leje lindje, ka kërkuar për të shfrytëzuar pushimet vjetore të më shumë se një viti, të cilat nuk i janë miratuar nga punëdhënësi edhe përpara se të merrte lejen e lindjes. Banka Credit Agricole në përgjigjen e tij ka informuar Komisionerin se për shkak të mbingarkesës në punë kërkesa e punonjësës për të shfrytëzuar lejet vjetore të mbartura është refuzuar.

Komisioneri ka vlerësuar se drejtuesit e bankës me refuzimet e përsëritura të dhënies së pushimeve vjetore punonjësës me arsyetimin se duhet të paraqitet në punë dhe pastaj të diskutohet koha e duhur për marrjen e lejes, përbën një trajtim të diferencuar në raport me standardin që është parashikuar në Kodin e Punës dhe kontratën individuale të punonjësve si dhe me punonjësit e tjerë të bankës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës KMD ka konstatuar diskriminimin e shtetasës E.Zh, për shkak të shtatzanisë në fushën e punësimit. Në këtë vendim Komisioneri ka rekomanduar punëdhënësin për dhënjen e lejes vjetore për E.Zh.

- ***Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit***

Në fushën e arsimit, krahasuar më një vit më parë, numri i ankesave ka qënë më i vogël. Në përgjithësi një pjesë e madhe e rasteve të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kanë qënë të nisura kryesisht. Rastet në fushën e arsimit kanë pasur përgjithësisht shkaqe diskriminimi racën, gjëndjen shëndetësore dhe aftësinë e kufizuar. Pjesa më e madhe e këtyre rasteve ka të bëjë me mospranimin e integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme dhe mospranimin e regjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

### Shembull:

Në bazë të informacionit të marrë nga Shoqata “Qëndistarët”, Korçë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi inicioi hetimin kryesisht të çështjes së nxënësit D. Q., i cili nuk pranohej nga Drejtorja e Shkollës “Themistokli Gërmenji”, të rregjistrohet në këtë shkollë, duke u diskriminuar për shkak të racës. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e shqyrtoi rastin në fjalë duke ndjekur të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë.

Pas kontaktimit me drejtorinë e shkollës rezultoi se këshilli i mësuesve të shkollës kishte vendosur që nxënësit që ishin përjashtuar një vit më parë nga shkolla, të mos ripranoheshin. Ndërkohë, në rregjistrin e klasës nxënësi D. Q., rezultonte të ishte larguar me dëshirë nga shkolla dhe jo përjashtuar. Gjithashtu ishte vendosur një rregull i pashkruar që në këtë shkollë të pranohen vetëm nxënës me mesatare mbi tetë, duke përjashtuar automatikisht nxënësit me mesatare më të ulët të notave.

Bazuar në provat dhe faktet e administruara Komisioneri, arriti në përfundimin se për rastin në fjalë kemi të bëjmë me një rast diskriminimi të drejtëpërdrejtë, pasi shkolla kishte vënë disa rregulla, të cilat përjashtonin rregjistrimin e nxënësve, që bazuar në legjislacionin në fuqi duhej të rregjistroheshin në atë shkollë. Përjashtonin nxënësit me një mesatare të notave më të ulët se 8, pra në atë shkollë bëhej një selektim, diferencim i nxënësve që dëshironin të ndiqnin atë shkollë. **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi:**

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë në fushën e arsimit, për shkak të gjendjes arsimore të nxënësit D. Q., nga drejtuesit e shkollës dhe Drejtorisë Arsimore Korçë.
2. Detyrimin e Drejtuesëve të shkollës dhe Drejtorisë Arsimore Korçë, të marrë masat e menjëhershme për të eliminuar trajtimin ndryshe të nxënësit D. Q. dhe garantimin e të drejtës për tu arsimuar.

Në zbatim të rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e shkollës "Themistokli Dërmenji" Korçë, informoi Komisionerin se nxënësi D. Q ishte rikthyer dhe pranuar sërish në shkollë.

#### II.1.1.7. Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara


Duke u bazuar në nenin 33 të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", fillimisht ankesat i janë nënshtruar një shqyrtimi paraprak, lidhur me kushtet e pranimit. Nëse ankesa nuk ka plotësuar kriteret e pranimit ose ka patur mungesë të informacionit që mund të pengojë procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të saj, ankuesit i është kërkuar që të plotësojë kriteret e kërkuar nga ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qënë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me njësitë vendore, subjekteve ankues u është ofruar ndihmë nga njësitë vendore, për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2013 ka marrë një numër të konsiderueshëm vendimesh prej 135, në të cilat:

- 19 vendime konstatim diskriminimi,
- 14 vendime për pushimin e çështjes, pasi është arritur qëllimi për të cilin kishte iniciuar shqyrtimi i ankesave,
- 2 rekomandime për përmirësimin e situatës,
- 39 vendime konstatim mosdiskriminimi,
- 15 vendime konstatim mosdiskriminimi dhe rekomandime për përmirësim situatë,
- 10 vendime për ndërprerje të procedurave për shkak se ankuesit janë tërhequr,
- 7 vendime për pushimin e çështjes, për shkaqe të ndryshme,
- 26 vendime për mospranim të ankesës,

Theksojmë faktin se në 14 çështjet e përfunduara me arritje qëllimi, situata diskriminuese e konstatuar është rregulluar gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, nëpërmjet hapave që KMD ka ndërmarrë në mbështetje të ligjit.

Gjithashtu për 3 subjektet që nuk kanë plotësuar rekomandimet e Komisionerit, bazuar në Ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë dhënë sanksione me gjobë. Njëri nga subjektet ka ankimuar masën e sanksionit në gjykatë.



### **Vendimet e Komisionerit të ankimuar në gjykatë**

Gjatë vitit 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndjekur proceset gjyqësore, si palë e paditur, konkretisht në këto çështje:

1. Në çështjen civile me palë paditëse: Credit Agricole sh.a, me të paditur: Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe person i tretë: E. Zh, në çështjen me objekt: “Anulimi i aktit administrativ të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Bazuar ne Vendimin e Gjykatës së Lartë, çështja do të transferohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
2. Në çështjen civile me palë paditëse: Subjekti Politik “Aleanca Kuq e Zi”, me të paditur: Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe person i tretë: E. V. Th, Kryetar i Komunës Liqenasit. në çështjen me objekt: “Shfuqizimin e Aktit Administrativ, Vendimit “Për dënimin me gjobë”, dalë në zbatim të Vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe sigurimin e padisë. Bazuar ne Vendimin e Gjykatës së Lartë çështja do të transferohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Në çështjen gjyqësore me palë paditëse Fondacioni “Harry Fultz”, me të paditur: Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt “Shfuqizimin e vendimit për sanksionimin me gjobë, të “Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” aktualisht në apel.

### II.1.2. Asistenca ndaj viktimave në gjykatë

Bazuar në Ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë: me kërkesën e gjykatës që shqyrton çështjen, të parashtrorë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; të përfaqësojë ankuesin në organet gjyqësore në çështje civile me miratimin e tij në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të këtij ligji;

1. Në ankesën e paraqitur nga shtetasja F.K kundër Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Fier, në të cilën pretendonte se kishte qenë viktimë e diskriminimit për shkak se kishte ushtruar një të drejtë të saj duke denoncuar veprime në kundërshtim me ligjin që ishin kryer nga punëdhënësi, *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi konstatimin e diskriminimit të të drejtpërdrejtë të subjektit ankues dhe rekomandoi rikthimin në punë.* Pas shqyrtimit administrativ nga Komisioneri, F.K bëri objekt të shqyrtimit gjyqësor pretendimin e saj për largimin nga puna për shkaqe diskriminuuese. Komisioneri ofroi asistencë ligjore për hartimin e padisë dhe njëkohësisht mbështeti ankuesen me të gjithë dokumentacionin provues të grumbulluar gjatë procesit hetimor administrativ. Njëkohësisht, KMD ndoqi të gjithë procesin gjyqësor, i cili u zhvillua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, si palë e interesuar në gjykim, e thirrur nga paditësja. Në përfundim të procesit gjyqësor, *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi, konstatimin e faktit të diskriminimit dhe të viktimizimit të paditëses nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Fier dhe vendosi ndreqjen e pasojave të ardhura si rezultat i sjelljes diskriminuuese, duke urdhëruar rikthimin e paditëses në vendin e saj të mëparshëm të punës, si dhe duke dhënë dëmshpërblimin për dëmin pasuror dhe ato jo pasuror të pësuar nga paditësja.* Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier përbën një konfirmim të vendimmarrjes së institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe njëkohësisht një hap pozitiv drejt zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Në çështjen civile me palë paditëse E. C dhe palë të paditur Rektorin e Universitetit “Ismail Qemali”, Dekanen e Fakultetit Ekonomik dhe Shefen e Departamentit të Ekonomiksit, Znj. K. G pretendohet konstatimin e faktit të diskriminimit dhe viktimizimit ndaj paditëses, nga ana e palës së paditur. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi merr pjesë si palë e tretë. Me kërkesën e palës së paditur, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë u shpreh me vendim, duke e pushuar çështjen civile. Për sa më sipër, Znj. E. C. ka paraqitur një ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në të cilën pretendon për diskriminim për shkak të qëndrimeve parimore, për cënimin e standarteve të shërbimit arsimor në Universitet, si dhe për shkak të qëndrimit kundrejt procesit zgjedhor për organet drejtuese të Universitetit për vitin 2012. Për këtë shkak, subjekti ankues pretendon se është diskriminuar dhe viktimizuar në fushën e punësimit.
3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë në cilësinë e personit të tretë në gjykimin e çështjes administrative, me palë paditëse J. H dhe palë të paditur Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë me objekt padie “konstatimi i faktit të diskriminimit ndaj paditëses” etj. Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur rrëzimin tërësisht të kërkesë padisë, si të pabazuar në prova dhe në ligj.

## II.2. Ndërgjegjësimi

Rritja e ndërgjegjëimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar nëpërmjet një serë kompetencash për këtë qëllim, si - nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; - adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; - informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; - zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Në zbatim të Planit Strategjik 2012-2015, KMD ka përcaktuar si prioritet strategjik *rritjen e ndërgjegjëimit të opinionit publik për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për rolin e KMD-së në këtë fushë*. Komisioni Europian në Raportin Analitik të vitit 2013 për Shqipërinë, ka theksuar se “*ndërgjegjësimi i publikut për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe mekanizmi i ankesës mbetet i ulët*”. Që nga krijimi i tij, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në zbatim të kompetencave të parashikuara nga ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” dhe prioritetet, me synim rritjen e sensibilizimit dhe lehtësimin e aksesit të qytetarëve për t’iu drejtuar zyrës, ka kryer një serë veprimtarish me qëllim rritjen e ndërgjegjëimit, të cilat do t’i parashtrijmë si më poshtë. Megjithatë, KMD konstaton se ka ende nevojë për rritjen e ndërgjegjëimit të opinionit publik por edhe të grupeve vulnerabël, për mbrojtjen nga diskriminimi dhe mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje.

- **Organizimi i Konferencave dhe trajnimeve nga KMD**

Me datë 19 mars 2013, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racial, Komisioneri organizoi tryezën e rrumbullakët me temë: “*Diskriminimi Racial dhe sfidat e zbatimit të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*”. Qëllimi i këtij takimi ishte të tërhiqte vëmendjen e institucioneve, shoqërisë civile dhe mediave ndaj të drejtës së personave të komunitetit rom dhe egjiptian, për të marrë në mënyrë të përshtatshme shërbimet në edukim, punësim dhe të mira. Të ftuar në këto aktivitete ishin Koordinatorja e Projektit “*Praktikat më të mira për integrimin e romëve në Ballkanin Perëndimor*”, drejtor të shkollave, përfaqësuesit e shoqatave. Gjatë këtij aktiviteti u nënshkruan 11 Marrëveshje Bashkëpunimi midis Komisionerit dhe OJF-ve pjesëmarrëse, që mbrojnë të drejtat e këtyre komuniteteve në Shqipëri.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka zhvilluar seminare dy-ditore me temë “*Mbrojtja nga diskriminimi: Kuadri ligjor dhe institucional*”, me mbështetjen e Hans Seidel Foundation. Seminaret u zhvilluan në datat 1-2 Mars 2013 në qytetin e Shkodrës dhe në datat 1-2 prill 2013 në qytetin e Lezhës. Diskutimet nga të pranishmit ishin të pranishme gjatë të dy sesioneve të zhvilluara në dy ditë. Kryesisht ato u fokusuan në veprimtarinë konkrete të KMD-së, objektivat në të cilat është fokusuar ky institucion, sfidat, boshllëqet ligjore dhe nevojat për përmirësimet ligjore, marrëdhënia në të cilën ligji vendos KMD me pushtetin gjyqësor etj. Gjithashtu, eksperiencia u sollën edhe nga të pranishmit nga Bashkia, Inspektoriat i Shtetëror i Punës, OJF-të që kanë në objekt mbrojtjen e të drejtave të grave, pedagogë etj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi, me datë 7 nëntor 2013, **Konferencën “Mbrojtja nga diskriminimi: Modelet pozitive dhe sfidat”**. Konferenca kishte për qëllim të tërhiqte vëmendjen e institucioneve, shoqërisë civile, mediave dhe organizmave ndërkombëtarë ndaj të drejtës për mbrojtje nga diskriminimi, arritjeve dhe sfidave në këtë fushë. Pas panelit me përfaqësues të lartë, Konferenca ka vijuar përmes tryezave të veçanta të diskutimit për mbrojtjen nga diskriminimi të grupeve vulnerabël, pjesë të të cilave ishin grupet e interesit, përfaqësues të OJF-ve që kanë në objekt mbrojtjen e të drejtave të këtyre target grupeve si dhe përfaqësues të KMD-së. Janë ndarë gjashtë grupe pune: për mbrojtjen nga diskriminimi me bazë gjinore, mbrojtjen nga diskriminimi të fëmijëve, minoriteteve, komunitetit LGBT, personave me aftësi të kufizuar dhe një tryezë ka diskutuar lidhur me sfidat e zbatimit të ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në përfundim u evidentuan si **modele pozitive**

- Bashkëpunimi pozitiv me OJF-të për referimin e rasteve të diskriminimit;
- Vendime që krijojnë modele pozitive të trajtimit të çështjeve të diskriminimit;
- Bashkëpunimi pozitiv me OJF-të për trajnimin e institucioneve vendore, stafëve mësimorë e Zyrave të Punësimit për trajtimin e çështjeve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimin e komunitetit;
- Informacioni që përmban elementë që nxisin sjelljet diskriminuese trajtohen ex-officio;
- Kryerja e monitorimeve në sistemin arsimor dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Nga ana tjetër u evidentuan **rekomandimet:**

- Bashkëpunimi me synim përfshirjen në tekstet universitare të vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të Gjykatave për çështjet që kanë lidhje me diskriminimin;
- Referimi nga OJF-të i çështjeve të diskriminimit;
- Rritja e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë për ndërgjegjësimin dhe trajnimin e gjyqësorit mbi çështjet e diskriminimit;
- Të vazhdojë trajnimi i institucioneve vendore mbi ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;
- Monitorimi i zbatimit të ligjit nga ana e KMD-së ;
- Nevoja për përmirësimin e ligjit kryesisht lidhur me barrën e provës e cila duhet të rregullohet në mënyrë të qartë veçanërisht në procedurën para Komisionerit; në ligjet e tjera për t’i përshtatur me Direktivën Europiane për barrën e provës dhe me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”; ndryshime ligjore në lidhje me afatet e shqyrtimit të ankesës dhe detyrimit të institucionit për t’i dhënë informacion Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Të krijohet praktika e vjeljes së gjobave;
- Të nxitet qëndrimi proaktiv i administratës qendrore dhe vendore në drejtim të zbatimit të ligjit për të qenë pranë komunitetit
- Të shtrihet trajtimi i çështjeve të diskriminimit jo vetëm në fushën e zgjedhjeve, por edhe të arsimimit për personat me aftësi të kufizuar;
- Inkurajimi i personave me aftësi të kufizuar për të prezantuar rastet e diskriminimit; nevoja për një strategji komunikimi me personat me aftësi të kufizuar;
- Mbështetje më e madhe për organizatat nga Shteti;
- Të bëhen fushata ndërgjegjësimesh masive;
- Ofrimi i asistencës adekuate për fëmijët me nevojë të veçanta në sistemin arsimor;

Lehtësimi i procedurave për të përfituar strehim dhe ndihmë ekonomike si dhe rritja e ndihmës ekonomike;

Vendosja e masave ekstreme të sanksionit me gjobë për diskriminim të komunitetit LGBT;

Monitorimi i sektorit privat mbi zbatimin e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;

Ndërgjegjësim mbi kufirin që ndan lirinë e shprehjes nga gjuha e urrejtjes.

Të gjitha këto rekomandime kanë gjetur pasqyrim në Planin e Veprimit të KMD-së për vitin 2014.

Me qëllim mbrojtjen nga diskriminimi të viktimave të trafikimit, gjatë muajit Shtator 2012-Shtator 2013, Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë zhvilluar projektin me titull: **“Respektimi i të Drejtave të Viktimave të Trafikimit në Shqipëri - Ti Japim Fund Stigmës”**, mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A në Tiranë. Ky projekt kishte si qëllim ndërmarrjen e një fushate sensibilizimi në shkallë vendi në kuadër të mos-diskriminimit të viktimave të trafikimit si dhe synonte të përmirësonte të drejtat e këtij grupi në Shqipëri. Projekti është shtrirë në tre qytete: Lezhë, Durrës, Berat. Grupet e trajnuara ishin nxënësit e shkollave të mesme publike apo private, përfaqësues të komuniteteve, dhe punëdhënës. Në kuadër të këtij projekti janë realizuar këto aktivitete:

#### **18 Workshop-e me nxënësit e shkollave:**

Berat - 6 workshop-e në total në 3 shkolla (datë 20/12/2013 - 2 workshop-e; 11/01/2013 - 2 workshop-e; 16/01/2013 - 2 workshop-e).

Durrës - 6 workshop-e në total në 3 shkolla (datë 31/01/2013 -1 workshop; 31/01/2013 - 1 workshop; 01/02/2013 - 1 workshop; 01/02/2013 - 1 workshop; 08/02/2013 - 2 workshop-e).

Lezhë - 6 workshop-e në total në 4 shkolla (me datë 18/02/2013 -1 workshop; 18/02/2013 - 1 workshop; 20/02/2013 - 2 workshop-e; 25/02/2013 - 2 workshop-e). Në total morën pjesë rreth 350 nxënës.

**3 Workshop-e me punëdhënësit** në Berat (me datë 12/12/2012), Durrës (16/09/2013), Lezhë (me datë 20/11/2013). Në total morën pjesë rreth 70 punëdhënës.

**6 Forume me komunitetin:** 3 në Durrës (në datat 28/03/2013, 25/04/2013 dhe 07/05/2013) dhe 3 në Berat (në datat 09/05/2013, 15/05/2013, 22/05/2013). Në total morën pjesë rreth 120 anëtarë të komuniteteve të ndryshme.

Me datë 4 dhjetor 2013, përfaqësues të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministrisë së Brendshme dhe Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” zhvilluan takimim përmbyllës të këtij projekti, ku u prezantua metodologjia dhe u shpërndanë materiale ndërgjegjësuese. Qëllimi ishte që pjesëmarrësit, të cilët ishin përfaqësues të institucioneve arsimore, zyra rajonale të punësimit apo shërbimit social shtetëror, të merrnin dhe të zhvillonin aktivitete të ngjashme në institucionet që ata përfaqësonin, për rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi të viktimave të trafikimit.

Në datën 16 Maj 2013 u organizua tryeza e rrumbullakët: **“Shqipëria kundër homofobisë: LGBT përballë politikës, medias, të rinjve dhe masave kundër diskriminimit”**, realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta (sot Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë), Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi



dhe Avokatit të Popullit. Në këtë takim, Komisioneri mbajti fjalën përshëndetëse me temë: “Të drejtat e komunitetit LGBT si të drejta themelore të njeriut”.

Në datën 17 maj 2013, me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, KMD ka qenë pjesë e organizimit të “*Panairit të Diversitetit 2013*”. KMD kishte standin e tij në këtë panair. KMD ka marrë pjesë në takimet konsultative për organizimin e këtij Panairi, duke dhënë kontributin e tij në përgatitjen e fletëpalosjeve dhe logos së Panairit të Diversitetit.

#### • Organizimi i Ditëve të Hapura

Ditët e hapura janë realizuar nga KMD duke qenë të parashikuara si një nga komponentët e tre projekteve që po implementohen në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të kombëtare.<sup>56</sup>

Gjatë vitit 2013, KMD ka zhvilluar në total 9 Ditë të Hapura, në të cilat kanë marrë pjesë 355 pjesëmarrës nga grupe të ndryshme vulnerabël. Ditët e Hapura realizohen nëpërmjet *sesioneve informuese* dhe takimeve të drejtpërdrejta me komunitetin me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për mbrojtjen nga diskriminimi, *parashtrimin të problematikave nëpërmjet ankesave* të çdo komuniteti, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e numrit të ankesave të paraqitura dhe shqyrtuar nga KMD. Janë realizuar Ditë të Hapura, në:

- Bashkia Bajram-Curri (datë 19.09.2013); Bashkia Librazhd (datë 25.03.2013). Bashkia e Fierit (me datë 14.10.2013). Në çdo qytet morën pjesë 30-40 qytetarë.
- Komuna Shushicë (Vlorë) me dt. 28.02.2013 (rreth 40 pjesëmarrës); Bashkia Lezhë me dt. 22.02.2013 (55 pjesëmarrës); Bashkia Lushnje me dt. 13.02.2013 (70 pjesëmarrës);
- Bashkinë e Lezhës me datë 17-18 tetor 2013; Bashkinë e Shkodrës me datë 25-26 Nëntor; Bashkinë e Kukësit me datë 27 Nëntor.

#### • Rritja e vizibilitetit në media

##### *Prodhimi i një spoti publicitar dhe transmetimi në TV*

Një spot televiziv për të rritur ndërgjegjësimin e opinionit publik për ligjin dhe kompetencat e Komisionerit është përgatitur në kuadër të projektit të OSCE-ODIHR “*Best Practices for Roma Integration*” dhe është transmetuar nga data 11-18 shkurt 2013 në dy televizione kombëtare, përkatësisht: TV Klan dhe Top Channel.

##### *Pjesëmarrje në emisione dhe debate televizive*

Komisioneri dhe stafi i KMD-së kanë marrë pjesë në disa emisione televizive ku trajtohen problematikat sociale, që kanë të bëjnë me barazinë dhe mosdiskriminimin, nga ku mund të përmendim: “*Urbanika*” (A1 Report), “*Me zemër të hapur*” (Neës 24), “*Pasdite në Top Channel*”, “*Dita ime*” (Vizion Plus), “*Target*” (Albanian Screen), “*Duel*” (Tvsh), Radio Albania Neës etj.

Gjithashtu, janë dhënë deklarata për shtyp në lidhje me rritjen e dhunës ndaj grave, rastet e pedofilisë, apo edhe për aspekte të tjera të veprimtarisë së KMD-së, siç ishte rasti i

<sup>56</sup> P r m tepër referoju çështjes “Bashkëpunime”

nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Postën Shqiptare, nëpërmjet të cilës do të mundësohet shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese edhe në zonat më të thella të vendit.

Komisioneri ka botuar disa shkrime në shtypin e shkruar si dhe ka zhvilluar intervista speciale, si e ftuar, në edicionet qendrore informative të ABC Neës, Ora News dhe Albania Screen.<sup>57</sup>

- **Pjesëmarrja në Seminare, Konferenca dhe tryeza diskutimi**

Komisioneri si dhe stafi i KMD-së kanë marrë pjesë në rreth 35 seminare, konferenca dhe tryeza diskutimi mbi diskriminimin në fushën e punësimit, barazinë gjinore, ushtrimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, përfshirjen sociale të minoritetit rom në Shqipëri, të drejtat e komunitetit LGBT. Nga këto, do veçonim:

Në datën 18 mars 2013, Komisioneri mori pjesë në Konferencën Rajonale “*Të drejtat e Komunitetit LGBT në Ballkanin Perëndimor- Arritje dhe Sfida*”, të organizuar nga Ambasada PINK në bashkëpunim me COC Hollandë dhe me mbështetjen e Programit MATRA të Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulta. Në këtë konferencë Komisioneri pasqyroi sfidat e diskriminimit të Komunitetit LGBT në Shqipëri.

Në datat 30-31 Maj 2013, Komisioneri mori pjesë në seminarin e organizuar nga ECRI - Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës, me institucionet e specializuara për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial me temë “*Sfidat e ndeshura në zhvillimin institucional dhe financiar*”.

Me datë 17-19 Qershor 2013, Komisioneri mori pjesë në workshop rajonal me temë: “*Të drejtat njerëzore të Komunitetit LGBT, Trajtimi i Barabartë dhe Lufta kundër Diskriminimit*”, organizuar në Beograd, Serbi, nga “People 2 People”, Program i Komisionit Europian në bashkëpunim me Zyrën për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore të Minoriteteve në Serbi. Komisioneri mbajti një referim “*Mbi krimin e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes*” në panelin “Pesë angazhimet konkrete që Qeveritë duhet të ndërmarrin në drejtim të përmirësimit të barazisë gjinore”. Prezantimet e Komisioneres ndodhen në ëbsite Taix: [http://ec.europa.eu/enlargement/taix/dyn/taix-events/library/detail\\_en.jsp?EventID=53050](http://ec.europa.eu/enlargement/taix/dyn/taix-events/library/detail_en.jsp?EventID=53050)

Në datat 25-27 shtator 2013, Komisionerja mori pjesë në konferencën rajonale “*Sfida të Posaçme në Shqyrtimin e Ankesave mbi Diskriminimin në Baza Etnike- Shkëmbim i Përvojave të Praktikantëve nga Rajoni*”, të zhvilluar në Ohër në kuadër të projektit “*Praktikat më të mira për Integrimin e Komunitetit Rom*”, financuar nga OSBE/OHDIR. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet përfaqësuesve të organeve të barazisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga rajoni.

- **Leksione te Hapura**

Në muajin janar 2013, Komisioneri zhvilloi 2 leksione të hapura “*Mbi Rolin e Komisionerit si garant ndaj sjelljeve diskriminuese*”, në Universitetin i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, brenda Modullit “*Administrata Publike dhe Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut*”.

Në datën 15 mars 2013 është zhvilluar trajnimi i stafit pedagogjik të Shkollës “Edit’ham Durham”, për mbrojtjen nga diskriminimi në sistemin arsimor para-universitar.

---

<sup>57</sup> Shih Aneks, fq 70

### II.3. Kryerja e sondazheve dhe monitorimeve të pavarura në lidhje me diskriminimin.

Duke marr shkas nga një çështje, e shqyrtuar me iniciativën e KMD-së, në fillimin e vitit shkollor 2011-2012, lidhur me grumbullimin/veçimin në një klasë vetme të nxënësve romë, në një shkollë 9-vjeçare të Tiranës, KMD ka realizuar, gjatë vitit 2013, një monitorim për të parë shpërndarjen e nxënësve rom në të gjitha shkollat 9-vjeçare të Tiranës. Pas analizës së bërë, KMD konstatoi se *nuk kishte ndonjë tendencë të veçimit apo përqendrimit të fëmijëve rom në një shkollë të vetme*, por duke qenë se vendbanimet e komunitetit rom janë të përqendruara më pranë shkollave të caktuara, rrjedhimisht edhe numri i fëmijëve rom të regjistruar në këto shkolla është më i madh. Lidhur me këtë çështje Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandoi Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, të ndjekë në vazhdimësi frekuentimin e fëmijëve të komunitetit rom në shkollat 9-vjeçare dhe ndryshimin e raportit mes nxënësve të komunitetit rom dhe atyre jo rom, në shkollat që kanë numër më të madh të fëmijëve të komunitetit rom.

Me datë 24.05.2013, KMD ka iniciuar një çështje ex-officio “*Mbi përfitimet e ndihmës ekonomike, nga ana e banorëve të njërive të pushtetit vendor (Komuna)*”. Me anë të kësaj çështjeje, KMD do të monitorojë procedurat për të përfituar ndihmën ekonomike në Komuna. Monitorimi zhvillohet në fushën e të mirave dhe shërbimeve dhe shkak i pretenduar i diskriminimit është gjendja ekonomike. Iniciativa e Komisionerit për të zhvilluar një monitorim të tillë erdhi nga informacioni i marrë në disa ankesa të paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë një Dite të Hapur në Komunën Grabian, Lushnje, ku u evidentua se, banorët e kësaj komune nuk përfitonin ndihmë ekonomike, me pretendimin se përfshihen në kategorinë e njërive vendore të cilat janë të pajisura me tokë. Ky monitorim është në proces.

#### Monitorimi i mediave

Gjatë shqyrtimit të ankesës në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të orientimit seksual, nga mediat e shkruara dhe vizive, përmes publikimit të të dhënave personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka vendosur se transmetimi i informacionit mbi veprën penale, duke e lidhur me karakteristika personale të individit që prezumohet apo ka kryer veprën penale, edhe kur kjo karakteristikë nuk përcakton cilësimin e veprës penale, vendos një praktikë që në mënyrë të tërthortë diskriminon individët apo komunitetet për shkak të këtyre karakteristikave.<sup>58</sup>

Gjithashtu, pas marrjes së opinionit ligjor mbi këtë çështje nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin është theksuar se “*televizionet private si dhe gazetat, kanë bërë përpunimin e të dhënave personale sensitive të këtij subjekti në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, KMD ka rekomanduar që kjo çështje të trajtohet nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Gjatë shqyrtimit administrativ, KMD ka konstatuar se informacioni i dhënë në media, duke identifikuar subjektin ankues si homoseksual, mund të nxisë qëndrime negative dhe agresive

<sup>58</sup> V e n d i m nr. 97, datë 07.10.2013 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

për shkak të orientimit të tij seksual, si dhe mund të vendosë në pozita diskriminuese të gjithë komunitetin LGBT.

Për të arritur në konkluzionin nëse ky asocim bëhet mes karakteristikës personale dhe veprës penale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë muajit Mars 2013, ka bërë monitorimin e tre gazetave të përditshme dhe tre televizioneve. *Në përfundim, KMD ka vënë re se shtypi i shkruar, konkretisht tre gazetat dhe tre televizionet e monitoruara, kanë publikuar informacione duke përdorur karakteristika personale si orientimi seksual, gjendja shëndetësore apo përkatësia në komunitetin Rom.*

#### **II.4. Publikimi i raporteve dhe dhënia e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin**

*Publikimi i raporteve dhe dhënia e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin, është një aspekt i rëndësishëm ku përfshihen: adresimi i rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues; publikimi i raporteve dhe përgatitja e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; kontribuimi në raportime dhe, sipas rastit, prezantimi i raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.*

##### **II.4.1. Rekomandime Legjislative**

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet shkresës nr. 175 Prot, datë 07.03.2013 ka dërguar “Rekomandime për ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë propozimet mbi disa shtesa dhe riformulime në disa vepra penale të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Konkretisht, Komisioneri ka rekomanduar:

- Riformulim i nenit 50/j të Kodit Penal, duke përfshirë si një rrethanë rënduese për kryerjen e një veprë penale të gjitha bazat e parashikuara në Ligjin "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".
- Riformulim i nenit 84/a të Kodit Penal me qëllim për të parashikuar si vepër të veçantë penale të kanosjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit.
- Riformulim i nenit 119/a "Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik" dhe riformulimi i nenit 119 / b "fyerjeve të motivuara nga racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik", në mënyrë që të kriminalizohen këtë qëndrime për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- Shtesa e një neni të ri pas nenit 265 “nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”, me qëllim për të kriminalizuar nxitjen e urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- Riformulim i nenit 253 “Shkelja e barazisë së shtetasve”, në mënyrë që të përfshijë të gjitha bazat e diskriminimit, të parashikuara nga ligji anti-diskriminim, duke garantuar një mbrojtje më të gjerë të personave.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar në dhjetor 2013, rekomandime legislative lidhur me projekt-ligjin “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ndër të tjera, KMD ka rekomanduar:

- Riformulimin e nenit 5 të projektligjit ose shtimin e një neni të veçantë, ku të formulohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, si parime të rëndësishme që duhet të udhëheqin veprimtarinë e çdo organi publik apo subjekti privat që ushtron funksione publike.
- Shkaqet e mbrojtura nga diskriminimi duhet të jenë në harmoni me parashikimet e nenit 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Shtimin e një neni që të rregullojë barrën e provës në çështjet e diskriminimit. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në përputhje me parashikimet e direktivave të BE-së e ka parashikuar zhvendosjen e barrës së provës në procedurat përpara gjykatës, kur kjo e fundit shqyrton një padi diskriminimi dhe konkretisht në nenin 36 pika 6 e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

#### II.4.2. Opinione dhe Rekomandime të tjera për çështje diskriminimi

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka kërkuar opinion nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me një kërkesë të paraqitur nga Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, me objekt: “Deklarimi si të papajtueshëm me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kartën Sociale Europiane, i pikave 7 dhe 9 të nenit 3 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’”. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka parashtruar Opinionin Gjykatës Kushtetuese me datë 05.07.2013.

Në zbatim të nenit 32, pika 1/f ku parashikohet kompetenca e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”, janë dërguar këto rekomandime:

1. Me shkresën nr. 462 Prot datë 06.09.2013, KMD i ka dërguar rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave “për marrjen e masave urgjente për miratimin e udhëzimit të përbashkët midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave, për të siguruar kompensimin e çmimit të teksteve shkollore, për vitin shkollor 2013-2014 në sistemin arsimor para-universitar”, me qëllim parandalimin e gjenerimit të situatave diskriminuese për kategoritë e nxënësve vulnerabël, si fëmijët rom dhe egjiptian apo kategori të tjera nxënësish që ndodhen në kushteve të vështira ekonomike. Ky akt do të lejonte çeljen e fondit për të siguruar kompensimin e çmimit të teksteve shkollore për kategoritë vulnerabël të nxënësve.
2. Duke patur parasysh situatën në të cilën gjenden grupe të caktuara nxënësish dhe për të garantuar në baza të barabarta me të tjerët të së drejtës për arsimim të fëmijëve, KMD, me shkresën nr. 461 Prot, datë 05.09.2013, ka dërguar “rekomandime për marrjen e masave urgjente për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim, në fillimin të vitit shkollor 2013-2014 në sistemin arsimor para-universitar”, të gjitha Drejtorive Rajonale Arsimore të Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Nëpërmjet kësaj shkrese,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar Drejtorive Rajonale Arsimore:

- Zbatimin me efikasitet të udhëzimit të Ministrit të Arsimit Nr. 6, datë 29.03.2006 “*Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje*”, në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë të qeverisjes vendore, për të bërë të mundur regjistrimin e fëmijëve romë për vitin shkollor 2013-2014, pranë njësive vendore ku ata banojnë pavarësisht nëse ata janë të regjistruar në gjendjen civile.
  - Zbatimin dhe monitorimin e të gjitha masat e përcaktuara për sigurimin e teksteve dhe mjeteve shkollore falas për fëmijët romë që ndjekin arsimin e detyruar, në përmbushje të Planit Kombëtar të Veprimit të Dekadës së Përfshirjes Rome, 2010-2015.
  - Të kujdesen dhe të marrin masat e duhura për të evituar veçimin dhe segregimin e fëmijëve romë në zona, shkolla apo klasa të caktuara.
  - Të zbatojnë dhe monitorojnë të gjitha masat e përcaktuara për të evidentuar numrin e fëmijëve romë, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor para-universitar, sipas largësisë së qendrës së banimit me shkollën dhe të bëjnë propozimet pranë institucioneve përgjegjëse për sigurimin e transportit falas për këta fëmijë.
  - të marrin masat e parashikuara në ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “*Për sistemin arsimor para-universitar në Republikën e Shqipërisë*” për të garantuar arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke bërë funksionalë komisionet multidisiplinare për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe zbatimin e detyrimeve të tjera që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.
  - të marrin masat për të siguruar arsimimin e fëmijëve të ngujuar duke zbatuar me efikasitet udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 36, datë 13.08.2013, “*Për procedurat për arsimimin e fëmijëve të ngujuar*”.
  - të zbatojnë me përparësi për komunitetin romë edhe udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 29, datë 02.08.2013 “*Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme*” dhe udhëzimin nr. 31, datë 02.08.2013, “*Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë*”.
  - të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme masat që marrin drejtuesit e institucioneve arsimore për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në shkolla, dhe mënyrën e trajtimit të sjelljeve dhe qëndrimeve homofobike dhe stigmatizuese dhe diskriminuese ndaj nxënësve që i përkasin komunitetit LGBT, nxënësve të përkatësisë rome dhe egjiptiane, dhe nxënësit me aftësi të kufizuara.
3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nëpërmjet shkresës Nr. 367 Prot., datë 01.07.2013 ka dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Rekomandime për marrjen e masave për eliminimin nga programet e studimeve që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë publike dhe private, të literaturës që paragjykon dhe diskriminon të drejtat e komunitetit LGBT. Konkretisht, KMD ka rekomanduar:
- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të marrë të gjitha masat për të garantuar që të gjitha institucionet e arsimit të lartë private dhe publikë, gjatë procesit të miratimit të

programeve dhe planeve mësimore, si dhe literaturës që do të përdoret, të mbajnë në vëmendje ndryshimet në tekstin “Mjekësia Ligjore”, sipas propozimeve të bëra nga KMD në fund të një shqyrtimi administrativ.

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të marrë të gjitha masat për të garantuar që të gjitha institucionet e arsimit të lartë private dhe publikë, gjatë procesit të miratimit të programeve dhe planeve mësimore, si dhe literaturës që do të përdoret, të evitojnë përfshirjen e teksteve dhe literaturës, që kanë në përmbajtjen e tyre parashikime dhe koncepte diskriminuese.
  - Të sillen në kujtesë të drejtuesve të institucioneve arsimore publike dhe private, detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
4. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të monitorimit të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ku garantohet mbrojtje e posaçme e individëve nga diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur dhe t’u zgjedhur, ka kërkuar informacion “për masat e marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në kuadër të procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme të datës 23 qershor 2013, për të garantuar të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara”. Nëpërmjet kësaj shkrese, KMD ka kërkuar:
- Informacion lidhur me faktin nëse detyrimi për identifikimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara është respektuar nga njësitë e qeverisjes vendore
  - Respektimin e detyrimit për vendosjen e qendrave të votimit në katet e para të objekteve nga ana e qeverisjes vendore
  - Masat e marra, duke përfshirë masat administrative dhe ato financiare, për të garantuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara në mjediset e votimit dhe garantimin efektiv të të drejtës për të votuar për këtë kategori zgjedhësish.
  - Masat e marra për të garantuar të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara që e kanë të pamundur të dalin nga shtëpia e të jenë prezent në qendrat e votimit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka informuar me shkresë KMD lidhur me masat e ndërmarrja lidhur me pikat e mësipërme. Në vijim, KMD sërish ka kërkuar një vëmendje të veçantë lidhur me këto dy pika:

*Së pari*, masat e marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e detyrimit për vendosjen e qendrave të votimit në katet e para të objekteve nga ana e qeverisjes vendore.

*Së dyti*, KMD theksoi nevojën e gjetjes së zgjidhjeve të përshtatshme për garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara që nuk dalin dot nga shtëpia e kjo kategori të shihen me prioritet pasi mund të mos kenë patur as një here mundësinë për të ushtruar të drejtën e votës, një e drejtë Kushtetuese.

#### **II.4.3. Rekomandime për përmirësimin e situatës së grupeve vulnerabël**

Në kuadër të projektit me titull “Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar”, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zvicëran në Tiranë, u zhvilluan sesione informuese, Ditë e Hapur dhe takime me OJF-të, në Lezhë, Shkodër dhe Kukës, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për Ligjin “Për mbrojtjen nga

*diskriminimi*” dhe zbatimin e tij të plotë nga gjithë aktorët. Në Ditët e Hapura, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe KShH kanë konstatuar problematikat e komuniteteve, në bazë të të cilave, KMD ka dërguar, autoriteteve qendrore dhe vendore përgjegjëse, rekomandime për përmirësimin e situatës për grupet vulnerabël, si më poshtë:

- Me shkresën nr. 644 Prot, datë 11.11.2013, KMD i ka dërguar *Zyrës Rajonale të Punësimit, Lezhë, rekomandim për nxitjen e programeve të punësimit për grupet vulnerabël*, kryesisht për komunitetin rom/egjiptian dhe për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Me shkresën nr. 643 Prot, datë 11.11.2013, KMD i ka dërguar *Bashkisë Lezhë, rekomandim për nxitjen e programeve të punësimit për grupet vulnerabël*, në respektim të kuadri ligjor dhe rregullator ekzistues. KMD i ka rekomanduar gjithashtu Bashkisë Lezhë që të ndërmjetësojë me bizneset private të kontraktuara nga vetë Bashkia për nxitjen e punësimit dhe marrjen e veprimeve pozitive për këtë qëllim, përmes vendosjes së kuotave.
- Me shkresën nr. 655 Prot, datë 12.11.2013, KMD i ka dërguar *Policisë Bashkiake të qarkut Lezhë, rekomandim për marrjen e masave për sistemin e tregtarëve rom në vende ku ata mund të ushtrojnë aktivitetin tregtar në mënyrë të barabartë me të tjerët si dhe të shmangin në të ardhmen sjelljet diskriminuese në drejtim të tyre.*
- Me shkresën nr. 653 Prot, datë 12.11.2013, KMD i ka dërguar *Drejtorisë Arsimore Rajonale, Lezhë, rekomandim për sjelljen në vëmendje të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.* Në këtë kudër, KMD ka rekomanduar Drejtorisë Arsimore Rajonale, Lezhë, zbatimin me efikasitet të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit Nr. 29 datë 02.08.2013 “*Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme*”, përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ligji “*Për sistemin arsimor para-universitar në R.Sh*”, si dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji 10221/2010 “*P r Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.
- Me shkresën nr. 656 Prot, datë 13.11.2013, KMD i ka dërguar *Zyrës së Gjendjes Civile , Lezhë, rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit rom në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual.*
- Me shkresën nr. 642 Prot, datë 11.11.2013, KMD i ka dërguar *Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, rekomandim për marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve që cenojnë dinjitetin e individit për shkak të përkatësisë së tij etnike dhe trajtimin me efektivitet të denoncimeve të bëra nga qytetarët pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.*
- Me shkresën nr. 641 Prot, datë 11.11.2013, KMD i ka dërguar *Drejtorisë së Policisë të Qarkut Lezhë, rekomandim për marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve që cenojnë dinjitetin e individit për shkak të përkatësisë së tij etnike dhe trajtimin me efektivitet të denoncimeve të bëra nga qytetarët pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.*
- Me shkresën nr. 654 Prot, datë 12.11.2013, KMD i ka dërguar *Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave, rekomandim për marrjen e masave për eliminimin e vonesave të pagesës së Ndihmës Ekonomike të Personave me Aftësi të Kufizuara.*
- Me shkresën nr. 646 Prot, datë 11.11.2013, KMD i ka dërguar *Bashkisë Lezhë rekomandim për trajtimin me përparësi të familjeve romë më përfitimin e banesave sociale me qera.*
- Me shkresën nr. 769 Prot, datë 19.12.2013, KMD i ka dërguar *Bashkisë Shkodër rekomandim për nxitjen e programeve të punësimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian dhe Personat me Aftësi të Kufizuara.* KMD i ka rekomanduar gjithashtu Bashkisë Shkodër



- që të ndërmjetësojë me bizneset private të kontraktuara nga vetë Bashkia dhe marrjen e veprimeve pozitive për këtë qëllim, përmes vendosjes së kuotave.
- Me shkresën nr. 702 Prot, datë 10.12.2013, KMD i ka dërguar *Zyrës Rajonale të Punësimit, Shkodër, rekomandim për nxitjen e programeve të punësimit për grupet vulnerabël*, kryesisht për komunitetin rom/egjiptian dhe për Personat me Aftësi të Kufizuara si dhe marrjen e veprimeve pozitive të cilat synojnë nxitjen e punësimit për grupet vulnerabël
  - Me shkresën nr. 768 Prot, datë 19.12.2013, KMD i ka dërguar *Bashkisë Shkodër rekomandim për ndërtimin e një mbikalimi* poshtë kalasë së qytetit, për banorët e lagjes “Iliria”, ku banojnë komunitet egjiptian, me qëllim minimizimin e rrezikut të jetës dhe përmirësimin e situatës në të ardhmen.
  - Me shkresën nr. 770 Prot, datë 19.12.2013, KMD i ka dërguar *CEZ Shpërndarje Sh.a, Shkodër, rekomandim për marrjen e masave për sistemimin e kablllove të energjisë elektrike të amortizuar në lagjen “Iliria”,* ku banojnë komunitet egjiptian.
  - Me shkresën nr. 767 Prot, datë 19.12.2013, KMD i ka dërguar *Bashkisë Kukës rekomandim për nxitjen e programeve të punësimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian dhe Personat me Aftësi të Kufizuara.* KMD i ka rekomanduar gjithashtu Bashkisë Kukës që të ndërmjetësojë me bizneset private të kontraktuara nga vetë Bashkia dhe marrjen e veprimeve pozitive për këtë qëllim, përmes vendosjes së kuotave.

#### II.4.4. Publikimi i raporteve të veçanta

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa (f) të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se Komisioneri ka kompetencë “*të publikojë raporte (...) për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*”, KMD ka përgatitur dy Raporte të Veçanta:

- Raport të Veçantë “*Mbi situatën e diskriminimit të komunitetit rom*”;
- Raport të veçantë “*Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri*”.

Disa nga gjetjet në këto raporte janë përfshirë në Kapitullin I “Mbi situatën e diskriminimit në Shqipëri”. Gjatë tre-mujorit të parë të vitit 2014 po përgatiten raportet për botim.

#### II.4.5. Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Në nenin 26 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcaktohet detyrimi ligjor i Komisionerit për te raportuar në Kuvendin e R.Sh ku thuhet shprehimisht se “*Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e komisionerit dhe të zyrës*”.

Në hartimin e Raporteve Vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi shërbejnë edhe raportimet 3-mujore të KMD-së pranë Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, në Kuvendin e R.SH-së.

Me datë 8 mars 2013, KMD ka raportuar ne takimin e IV<sup>të</sup> të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në Bruksel.

Në datat 17-18 Prill 2013 KMD ka raportuar në Takimin e V<sup>të</sup> të Nënkomitetit për *Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë* BE-Shqipëri, i cili u zhvillua në Buksel.

KMD ka raportuar pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të Raportit të Dytë Periodik Shqiptar për *Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*, i cili u mor në shqyrtim në data 15-16 Korrik 2013, në Gjenevë.

Komisioneri ka raportuar në kuadër të Takimit të pestë të Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për *Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikat Sociale*, BE-Shqipëri, zhvilluar me datë 28-29 Tetor 2013, në Tiranë.

Me datë 6 Nëntor 2013, Komisioneri ka raportuar në kuadër të zbatimit të *Paktit për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore* pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut, në Gjenevë.

Me datë 20 Nëntor 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar informacion Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, lidhur me plotësimin e Pyetësorëve në zbatim të Konventës së Këshillit të Evropës "*Mbrojtja e Fëmijëve nga Abuzimi Seksual dhe Shfrytëzimi Seksual*".

Me datë 27 Nëntor 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar informacion Ministrisë së Punëve të Jashtme, lidhur me hartimin e Raportit Kombëtar në kuadër të Mekanizmit Universal Periodik (UPR) për të Drejtat e Njeriut.

### **Seancat Publike në Kuvendin e Shqipërisë**

23.10.2013 - Seancë dëgjimore për masat e marra për *strehimin e familjeve romë dhe për pagesat e Personave me Aftësi të Kufizuara* në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Duke qenë se romët edhe personat me aftësi të kufizuara janë dy nga kategoritë me të cilët KMD zhvillon pjesën më të madhe të punës, Komisionerja theksoi problematikat e këtyre grupeve vulnerabël si dhe rekomandimet nxjerra për përmirësimin e situatës së tyre.

09.12.2013 - Seancë dëgjimore për *parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it*, zhvilluar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, ku Komisionerja parashtrroi problematikat që hasin personat e prekura me HIV/AIDS, sipas konstatimeve të bëra nga puna e Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

02.12.2013 - Seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile, *me rastin e 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave*, në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Një përfaqësuese e KMD ishte pjesë e kësaj seanca, e bëri një prezantim të konstatimeve të disa rekomandimeve, në drejtim të luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj gruas.

13.11.2013 - *Seancë dëgjimore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri*, zhvilluar nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Komisionerja prezantoi aktivitetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, i fokusuar në: - ndërgjegjësim të komunitetit të shoqërisë në tërësi dhe trajnim të aktorëve të përfshirë - monitorime dhe asistencë ndaj fëmijëve, viktimë të diskriminimit. - rekomandime (ligjore apo për çështje të veçanta diskriminimi).

20.11.2013 - *Seancë dëgjimore për Progres-Raportin e vitit 2013 me Avokatin e Popullit dhe Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

## II.5. Rritja e kapaciteteve të stafit të KMD-së

Në zbatim të projektit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me temë “*Zbatimi i parimit të barazisë gjinore dhe programit të dhunës me bazë gjinore*”, implementuar në bashkëpunim me PNUD, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2013, KMD është asistuar në veprimtarinë e tij nga një Grup Ekspertësh (i përbërë nga 4 studiues të së drejtës dhe një ekspert ndërkombëtar, me eksperiencë në institucionet e barazisë) në marrjen e vendimeve dhe hartimin e opinioneve legislative.

Gjithashtu, po në kuadër të këtij projekti, është pregatitur për botim një përmbledhje me Vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës Europiane të Drejtësisë si dhe Institucioneve të Barazisë të vendeve të BE-së, të cilat janë përkthyer në shqip.

Gjatë vitit 2013, Zyra e KMD-së ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh me qëllim rritjen e kapaciteteve për stafin e KMD, nga ku veçojmë:

Në datat 14-15 maj 2013, gjashtë punonjës të Zyrës së KMD-së morën pjesë në trajnimin me temë “*Parandalimi dhe luftimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, në kuadrin e drejtësisë gjinore*”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në kuadër të Programit të Trajnimit Vazhdues për vitin akademik 2012-2013, në bashkëpunim me PNUD.

Me datë 7 qershor 2013, dy përfaqësues nga Zyra e KMD-se si dhe Komisioneri morën pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë “*Zbatimi i urdhrave të mbrojtjes në kuadrin e masave për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje*”, organizuar në kuadër të projektit “*Parandalimi dhe luftimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, në kuadrin e drejtësisë gjinore*”, të Shkollës së Magjistraturës, mbështetur nga UNDP.

Në datat 12 - 13 Qershor 2013, me ftesë të Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE), një punonjës i Zyrës së Komisionerit mori pjesë në aktivitetet e organizuara nga Instituti, në Bruksel. Instituti organizoi në datë 12 qershor 2013 në ambientet e Këshillit të BE-së, takimin e zyrtarëve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në BE, për prezantimin e veprimtarisë së këtij Instituti, diskutimin mbi çështjet e barazisë gjinore dhe sjelljen e eksperiencave të vendeve pjesëmarrëse. Në datën 13 Qershor 2013, Instituti zhvilloi një Konferencë për lançimin e Indeksit të Barazisë Gjinore (Gender Equality Index).

Në datat 18-22 nëntor 2013, një përfaqësues i Zyrës së KMD mori pjesë në vizitën studimore të zhvilluar në Suedi pranë Institutit Suedez. Objektivi kryesor i këtij aktiviteti ishte njohja e delegacionit të Ballkanit me mënyrën e trajtimit të çështjeve LGBT nga Suedia, njohja me institucionet që merren me këto çështje si dhe mënyra e organizimit të paradës së përvitshme të komunitetit LGBT.

Në datat 1-7 dhjetor 2013 Komisionerja dhe pesë pjesëtarë të stafit të KMD-së zhvilluan një vizitë studimore në Suedi dhe Danimarkë. Institucionet e vizituara përfshijnë Institutin Danez për të Drejtat e Njeriut, Bordin Danez të Trajnimit të Barabartë, Shoqatën e Studiove Ligjore Daneze, Bordin Danez të Avokatëve si dhe Institutin Raoul Ëallenberg për të

Drejtat e Njeriut dhe të Drejtën Humanitare në Lund të Suedisë. Kjo vizitë studimore mbështetet nga programi i UNDP për barazinë gjinore dhe dhunën në familje me financim të Qeverisë Suedeze.

## II.6. Bashkëpunime

### II.6.1. Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare dhe OJF-të përmes projekteve të përbashkëta.

➤ Projekti i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, implementuar në bashkëpunim me PNUD, me temë: *“Zbatimi i parimit të barazisë gjinore dhe programit të dhunës me bazë gjinore”*

Qëllimi i këtij projekti është “Rritja e efektivitetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në trajtimin e çështjeve të diskriminimit me bazë gjinore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve profesionale të stafit të tij dhe ngritja e ndërgjegjësimit të komunitetit”.

Aktivitetet që janë ndërmarrë në kuadër të këtij objekti janë:

- Vizita studimore të stafit profesional të Zyrës së Komisionerit në zyrat homologe, të planifikuara për t’u realizuar me qëllim njohjen dhe marrjen e praktikave më të mira për adresimin e çështjeve të diskriminimit.
- Jurisprudencë e përkthyer në shqip të vendimeve historike të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës Europiane të Drejtësisë, Komitetit CEDAW dhe institucioneve të barazisë, veçanërisht nga Shtetet e Europës Perëndimore, mbi çështjet e barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit, të cilat synojnë që ti shërbejnë si referencë stafit të KMD-së për zgjidhjen e çështjeve.
- Me qëllim rritjen e profesionalizmit të stafit të KMD-së, është krijuar një grup me ekspertë të jashtëm të fushës së diskriminimit. Roli i këtij grupi konsiston në analizimin dhe këshillimin mbi çështje dhe vendime të Komisionerit që i përkasin fushës së diskriminimit, për shkaqe të ndryshme.

Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbrojtjen nga diskriminimi përmes organizimit 10 Ditë të Hapura në: Tiranë, Durrës, Fier, Skrapar, Përmet, Sarandë, Tropojë, Lezhë, Burrel, Shkodër. Organizimi i këtyre takimeve synon që të informojnë dhe të ndërgjegjësojë popullsinë mbi rolin e KMD-së si dhe të rrisë numrin e ankesave që do të paraqiten në Zyrën Komisionerit apo në Gjykatë. Në këto Ditë të Hapura janë formalizuar edhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Kryetarët e Bashkive respektive.

Media është përdorur si një mjet për informimin e publikut mbi legjislacionin anti-diskriminim dhe t’i inkurajojë ata që përdorë shërbimet e Komisionerit Anti-Diskriminim. Trajnimi i gazetarëve për raportimin e çështjeve të diskriminimit është një tjetër aktivitet i cili është zhvilluar në zbatim të këtij projekti. Pjesmarrja në programe dhe artikuj të ndryshëm është realizuar me qëllim që t’i shpjegohet publikut procesi i ankimit.

- Projekti i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ”, implementuar nga **ODIHR**, në kuadër të projekti rajonal (EU) – OSCE – ODIHR, me temë: **“Praktikat më të mira për integrimin e komunitetit rom”**

Objektivat e projektit janë:

1. Forcimi i kapaciteteve të aktoreve shtetërore duke përfshirë Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore për sigurimin e barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi
2. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian mbi Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi
3. Krijimi dhe forcimi i lidhjeve midis Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe njësite të qeverisjes lokale për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Kjo lidhje dhe bashkëpunim fillon me caktimin e një personi si pikë kontakti në strukturën e bashkisë/komunës dhe me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit, të nënshkruar mes KMD dhe njësite të qeverisjes vendore përkatëse;
4. Mbështetje për organizimin e Ditëve të Hapura në Zyrat e qeverisjes lokale, nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të shpjeguar banorëve lokal, duke përfshirë romët dhe egjiptianët, mënyrën se si mund të ankohen tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Aktivitetet që u ndërmorën në kuadër të këtij objekti janë:

- Prodhimi dhe shfaqja e një Spoti televiziv me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë mbi ligjin dhe kompetencat e KMD
- Organizimi i Ditëve të Hapura në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore në 7 bashki dhe komuna: Bashkia Lezhë, Komuna Sushice, Bashkia Lushnjë, Komuna Grabian, Bashkia Pogradec, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Tiranë.
- Gjatë zhvillimit të këtyre Ditëve të Hapura, Komisioneri nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Kryetarët e Bashkive apo komunave respektive dhe vendosja e një pikë kontakti, nga stafi i KMD-së, në mënyrë që të referohen raste tek zyra e Komisionerit dhe të organizohen Ditë të Hapura në mënyrë periodike.
- Fushata ndërgjegjësimi 2-ditore.

➤ Projekti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë, me temë: **“Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të iskriminuar”**

Ky projekt synon që të rritet aksesin e qytetarëve tek zyra e Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nëpërmjet OJF-ve dhe organeve të qeverisjes vendore si dhe të rritet ndërgjegjësimi për Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe zbatimin e tij i plotë nga të gjithë aktorët e përcaktuar në ligj. Në kuadër të projektit janë zhvilluar *sesione informues* mbi

ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” me përfaqësues të organeve të pushtetit vendor, Drejtorive Rajonale të Arsimit, Drejtorisë Rajonale të Punësimit dhe përfaqësues të personelit pedagogjik të shkollave, u realizuan *Ditë të Hapura* për komunitetin qytetar, ku u zhvilluan takime të drejtpërdrejta dhe u morën ankesa nga qytetarët, si dhe *programe televizive* në mediat lokale. Gjithashtu, është përgatitur një Manuali i Trajnimit: “*Mbrojtja nga Diskriminimi – Manual Trajnimi për OJF-të*”, i cili ka përfunduar në gusht 2013. Në zbatim të objektivave specifik të këtij Projekti, do të krijohet një netëork me OJF-të lokale.

## II.6.2. Nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit

Në kuadrin e vendosjes së bashkëpunimit institucional, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nënshkruar 32 Marrëveshje Bashkëpunimi, me Institucionet Shtetërore, Organet e Qeverisjes Vendore dhe OJF kombëtare dhe lokale. Konkretisht, KMD ka nënshkruar këto marrëveshje bashkëpunimi:

- Institucionet Shtetërore
  1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, datë 20.02.2013
  2. Postën Shqiptare Sh.a, datë 18.12.2013
- Organet e Qeverisjes Vendore

Në kuadër të realizimit të Ditëve të Hapura, KMD ka nënshkruar *Marrëveshje Bashkëpunimit* me organeve të qeverisjes vendore respektive, me qëllim konsolidimin e bashkëpunimit, kryesisht për lehtësimin e procesit të paraqitjes së ankesave, nga qytetarët e këtyre njësive vendore. Konkretisht, KMD ka nënshkruar:

1. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Bashkinë Bajram-Curri, datë 19.09.2013
  2. Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë e Kuçovës, datë 10.05.2013
  3. Marrëveshje e Bashkëpunimit me Bashkinë Tiranë, datë 19.04.2013
  4. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Bashkinë Librazhd, datë 25.03.2013
  5. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Komunën Shushicë (Vlorë), datë 28.02.2013
  6. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Bashkinë Lushnje, datë 13.02.2013
  7. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Bashkinë Fier, datë 14.10.2013
  8. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Bashkinë Patos, datë 16.12.2013
  9. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Bashkinë Kukës, datë 19.12.2013
- Organizatat jo-fitimprurëse
    1. Shoqata “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT (Pro LGBT)”, datë 05.07.2013
    2. Aleanca kundër Diskriminimit, datë 05.07.2013
    3. Shoqata “Open Mind Spectrum Albania (OMSA)”, datë 10.05.2013
    4. Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri, datë 18.04.2013
    5. Organizatës “Të Ndryshëm&Të Barabart ” 12.04.2013
    6. Shoqata Rromani Baxt-Shqipëri, datë 25.03.2013
    7. Shoqata Roma Women Rights, datë 25.03.2013
    8. Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, datë 25.03.2013
    9. Shoqata Rromano KHAM, datë 25.03.2013
    10. Shoqata e Komunitetit Egjiptian “Jemi edhe Ne”, datë 25.03.2013
    11. Shoqata MEDPAK, datë 25.03.2013

12. Shoqata Amaro Drom, datë 25.03.2013
13. Shoqata Disutni Albania, datë 25.03.2013
14. Shoqata Roma Active Albania, datë 25.03.2013
15. Shoqata Qendra e Gruas Rome për Zhvillim”, datë 25.03.2013
16. Shoqata Rome për Integrim, datë 25.03.2013
17. Shoqata SFINKSI, datë 15.03.2013
18. Shoqata “Shpresë për të Varfrit, datë 28.02.2013
19. Shoqata “Integrimi i Romëve të Veriut”, datë 28.02.2013
20. Ambasada Pink/LGBT Pro Shqipëri, datë 26.02.2013
21. Shoqata Romët e Veriut, datë 26.02.2013

Një aspekt tjetër i rëndësishëm gjatë nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit është caktimi i një pike kontakti respektive që do të lehtësojë nga njëra anë, bashkëpunimin mes KMD-së dhe pushtetit vendor dhe nga ana tjetër, do të lehtësojë procedurën e shqyrtimit të ankesave dhe problemeve që komuniteti ka në këto njësi administrative.


### KAPITULLI III

#### ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

##### III.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse gjatë vitit 2013 ka pasur në qendër të vëmendjes menaxhimin me efikasitet të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike, të vëna në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Struktura dhe organika e institucionit të Komisionerit është miratuar me vendimin nr. 34, datë 20.05.2010 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Struktura e Zyrës së Komisionerit sipas këtij vendimi paraqitet si më poshtë:



Në bazë të ligjit nr.8549,datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, për vitin 2013 pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk është zhvilluar asnjë konkurim për pozicione të lira pune, por bazuar në nenin 14 të Ligjit “Statusi i Nëpunësit Civil” kanë marrë konfirmimin si nëpunës civil 6 punonjës.

##### III.2. Menaxhimi i burimeve financiare

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në zbatimin të buxhetit të vitit 2013, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.



Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektësi në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06. 2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për Buxhetin e vitit 2013", në vijim Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 06. 02. 2012, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit dhe zbatimin të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1/1 datë 19.02.2013 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2013",

### **Programi "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"**

Buxheti i akorduar për këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit: Organizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për mirëfunksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me legjislacionin e vendeve të tjera të bashkimit europian; sigurimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe hartimi i strategjive për realizimin e këtij synimi; vendosja e marrëdhënjeve dhe hartimi marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që ndikojnë në zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e zbatimit të parimit të barazisë; nxitja dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve që kanë interes të drejtpërdrejtë si dhe të gjithë shoqërisë mbi mundësitë e zbatimit të parimit të mësipërm, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 2 datë 06. 02. 2012, "**Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit**", pika VI - Raportet e Monitorimit, po Ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2013, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond i planifikuar prej **35.400 në mijë lekë**, i shkurtuar në vlerën **2.200 në mijë lekë** në zërin 602. Totali i vlerës së akorduar duke përfshirë edhe fondin e donatorëve është **34.185,24 në mijë lekë** dhe përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	21. 500	<i>mijë lekë (zëri 600)</i>
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	4. 700	<i>mijë lekë (zëri 601)</i>
Fondi për Shpenzime Operative:	5. 000	<i>mijë lekë (zëri 602)</i>
Fondi për Investime:	2. 000	<i>mijë lekë (zëri 231)</i>
Fondi i Donacioneve:	985, 24	<i>mijë lekë (zëri 602)</i>

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në zbatim të regjistrit të parashikimeve të vitit 2013, për periudhën 12 – mujore, ka realizuar nga fondet buxhetore vlerën **26.486,69 në mijë lekë** ose **79,30 %** e buxhetit të akorduar për periudhën e 12 - mujore prej **33.200,00 në mijë lekë**.

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore**, (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 34 datë 20. 05.2010 “Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, numri mesatar i punonjësve është realizuar 21 vetë, nga 23 vetë të miratuar.

Fondi i 12-mujorit për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore ka qënë **26.200,00 në mijë lekë** dhe është realizuar respektivisht:

- **17.200,12 (në mijë lekë)** për paga nga zëri 600
- **2.613,86 (në mijë lekë)** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore nga zëri 601

ose **75.63 %** e fondit të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore nuk është realizuar plotësisht si rrjedhojë e lëvizjes së personelit në institucione të tjera dhe për specializime. Diferenca referuar fondit në zërin paga dhe sigurime shoqërore, për shkak të lëvizjeve të personelit, është **24,37%** e totalit për 12-mujorin. Institucioni jonë ka bërë kërkesë për ndryshimin e strukturës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

**Fondi për shpenzim investime** (zëri 231): nga vlera e përgjithshme prej **2.000 (në mijë lekë)** për periudhën e raportuar është realizuar vlera prej **1.746,77 (në mijë lekë)** ose **87,34 %**, e fondit të planifikuar “Blerje pajisje kompjuterike dhe informatike”.

**Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime** (zëri 602); për vitin 2013, është planifikuar në vlerën **7.200,00 në mijë lekë** dhe është shkurtuar në vlerën **2.200,00 në mijë lekë**. Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar vlera prej **4.925,94 (në mijë lekë)** ose **98,52 %**, e fondit 12 - mujor të planifikuar në vlerën **5.000,00 në mijë lekë**.

**Fondi i Donacioneve** (zëri 602); për vitin 2013, është në vlerën **985,24 (në mijë lekë)** (fonde aktive). Këto fonde ndahen në dy donator:

1. UNICEF me vlerë **96,00 (në mijë lekë)** e cila është realizuar **100%** e fondit të planifikuar vjetor të mbartur nga viti 2012.
2. UNDP me një projekt me vlerë totale **2.482,20 (në mijë lekë)**. Ky projekt parashikon xhirimin e fondeve nga ana donatorit në tre keste. Kësti i parë i xhiruar në Tetor 2012 ka vlerë prej **940,00 (në mijë lekë)**. Në 2012 është përdorur vetëm në vlerën **68,5 (në mijë lekë)** dhe diferenca prej **871,5 (në mijë lekë)** është përdorur në vlerën **781,14 (në mijë lekë)**. Pjesa e mbetur nga kesti i parë prej **90,36 (në mijë lekë)** si dhe dy këstet e tjera të parashikuara nga projekti do të përdoret gjatë vitit 2014.
3. INSIG me vlerë **17.74 (në mijë lekë)** e cila është realizuar **100%** e fondit të planifikuar.

## REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Bazuar në situatën e e konstatuar mbi zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë të paraqitur në këtë raport si dhe duke u bazuar njëkohësisht në veprimtarinë dhe ankesat e trajtuara nga institucioni gjatë vitit 2013, janë evidentuar disa çështje dhe problematika kryesore që kanë nevojë të adresohen në mënyrë që të garandohet respektimi i parimit të barazisë.

Konkretisht kërkohet nga të gjithë institucionet dhe autoritetet përgjegjëse:

1. Ekzistojnë një sërë aktesh ligjore dhe politika që kanë parashikime dhe masa për mbrojtjen nga diskriminimi. Krijimi i një dokumenti strategjik kombëtar për luftën kundër diskriminimit, do të koordinonte më mirë të gjitha masat në fuqi dhe veprimet e autoriteteve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencës. Ky është një rekomandim i adresuar edhe në Raportin Vjetor 2012 të KMD-së.
2. Janë miratuar dokumenta strategjikë kombëtarë që parashikojnë marrjen e masave për të përmirësuar kushtet e disa grupeve vulnerabël të shoqërisë siç janë; romët, personat me aftësi të kufizuar, gratë, fëmijët, personat në kushtë jo të mira ekonomike, personat LGBT. Në mënyrë që të garantohen të drejtat e tyre është thelbësore jo vetëm një bashkëpunim më i mirë mes pushtetit qendror dhe atij vendor, por kërkohet nga ky i fundit që të marri masa për zbatimin e parashikimeve që janë bërë për këto grupe të marginalizuara.
3. Duhet një studim legjislativ për të eliminuar të gjitha dispozitat që paraqesin tendencë diskriminuese me bazë gjinore si dhe përcaktimi i qartë i mekanizmit përgjegjës për mbrojtjen dhe promovimin e barazisë gjinore.
4. Në mënyrë që të sigurohet një monitorim më i mirë i situatës së diskriminimit kërkohet krijimi i një sistemi të centralizuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për çështjet e diskriminimit. Ky sistem duhet të gjenerojë të dhëna mbi shkaqet e diskriminimit, format e shfaqjes së diskriminimit, fushën e diskriminimit, të dhëna mbi viktimat e diskriminimit dhe autorët e konsumimit të sjelljeve diskriminuese.
5. Duhet që në çdo rast të nxitet përfshirja e grupeve vulnerabël në të gjitha fushat dhe veçanërisht kërkohet nga autoritetet publike që në çdo rast të përfshijnë dhe konsultojnë këto grupe kur ato trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me interesat e tyre.
6. Kërkohet që dokumentat strategjikë kombëtarë apo lokale dhe planet e tyre të veprimit për grupe vulnerabël si gratë, fëmijët, personat LGBT, rom, personave me aftësi të kufizuar, të integrohet në të gjitha vendimarrjet dhe politikat e autoriteteve publike.
7. Kërkohet një ndërhyrje në kurrikulat e sistemit arsimor, tekstet shkollore, në mënyrë që të përfshihen në programet arsimore konceptet e diskriminimit, format e shfaqjes së tij. Gjithashtu kurrikulat duhet të përfshijnë konceptet bazë për: barazinë gjinore, racën dhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Kjo shërben për të rritur ndërgjegjesimin,

- respektin për diversitetin, tolerancën dhe për të luftuar stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimin.
8. Duhet marrë masa për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të drejtuesve të institucioneve arsimore, mësuesve dhe nxënësve, për të forcuar kapacitetet e tyre për identifikimin e diskriminimit në shkolla dhe trajtimin efektiv të rasteve dhe ankesave për diskriminim.
  9. Duhet nxitur dialogu social në ambientet universitare për të diskutuar dhe trajtuar problematika dhe çështje të lidhura me diskriminimin dhe luftën kundër tij.
  10. Duhet marrë masa për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të administratës publike dhe punonjësve të sektorit privat, për të rritur ndërgjegjësimin mbi çështjet e diskriminimit. Gjithashtu, nevojitet një monitorim në fushën e punësimit në sektorin privat me qëllim që të evidentohet situata e diskriminimit në këtë fushë.
  11. Duhet të bëhen trajnime për grupe të veçanta profesionale si: Gjyqtarë, punonjësit e policisë, punonjësit e institucioneve të vuajtjes së dënimit, mjekë, prokurorë dhe avokatë.
  12. Duhet të merren masa për të garantuar zbatimin efektiv të legjislacionit të ri të miratuar në fushën e arsimit, legjislacionit në fushën e punësimit dhe formimit profesional, duke eliminuar barrierat në ndërtesa, transport, informacion, komunikim, si dhe në çdo aspekt tjetër të shërbimeve që janë publike, për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë në baza të barabarta me të tjerët dhe pa u diskriminuar të drejtat dhe liritë që garantohen.
  13. Duhet të miratohen edhe ndryshimet e tjera që ka propozuar KMD në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë për të garantuar një mbrojtje më të plotë dhe më efektive nga diskriminimi.
  14. Duhet që institucionet publike të zhvillojnë mekanizma për të mbështetur KMD-në, në kohë dhe me të gjithë informacionin e kërkuar për shqyrtimin e çështjeve të diskriminimit.
  15. Për të adresuar nënraportimin e çështjeve të diskriminimit është e nevojshme krijimi i zyrave rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
  16. Media duhet të japë një kontribut të madh në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, duke luftuar në këtë mënyrë stereotipet dhe paragjykimet që mund të ekzistojnë ndaj minoriteteve apo grupeve të caktuara sociale të marginalizuara. Është e domosdoshme të nxitet media për të rritur ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen nga diskriminimi.
  17. Media duhet të jetë më e hapur për të pasqyruar me objektivitet çështjet e diskriminimit dhe problematika të grupeve vulnerabël. Media përveç problematikave duhet të promovojë modele pozitive, suksesi dhe tolerance.

## ANEKS

### AKTIVITETE TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Gjatë vitit 2013, Zyra e KMD-së ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh, me qëllim rritjen e kapaciteteve si dhe forcimin e bashkëpunimit me institucione shtetërore apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut. Disa nga këto aktivitete renditen si më poshtë:

Në datën 25 janar 2013, pjesëmarrja e stafit të KMD në Konferencën për Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2013-2020, të organizuar nga Departamenti i Administratës Publike.

Një specialist i Zyrës së Komisionerit, duke qenë pikë kontakti mes KMD-së dhe njësive të qeverisjes vendore, koordinoi dhe asistoi takimin e zhvilluar në datën 4 mars 2013, në Bashkinë Elbasan midis Kryetarit të Bashkisë Elbasan dhe Ambasadës PINK/LGBT Pro Shqipëri, në kuadër të krijimit të rrjetit “Miq të LGBT”. Pjesëmarrja në këtë takim vjen si mbështetje e KMD-së për organizatat që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT në Shqipëri.

Me datë 13 mars 2013, punonjës të Zyrës së KMD-së morën pjesë në Tryezën e rrumbullakët “Roli i shoqërisë civile në zbatimin e legjislacionit Shqiptar dhe standarteve ndërkombëtare në këndvështrimin gjinor”, organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me mbështetjen e UNDP-së dhe Qeverisë Suedeze.

Në datat 8-10 prill 2013, dy punonjës të Zyrës së KMD-së morën pjesë në trajnimin me temë “Integrimi gjinor për Punonjësit në nivel vendor të Barazisë Gjinore”, organizuar nga OSBE në bashkëpunim me Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Në datën 17 maj 2013, me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, KMD ka qenë i pranishëm në përrurimin e Kopshtit të Diversitetit, organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe PNUD si dhe në Paradën e Bicikletave organizuar nga Aleanca Gjinore dhe Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT (Pro LGBT).

Me datë 20 maj 2013, një përfaqësues nga Zyra e KMD-se mori pjesë në tryezën e diskutimit me temë “E drejta për punësim për personat me aftësi të kufizuara” organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi mbi Paketën Orientuese të Ndryshimeve Ligjore për Nxitjen e Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në datat 6-7 qershor 2013, dy punonjës të Zyrës së Komisionerit morën pjesë në workshop-in me temë “Mënyrat efektive për të luftuar diskriminimin në Ballkanin Perëndimor”, të organizuar nga Civil Rights Defenders.

Me datë 6 qershor 2013, një përfaqësues i Zyrës së KMD-së mori pjesë në Konferencën Kombëtare “Fëmijëri e Mbrojtur, Fëmijëri e Sigurt – Progres për një Shoqëri dhe Shtet të Zhvilluar”, organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Në datën 17 Shtator 2013, Këshilltari dhe një punonjës nga Zyra e KMD-së morën pjesë në

workshop-in me temë “Çështjet e personave transgjnorë dhe Interseks në Shqipëri”, organizuar nga Aleanca LGBT dhe Pro LGBT.

Me datë 26 Shtator 2013, një përfaqësuese e KMD mori pjesë në tryezën e diskutimit: “Mbrotjtja e whistleblowers në Shqipëri :Legjislacioni dhe Praktikrat aktuale”, zhvilluar nga Instituti p r Demokraci dhe Ndërmjetësim. Në vijim të këtij projekti, me datë 15 Nëntor 2013 dy përfaqësues të Zyrës së KMD morën pjesë në tryezën e diskutimit me temë “Legjislacioni shqiptar mbi bilbilfryrësit: Çështje, Sfida dhe Perspektiva”.

Në datën 30 Shtator 2013, një përfaqësues nga Zyra e KMD-së mori pjesë në Tryezën e diskutimit “Mbrotjtja e whistleblowers në Shqipëri: Legjislacioni dhe praktikrat aktuale”, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) mbështetur nga Konrad Adenauer Stiftung. Ky projekt ka si qëllim të analizojë kuadrin ligjor dhe rregullator që parashikon aktivitetin dhe mbrotjtjen e whistleblowers.

Me datë 2 tetor 2013 në ambjentet e Qendrës Aleanca kundër Diskriminimit LGBT u zhvillua një workshop me komunitetin LGBT. Në këtë workshop mori pjesë një përfaqësuese e Zyrës së KMD me qëllim prezantimin e mekanizmave p r mbrotjtjen nga diskriminimi, rolin e KMD dhe modelet pozitive, mënyrat e ankimit, procedurat për shqyrtimin e rasteve etj.

Me datë 29 Tetor 2013, një përfaqësues i Zyrës së KMD mori pjesë në tryezën teknike të konsultimit, me temë “Konventa e Stambollit po hyn në fuqi. Po ligji ynë, a është gati?”, me ftesë të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Kjo tryezë u organizua në serinë e takimeve teknike për rishikimin e legjislacionit shqiptar nga këndvështrimi gjinor në përputhje me dokumentet ndërkombëtare. Kjo është tryeza e parë teknike që ka në fokus Konventën e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, njohur ndryshe si Konventa e Stambollit si dhe analizën e saj në këndvështrim me legjislacionit shqiptar.

Me datë 1 nëntor 2013, një përfaqësues i Zyrës së KMD mori pjesë në seminarin “Zhvillimi i Litigimit Strategjik për çështjet e personave LGBT”.

Në datat 12 dhe 13 Nëntor, një përfaqësues i Zyrës së KMD mori pjesë në Takimin e Ekspertëve Rajonale në kuadër të Projektit BE-UNICEF mbi “Mbrotjtjen e fëmijëve nga dhuna në Evropën Jug-Lindore”.

Në datat 20-21 nëntor 2013, dy përfaqësues të Zyrës së KMD morën pjesë në Seminarin e zhvilluar nga Avokati i Popullit me temë “Përdorimi i Treguesve p r të zbatuar dhe vlerësuar të drejtat e Njeriut në Shqipëri”.

Me datë 2 dhjetor 2013 një përfaqësuese e Zyrës së KMD-së mori pjesë në tryezën e rrumbullakët “Analiza SEOT në sektorin e aftësisë së kufizuar në Shqipëri”, të organizuar nga UNDP.

Me datë 2 dhjetor 2013 një përfaqësuese e Zyrës së KMD-së u bë pjesë e panelit në takimin e organizuar nga Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut. Nga ana e përfaqësueses së KMD-së u shpreh rëndësia e bashkëpunimit të shoqatave me Komisionerin për Mbrotjtjen nga Diskriminimi, në luftën kundër diskriminimit.

Në dhjetor 2013, KMD ka shpërndarë materiale ndërgjegjësuese, ku përfshihen fletëpalosje informuese mbi Ligjin “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi” dhe KMD në 10 qendra shëndetësore të Tiranës.

Me datë 13 dhjetor 2013, përfaqësues të Zyrës së KMD morën pjesë në aktivitetin “*Djemtë dhe burrat, pjesë e zgjidhjes – Tregoni se jeni kundër dhunës!*”.

Në datat 4-5-12 dhjetor 2013, dy përfaqësues të Zyrës së KMD morën pjesë në trajnimin e organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të trajnimit të personit të kontaktit të ngarkuar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Sektorin Publik.

Me datë 10 dhjetor 2013, një përfaqësuese e zyrës mori pjesë si lehtësuese për diskriminimin në sesionin me temë “*Të drejtat e Minoriteteve*” në konferencën dy-ditore të Avokatit të Popullit “*Një vit të drejtat tona – Bilanc dhe Perspektiva*”.

Me datë 13 dhjetor 2013, dy përfaqësues të Zyrës së KMD morën pjesë në tryezën e rrumbullakët “*Perceptimet e opinionit publik në Shqipëri: Siguria Njerëzore, Kombëtare dhe Rajonale*”, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Qëllimi i tryezës është të prezantojë gjetjet e një sondazh mbi perceptimet e opinionit publik në tre vendet e rajonit mbi marrëdhëniet Serbi-Shqipëri në kuadrin e sigurisë personale, sigurisë kombëtare dhe rajonale.

Në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit mbi Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është realizuar një cikël seminaresh në qytete të ndryshme të Shqipërisë me temë: “*Diskriminimi në fushën e arsimit*”, nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), më mbështetjen e Civil Rights Defenders. Përfaqësuesi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë si trajnues në ciklin e seminareve të zhvilluar në Shkodër me datën 13.12.2013, në Korçë me datë 19.12.2014, në Elbasan me datë 20.12.2013 dhe në Vlorë me datën 23.12.2014. Këto seminare u drejttoheshin institucioneve dhe aktorëve përgjegjës, për t’i njohur ata me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim nxitjen që të përdorin në mënyrë sa më eficientë mekanizmat që ofron ky ligj dhe reflektimin apo nxitjen e praktikave më të mira për mbrojtjen nga diskriminimi dhe promovimin e parimit të barazisë në lidhje me nxënësit me aftësi të kufizuara. Numri total i pjesëmarrësve në këto seminare ishte 82 persona, ku përfshihen drejtues të institucioneve arsimore, mësues dhe nxënës.

### ***Pjesëmarrje në emisione dhe debate televizive***

Me datë 26 shtator 2013 një përfaqësuese e KMD mori pjesë në emisionin “*Urbanika*” të A1 Report ku u diskutua mbi ligjin “*Statusi i Nëpunësit Civil*”.

Me datë 17 tetor 2013 Komisionerja mori pjesë në një emision televiziv në televizionin lokal të qytetit të Lezhës, që synonte rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit lidhur me mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi, në vijim të Ditës së Hapur të zhvilluar në Lezhë, me projektin “*Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar*”, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit në partneritet me KMD, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë.

Me datë 9 tetor 2013 një përfaqësuese e KMD mori pjesë në emisionin televiziv të Neës 24 “*Me zemër të hapur*”, ku u diskutua tema për diskriminimin e një të burgosuri, që i përket komunitetit rom, i cili ka gjetur vdekjen në ambjentet e burgut dhe familja e denonconte si rast të diskriminimit ndaj këtij të burgosuri.

Me datë 25 Tetor 2013, Komisionerja Baraku, ishte e ftuar në emisionin “*Urbanika*” të A1 Report për të folur lidhur me tematikën “*Kanceri i gjirit e sistemi mjekësor*”. Znj. Baraku

theksoi se kjo kategori përballet me probleme të ndryshme sociale e shëndetësore, ndaj nevojitet më shumë përkujdesje.

Me datë 28 tetor 2013 Komisionerja foli në Televizionin Top Channel ne emisionin “*Pasdite në Top Channel*”, lidhur me një rast për të cilin pas shqyrtimit administrativ të KMD, ka pasur edhe një proces gjyqësor nga ku është dhënë vendimi i parë për diskriminim nga një gjykatë shqiptare.

Me datë 31 tetor 2013 - një përfaqësuese e KMD mori pjesë në emisionin televiziv të Vizion Plus “*Dita ime*”, ku u diskutua mbi temën “Birësimi nga një çift gay”.

Me datë 7 nëntor 2013 Komisionerja foli në Radio Albania Neës lidhur me Martesat Gay.

Në nëntor 2013, Komisionerja ishte e ftuar në emisionin “Target”, në Albanian Screen.

Me datë 25 nëntor 2013 Komisionerja Irma Baraku ka dhënë një intervistë në emisionin informativ në ABC Neës, në kuadër të Ditës Ndërkombëtarë kundër dhunës ndaj grave. Mbrojtja nga diskriminimi dhe fushata sensibilizuese për dhunën ndaj grave ka qenë në fokus të kësaj bisede në studion e ABC Neës.

Me datë 25 dhe 27 nëntor 2013, një përfaqësuese e KMD mori pjesë në dy emisione televizive, përkatësisht në dy televizione lokale të qytetit të Shkodrës dhe Kukësit, që synonin rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit lidhur me mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi, në vijim të Ditës së Hapur të zhvilluar në Shkodër, me projektin “*Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar*”, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit në partneritet me KMD, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë.

Me datë 10 dhjetor 2013 një përfaqësuese e KMD mori pjesë në emisionin “*Duel*” të TVSH në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Me datë 18 dhjetor 2013, Komisionerja Znj. Baraku dhe Drejtori i Postës Shqiptare sh.a, Z. Ardit Çela dhanë një deklaratë të përbashkët për shtyp në Top Neës dhe Scan, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Postës Shqiptare Sh.a.

Komisioneri ka botuar disa shkrime në shtypin e shkruar:

- Me datë 16 maj 2013, Komisioneri ka botuar në gazetën “Panorama” artikullin me titull: “*Të drejtat e komunitetit LGBT, si të drejtat themelore të njeriut*”;
- Me datë 12 qershor 2013, Komisioneri ka botuar në “Gazeta Shqiptare”, artikullin me titull “*Bashkëjetesa fetare, një realitet i prekshëm*”
- Me datë 23 korrik 2013, Komisioneri ka dhënë deklaratë për shtyp mbi fenomenin e dhunës ndaj grave, i shfaqur me një intensitet të lartë brenda një periudhe të shkurtër, e cila ka degraduar deri në vrasjen e grave, viktimat e dhunës nga bashkëshortët e tyre. Kjo deklaratë është bërë publike përmes televizioneve publike dhe private, ku Komisioneri ka dhënë intervista për Ora Neës dhe Radio Albanian Neës, mbi fenomenin e dhunës ndaj grave. Qëndrimi i Komisionerit mbi këtë problematikë është pasqyruar edhe në shtypin e



shkruar. Kështu, me datë 24 korrik, është publikuar artikulli *Baraku: Gratë e dhunuara, nuk garantohet mbrojtje*; në gazetën “Koha Jonë”; artikulli “*Dhuna ndaj Grave, Baraku: Të reagojnë organet shtetërore*” në gazetën “Shqiptarja” dhe artikulli “*Baraku: Denoncimet për dhunë nuk merren seriozisht*”, në gazetën “Tirana Observer”.

### **Pjesëmarrja në Seminare, Konferenca dhe tryeza diskutimi**

Në datën 31 Janar 2013, Komisioneri dhe dy punonjës të Zyrës së KMD-së morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara me mbështetjen e Civil Rights Defenders. Në këtë aktivitet u prezantuan gjetjet e raport-vëzhgimit: “*E drejta Zgjedhore për Zgjedhësit me Aftësi të Kufizuara*” dhe “*Punëdhënësit, Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Komisioneri vlerësoi kontributin e këtyre studimeve në veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit dhe mbajti fjalën e saj, me temë “*Diskriminimi në fushën e punësimit*”.

Me datë 20 shkurt 2013, Komisioneri u bë pjesë e workshop me temë: “*Zhvillimi i Demokracisë përmes Barazisë Gjimore*”, organizuar nga Rrjeti i Grave për Barazi në vendimmarrje, me mbështetjen e National Endowment for Democracy. Komisionerja Baraku mbajti fjalën gjatë seancës së parë: Barazia Gjimore dhe vendimmarrja: Kuadri Ligjor Mbështetës. Përmirësimi i situatës së pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje. Në fjalën e saj, Komisionerja u ndal në këndvështrimin ligjor dhe institucional të KMD-së lidhur me çështjet e barazisë gjimore dhe pjesëmarrjes së gruas në politikë. Në vijim të këtij workshop, me datë 5 Prill 2013, Komisioneri mori pjesë në Konferencën me të njëjtën temë.

Në datën 13 prill 2013, Komisioneri u bë pjesë e tryezës së rrumbullakët me temë “*Gjakmarrja, një sfidë për të gjithë*”, ku u prezantua Plani i Veprimit për tre-mujorin prill-qershor 2013. Ky aktivitet organizohej nga Instituti “Shtëpia e Drejtësisë dhe Pajtimit Kombëtar”.

Në datën 15 Prill 2013, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin me temë: “*Fuqizimi Ekonomik i Personave me Aftësi të Kufizuara*”, organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Në datën 24 Shtator 2013, Komisioneri zhvilloi, në ambjentet e Zyrës së Komisionerit, një takim me Komisionerin për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës, z. Nils Muižnieks. Fokusi i këtij takimi ishte administrimi i drejtësisë dhe çështjet e keqtrajtimit nga ana e policisë.

Në datat 7-8 tetor 2013, Komisionerja mori pjesë në takimin e zhvilluar në Vjenë me përfaqësues nga institucione kombëtare, europiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizma të barazisë, me temë “*Të fuqizojmë së bashku mbrojtjen e të drejtave themelore në një tablo të ndryshueshme të të drejtave të njeriut*”.

Me datë 21 tetor 2013, Komisionerja përshëndeti tryezën e rrumbullakët të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me Partnerët Bashkëpunues të Sistemit të Burgjeve.

Me datë 24 tetor 2013 Komisionerja dhe përfaqësues të zyrës ishte pjesë e tryezës së rrumbullakët “*Ushtrimi i të drejtës së votës për Personat me Aftësi të Kufizuara*”, të organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Gjatë këtij aktiviteti, Komisionerja referoi temën “*Roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në procesin e ushtrimit të së*

*drejtës së votës nga Personat me Aftësi të Kufizuara*”. Me pas, përfaqësues të zyrës së KMD-së u bënë pjesë të grupeve të punës në tryezat e diskutimit me qëllim nxjerrjen e Rekomandimeve të grupit të interesit për përmirësimin dhe zgjidhjen e problemeve të personave me aftësi të kufizuara.

Më datë 14 nëntor 2013 Komisionerja znj. Baraku priti, në ambjentet e institucionit, z. Nicholas Cannon OBE, Ambasadori Britanik në Republikën e Shqipërisë. Fokusi i këtij takimi ishte paraqitja e situatës së diskriminimit në përgjithësi dhe grupeve vulnerabël, njohja me institucionin e Komisionerit dhe diskutimi i mundësive për bashkëpunim mes Ambasadës Britanike në Shqipëri dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përmirësimit të situatës në të cilën gjenden grupe të caktuara vulnerabël.

Me datë 15-16 nëntor 2012 u zhvillua seminari me temë: *“Gratë dhe Korrupsioni në Shqipëri-Arritjet dhe Prioritetet e së Ardhmes”*,. Komisioneri foli mbi kontributin e institucionit dhe veprimtarinë e KMD-së në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri.

Me datë 9 Dhjetor 2013, Komisionerja përshëndeti konferencën dy-ditore të Avokatit të Popullit *“Një vit të drejtat tona – Bilanc dhe Perspektiva”*.

Me datë 17 Dhjetor 2013, një përfaqësuese e KMD mori pjesë në Konferencën e organizuar nga Shoqata *“Amaro Drom”* me temë *“Zgjidhje të qëndrueshme për përfshirjen sociale të minoritetit rom në Shqipëri”*. Roli i Komisionerit në këtë Konferencë ishte prezantimi i situatës aktuale të respektimit të të drejtave të minoritetit rom në Shqipëri, bazuar në konstatimet e KMD-së.